

Viktor Gjokolaj

Barra e vrave
Etnotregime



Tirane 2019

Autori: Viktor Gjokolaj

Titulli i librit: Barra e vrame

Botues: Mark Simoni

Redaktor: Luan M. Rama

Kujdesi grafik: Leandro Xhafa

Korrektor: Preng Gj. Gjomarkaj

Mundësuan botimin; Kthella Sh.p.k, me president z.Pjetër Nikolli
& Kostandin Gjokolaj



Të gjitha të drejtat janë të autorit

Adresa: Shtëpia botuese “**Muzgu**”,

Lagja “Komuna e Parisit” ,

Rruga “Osman Myderizi” ,

Tiranë, Albania

Mobile phone: +355 (0) 68 21 47 538;

+355 42 320 004;

e-mail: mark.simoni333@gmail.com;

Ky botim u hodh në qarkullim në dhjetor 2019

**Kolana
e autorëve
bashkëkohorë
shqipëtarë**

VIKTOR GJIKOLAJ, ETNOTREGIMTAR

Duk është e papritur dhe as befasuese ardhja e Viktor Gjokolës me një përmasë tjetër të krijimtarisë së tij, e njohur më së shumti deri më tash e nga shumëkush prej poezisë. Kush e njeh Viktorin dhe krijimtarinë e tij e raportet që ajo ka me njeriun, me vendlindjen, atdheun, por edhe me traditën, me historinë, mitet, legjendat, doket, zakonet, ritet e gojëdhënat, nuk e ka të vështirë të gjejë në të jo vetëm qëmtuesin e vëmendshëm dhe pasionant ndaj etnokulturë, por edhe bartësin e lëvrujes në një mënyrë krejt të veten të elementëve të saj. Duke u kthyer në kohë gati katër dekada më pas e duke bërë një analizë jo thjeshtë të krijimtarisë, por të të gjithë korpusit të sjelljes e qëndrimit, të gjykimit, mendimeve, vlerësimit e deduksioneve prej krijuesi të Viktor Gjokolës, që jo rastësisht veprën e Kadaresë “Autobiografi e popullit në vargje” e ka një prej librave që ai nuk e ka ndarë nga dora, ashtu si Visaret e kombit e botimet e Akademisë së Shkencave për folkun e traditën, do të kuptojmë se libri “ndryshe” i tij ka bashkudhëtuar me autorin, që prej kur ai ndjeu brenda tij magjinë e krijimtarisë në shtëpizën mbi lumin Urakë e përballë bjeshkës së Valmorit, dhe vendosi që përjetimin e vet ta ndajë me bashkëvendasit fillimisht, e mandej edhe me të gjithë hapsirën ardashëse shqiptare. Librin e Viktor Gjokolës mund ta lexosh si letërsi

artistike, po aq sa edhe si komentar të traditës etnojuridike apo si rrëfime për vendlindjen dhe njerëzit me të cilët ka jetuar. Pjesa më e madhe e njerëzve që ka njohur dhe e ngjarjeve që tregon janë të vërtetë, vijnë nga historia. Nuk mund t'i quash karaktere si në personazhet në letërsi, ndonëse kanë më shumë karakter se ata. Por njëherësh nuk janë as paraqitje historiografike të tyre.

Viktor Gjokolaj, ka pasur jetë të vështirë në vendlindjen e tij, si shumë të tjerë në gjithanshmërinë e vet e më të vështirë në momente të veçanta të saj. Ka shumë të ngjarë që vëmendja e tij e veçantë ndaj traditave joshkrimore të ketë pasur karakter ngujimi, të ketë qenë një përpjekje për t'u mbyllur në një ishull ideologjikisht të ndryshëm ndaj asaj ideologjie që sundonte, por duke krijuar në atë ishull hapsirën e munguar të lirisë së vet. Mund ta quash këtë një formë kundërshtimi të heshtur. Ishte një zgjidhje e mençme për të mbijetuar, për të pasur njëfarë komoditeti shpirtëror, pa fabrikuar konflikt. Më së pari Viktor Gjokolaj gjeti strehë tek Kanuni. Shkruan për Kanunin në mijëvjeçarin e ri ashtu si ka menduar në një kohë tjetër. Nuk është nga ata që Kanunin e përfytyrojnë si një kushtetutë që garantonte republikanizëm dhe demokraci. Ai, Kanunin e sheh me merita historike dhe kulturore thjesht pse përfaqëson një alternativë. Le të ishte si të ishte, totalitar dhe ai në mënyrën e dhënies së të drejtës, mjafton që nuk ishte si ideologjia sunduese, ca më shumë totalitare se Kanuni. Letërsia e Viktor Gjokolës sheh prapa. Jo për ta idealizuar, jo për të krijuar e propozuar një model tjetër qeverimi, apo ndorimi, siç shkruante Pjetër Bogdani, por për të na thënë me shumë mirësjellje se kjo mund të ishte dhe shtëpia ime. Njerëzit e Kanunit janë kudo në letërsinë shqipe. Lukja, që

ka zbritur prej maleve për të shitur qymyrin dhe trupin, âsht e dalë Kanuje. Në romanin “Dimri i vetmisë së madhe” hyn e del disa herë një karakter pa emër e pa fytyrë, që çapitet nëpër rrugicat e kryeqytetit duke shqiptuar vetëm një fjali: Dru me pre. Edhe Drumepreja âsht i dalë Kanuje. Karakteret e tregimeve të Viktor Gjokolës janë njerëz të Kanunit. Ata kanë rrojtur me rendin tradicional etnojuridik, kanë menduar me Kanun, kanë marrë vendime me Kanun, kanë fituar lavdi me Kanun, kanë mbetur në histori me Kanun. Përveç kuturisjes për ta paraqitur Veriun e lekëve dhe gegëve si një republikë kanunore, ka ekzistuar dhe një prirje tjetër, ajo për ta identifikuar Kanunin me Ungjijtë. Viktor Gjokolaj me të drejtë këto korniza i shpërfill. Ai nuk e fsheh simpatinë për kullën e Oroshit, për shtëpinë e Gjomarkut, së cilës Kanuni i njeh një sovranitet të ngjashëm me atë të sovranëve: sovranitet të trashëgueshëm. Gjithaq ai është krejt i vetëdijshëm se Kanuni është i gjithësejtë në arealin ku ka vepruar. Ndryshe nuk mund të ishte Kanun. Ashtu si Talmudi dhe Torah janë rregullatorë paralelë të jetës së hebrenjve: njëri i së drejtës dhe tjetri i besimit, ashtu dhe Ungjijtë e Kanuni jetojnë krahas njëri- tjetrit secili me autoritetin e vet. Madje në jo pak raste, siç na dëshmojnë prej arkivave të fretënve françeskanë, njeriu tradicional duhej të zgjidhte: Me Ungjill apo me Kanun? Për shembull, nëse për merita të dikujt që sapo ishte ndarë nga jeta familja, bajraku dhe krahina vendosnin me bâ gjamë burrash, atëherë meshtari, famullitari, u shmangej riteve të vdekjes që parashihnin Shkrimet, sepse në Krishterim vdekja ishte vullnet sipëran, ishte thirrje e Hyjit, ndaj nuk mund të pajtohej me gjamën, një dukuri tipike pagane, që ka lënë pa mend studiues antropologë të ardhur nga Perëndimi i industrializuar.

Viktor Gjokolaj shkruan tregime me origjinalitet. Para së gjithash kjo vjen nga zgjedhja e ngjarjes. Tregimet e tij Viktori ua kushton jo atyre ngjarjeve që kanë rregullim kanonik që nuk kanë nevojë për interpretim. Ai merret me përjashtimin. Zakonisht përjashtimi ka të bëjë jo me rendin kanunor, por me zonat e pasigurta të Kanunit. Për shembull, me i parilemi mbas dekret të burrit të pare, kur grueja ásht me barrë të vrame. Át Shtjefën Gjeçovi e quan një prallë grash, që edhe tue kjenë i tillë, burrat e pranojnë pa mëdysh. Tregimi që ka sjellë në këtë vëllim Viktor Gjokolaj, me titullin Barra e vrame, megjithëse një rikrijim etnolettrar i një ngjarjeje kanunore, ngjan me letërsinë e realizmit magjik. Në një anë tregimi të kujton motivin e Shën Mërisë në Shkrimet e Shenjta; në anë tjetër ngjarja ndërlihd lexuesin me një mendësi tipike shqiptare, me një besëtytni tradicionale vendëse dhe me ngjarje të përjetuara historikisht në Veriun shqiptar. Duket një përshkrim etnojuridik, por në thelbin e vet tregimi ka të bëjë me thelbet e mënyrës kanunore të jetesës. Në njërën anë është sakramenti i familjes, një prej sakramenteve themelore të Krishterimit; në anën tjetër është kulti i mashkullimit dhe i trashëgimit biologjik të shtëpisë. Këtu kemi të bëjmë me një botë që nuk ka lidhje me tekstin kanunor, por me arsyetimin në koherencë me këtë tekst, me zgjatimin e Kanunit përtej neneve dhe paragrafeve të tij. I së njëjtës natyrë është dhe tregimi-ese për trajtat e komikes në vajtimet popullore në Mirditë. Sikurse shenjuam më herët, në traditën e vjetër shqiptare ka pasur një kundërthënie konceptuale për vdekjen krahasuar me antropologjinë e vdekjes në Krishterim. Në Shkrimet e Shenjta jeta është dhunti e Zotit dhe dekën ja kemi borxh. Thelbi i të kuptuarit të vdekjes në Krishterim është ngushëllueshmënia. Në këtë kuptim, nuk ka

vend për gjamë, sepse në këtë botë ternon vetëm ajo që është hyjnore. Njeriu ndërron jetë dhe shkon prej familjes së vogël atje ku e ka thirrë Zoti. Pikërisht këtë kundërthënie zbut parodia e vdekjes, siç mund ta quanim qesëndisjen e madhështimit të tepruar prej vajtojcave të meritave të të ndjerit me anë të vajtimit parodizues. Në vështrim antropologjik, parodizimi i vdekjes shenjon ndryshim mendësie në drejtimin qytetërues. Me zgjatimin e Kanunit përtej parashkrimeve të tij ka të bëjë edhe rrëfimi letrar-etnografik për statusin e farkëtarit në tre bajrakët e Ohrit (Selitë, Kthellë e Rrëzë). I gjithë ky rrëfim është mahnitës për qendrimin e njeriut shqiptar ndaj tjetrit, të ndryshmit. Sot raporti midis vetes dhe tjetrit (me and others, from mother to other) ka të bëjë me themelet e vlerave qytetare europiane. Por nuk ka qenë gjithnjë kështu. Shumë sociologë dhe antropologë ndëshkimin e hebrenjve dhe të romëve për të qenë përgjatë afro dymijë vjetëve popullsi në lëvizje e kanë shpjeguar me rolin e tyre për kryqëzimin e Krishtit. Të parët e dënuan, ndërsa i dhanë lirinë kriminelit Barnaba, të dytët farkëtuan gozhdët e kryqëzimit. Këto kronika të Krishterimit zanafillës Viktor Gjokolaj nuk i zë në gojë, thjeshtë bën të ditur disa të dhëna etnografike që shprehin fisnikërinë e banorëve tradicionalë mirditorë, të cilët gjenin rregulla që farkëtari të mos ndihej i huaj në katund, të përfshihej me kujdes në të kremtet fetare të popullatës, madje dhe të trajtohej si i privilegjuar në rite rishtarie, të shihej si shenjë mbarësie për vendësit. Tregimet, rrëfimet, rikrijimet, shenjimet për librat mund të quhen me bindje etnoletërsi. Aty janë bashkë Kanuni, njeriu në kod, malësori, kulla, kuvendi, bajraku, ngjarja paraprirëse që e kthen veten në normë Kanuni. Aty është meshtari në ndore të të kthyerve; aty është myslimani që dorëzohet prift;

aty është lahuta dhe flauti, trimëria dhe dashuria, martina që flijohet për çikën, gruaja që duhet të joshë vrasësin e burrit në natën e parë të mortit me qëllim që familja të trashëgohet dhe hak pa marrë mos me mbetë. Aty është Mirdita e kuqe, që është mbiquajtur kështu jo prej ndonjë ideologjie, por prej arsyesh të mëhershme. Aty është Selita me bukuritë e veta, është kulti i vendlindjes dhe i të parëve, është nderimi për trashëgiminë.

Luan M.Rama
Shaban Sinani

MUZGU
SHTEPIA BOTUESE

“BARRA E VRAME”

“Po,-tha grueja,-se asht me barrë të vrame, edhe mbasi ta mbajnë prindja prej shpijet të burrit të dekun tu ju dhanë burrit të dytë, fëmija e parë që të lejë, do t’i nepet shpisë së burrit të parë...” Po si e përse institucioni i barrës së vrame ka hyrë në Keopsin e të drejtës zakonore shqiptare?! “Se asht një prrallë grash,-thotë At Gjeçovi në shënimin e vënë në dorëshkrimin e tij,
- e dishmon arsyeya dhe ditunia. Aq asht i ngulitun besimi i barrës së vrame ndër shqypetarët e maleve sa s’ka burrë që mundet t’ua mbushë mendjen ndryshe. A me nder a me dhunë, shpia e burrit të parë ia ka marrë shpisë së burrit të dytë fminë dhe pas 5-7 vjetësh”

1.

Drafti i është paraqitur kuvendit për vendim-marrje fill pasi pleqtë mentarë e të urtë, bashkë me ndërmjetësit, kanë pirë kafenë e pajtimit të një gjakmarrje të zgjatur e të nisur për shkak të një gruaje të vejë. Tragjizmi i saj do të ketë qenë vërtetë tronditës. Ndoshta dhjetë varre, ndoshta më shumë. Një fëmijë i vejushës së re të martuar me burrin e dytë e ka vënë përballë sulmeve integritetin moral të saj, mundet lindja jashtë kufijve normalë të një shtatzanie, në rastin tonë para kohe. Hamendjeve dëshpëruese për jeranin(të dashurin) ose vetë rebelimi i burrit të dytë ndaj guasviktimitë e ka bërë atë të bjerë në gjak. Palët e konfliktuara në mjegullnajen e ngjarjes nuk e kanë pranuar gjyqësimin e pleqve

dhe vazhdimi ka qenë fatal. Burrat e shquar të maleve e kanë vrarë mendjen për të parandaluar hapjen e një gjame të re. Ata e dinin mjaft mirë se në krejt relievin e Kanunit të Lekë Dukagjinit, vajzat martoheshin fort të reja, e ndërkohë, po kaq të reja, piskama e një vrasje do t'i shpallte vejusha, thuajse adoleshente. E veja kësodore gjendej në prag të shkeljes së moralit të saj dhe, akoma më keq, kur vazhdonte marëdhëniet me të dashurin e saj... Folklori i begatë i Veriut me një lirizëm brilant, sa do ta kishte zili kushdo, e përcjell mallin e ndezur për të dashurin: „ Në hije të bojlisë kush po qan/ Qanë Bardhoka për jaranë/ Qan Bardhoka n'hije t'bojlisë/ Po i shin lott me skaj t'shamisë/ N'skaj t'shamisë po i shin' pa nda/ Nis bojlia për me u tha/Dushku n'tokë i paska ra... Lotët e saj e kanë tharë bojlinë, sa gjethet e kthyer në trajtë dushku, kanë rënë dhimbshëm për tokë. Larg saj, i marrë nizamë a ndoshta i ngujuar, i dashuri me mungesën e tij e dramatizon gjendjen shpirtërore të vejushës. Bardi e ka përjetuar thellë shpirtit të tij dhe pastaj e ka derdhur në këngë e kënduar në odat e kullave, ndër dasma e festa. I shpalosur në këto mjedise, erosi i saj është bërë pjesë e ndërgjegjes estetike të malsorëve. Juristët popullor që shkëmbejnë vizita te njëri-tjetri e kuvendojnë rreth projektit të institucionit të Barrës së Vrame, për t'ia paraqitur ligjvënësit (Kuvendit të Flamurit a të Krahinës), ishin vetë bartës të këtyre vlerave shpirtërore. Sa e sa Bardhoka, poete të dasmës shqiptare, kishin shprehur me magjinë e zërit të tyre, dashurinë për atë që donin. Është e vleftë të themi se, vajzat e gratë, mund të këndonin çfarë të donin ato vetë, jashtë çdo privimi e censure. Erosi i gegëve, ka një fond të pasur, që tregon se sa bukur i derdhnin në vargje ndjenjat e tyre poetet e brishta të viseve të sërta.. Po sjell si shembull, një distik nga Mirdita:

„ Ba me di sa fort të due Shet martinën e më merr mue...“
Trimi i dashuruar (ndoshta i dashuri i vejushës) për mjedisin është krejt anonim, por vasha e don aq shumë sa po ta dijë ai këtë të vërtetë, shet armën (gjëja më e shtrejtë e shqiptarit), e merr atë për grua. Të udhëhequr nga fjala e urtë: A ka burrë që

me shup zjarmin se me i fry, i fry kushdo, hartuesit e draftit kanë si qëllim të vetëm, parandalimin e konfliktit. Por, që Kuvendi të thoshte me një zë: „Mirë e keni pleqnue, or burra!“; hartimi duhej bërë me kujdes, me argument të saktë. Debati ka qenë i gjatë, deri atëbotë, që njëri nga pleqtë, ka thënë: „Grueja e ndame, a e marrun me fjalë, ka barrën e huej“. Ndërkaq janë hedhur binarët e këtij institucioni nga më të çuditshmit, në tërë historinë e të drejtës zakonore shqiptare.

2

Oponenca ka reaguashpër. Dikush ka këmbëngulur se kjo s'ka kurrëfarë arsye, që të kalojë në Kuvend. Si është e mundur që, barra në shtatin e gruas, të vritet e ngjallet përsëri, e të lindë tre vjet pas vdekjes së burrit?!... Barra që dëmtohet, dihet përsë dëmtohet dhe, kur vritet nuk ngjallet më. Mazhoranca është vënë në mbrojtje të projektit, duke thënë „...tue e que fininë që i lind, shpisë së burrit të parë, na e lajmë një zjarrm të pafikun e pa dalë fare. Trojet i trashëgon ky fmi e nuk mbetet shkret, por dhe ndër vllazni ndalet ngatresa“. Pas një grimë heshtje, mbrojtja është rrëzuar. E kjo ka ndodhur pas një pyetje lakonike: „Po në qoftëse grueja e dhënë me fjalë, lind vajzë?!... Juristët popullorë kanë ulur kryet të zënë ngushtë. Kanuni nuk i jep tagër një femre të trashëgojë tokë e ajo (toka) shkret se shkret mbetet. Është dashur të shoshitet sërish në log të kuvendit, deri kur është marrë konsensusi për argumentin, të cilin Gjeçovi e sjell kështu: „Barra e vrame asht si pushka shqiptare me gurë, me ju lag falma, baruti që asht mbrenda jet i dekun, me ja përtri barutin falmes, pushka ndez e shprazet. Si të martohet grueja me barrë të vrame me burrë të dytë, i përtrihet e i ngjallet fmija, i len...”

Fëmija që lind shkon tek shtëpia e burrit të parë e, po të jetë djalë, ka tagrin si çdo mashkull tjetër në kodin familjar të së drejtës zakonore shqiptare; atë mbi trashëgiminë, armët dhe pjesëmarrjen në kuvend. Rregullimi i rreptë i këtyre marrëdhënieve

e bën çështjen të pa apelueshme. Kushti, që i vihet gruas së vejë, kur ndahet nga shtëpia e burrit të parë është, që ajo të thotë fjalën e vet nëse është apo nuk është shtatzanë. Kjo nuk është gjë tjetër veçse marrja në mbrojtje e moralit femëror, sepse nuk kërkohet asnjë provë tjetër (ekzaminimi) veçse fjalës së saj. Vejusha mund të martohej tre vjet pas ndarjes dhe mund të lindëte tre vjet e gjysmë mbas kësaj ndarje, ndërkohë që jeton (bashkëjeton) me burrin e dytë vetëm tre muaj (!)...Në këto rrethana, që nuk kanë ndodhur rrallë në malet tona, po të mos ishte ngritur ky institucion, konflikti do të ishte përhapur rrufeshëm. Çuditërisht, asgjë nuk ndodh, paçka se fëmija është ilegal, sepse gruaja është dhënë me fjalë. Çndodh? Fëmija shkon tek shtëpia e burrit të parë dhe kështu normaliteti familjar vazhdon. Jo vetëm kaq, por dhe opinioni e përcjell në heshtje, pa më të voglin përgojim. Për këtë arsye, bashkëjetesa me burrin e dytë nuk është aspak e kërcënuar. As më e vogla ftohtësi me shtëpinë e burrit të parë, por as me prindërit e nënës së barrës së vrame.

3.

Raste të rregullimit të këtyre marrëdhënieve nëpërmjet institucionit në fjalë kanë ndodhur shpesh ne Malet e Veriut, deri në mesin e shekullit XX-të. Edhe sot njihen raste, p.sh, të një burri rreth të 60-ve në një fshat të Mirditës, që jeton në këtë fshat edhe sot, dhe jeton këtu, pikërisht se është quajtur, ose më mirë te themi, ka statusin e barrës së vrame. Me tagrin që i ka dhënë e drejta zakonore është kthyer në shtëpinë e burrit të parë të nënës së tij pas tre vjetësh. Procesi është mbyllur me një seancë shumë të shkurtër, ku është paraqitur vetëm një provë. Ajo ka qenë dëshmia se gruaja është dhënë me fjalë. Vetëm kaq, dhe transferta është bërë menjëherë. Vendimi ka qenë i formës së prerë. Në këtë mënyrë kontributi i këtij institucioni, krejt primitiv në pamje të parë, u ka prerë udhën konflikteve dramatike. Pasi ashtu, si ka vënë re Kadareja në librin e tij, “Eskili ky humbës i madh”, gjakmarrjet në malet tona vazhdonin gjatë kur ato fillonin për punë grashë.

4.

Nuk ishte Helena, ajo që rrëmbeu princi i pashëm Parid. Jo, ajo ishte „hija“ e saj. Helena realisht ishte në Egjipt. Kështu thotë tragjediani grek Euripidi. Por, ai e dinte fort mirë pse u dogj Troja e përse u flijua Ifigjenia. Bukuroshja greke e kishte tradhëtuar Menelaun dhe nderi i grekëve duhej çuar në vend me çdo çmim. Poeti tragjik, megjithëse e njeh mirë të vërtetën, nuk e përllom ballin e vet. Ai bën çmos të retushojë këtë njollë, që tronditi Dheun. „Në Trojë- thotë poeti,- nuk ishte Helena, ishte hija e saj. „Keqkuptimi“ ndezi furtunën e Trojës. Ajo jetonte në Egjipt dhe nuk e shkeli kurrsesi kurorën me Menelaun, sepse gratë greke nuk janë të pabesa. „Hija“ emerr në mbrojtje bukuranen e pabesë, këtë mollë sherri me përmasa mbimitologjike. Ashtu si në shumë përkime të tjera në kulturat e popujve më të lashtë ballkanas, „hija“ e Helenës, me „Barrën e vrame“, përkojnë me njëra tjetrën, në mënyrën se si merret në mbrojtje nderi i një gruaje.

5.

Tagri që i jepet gruas në këtë institucion të së drejtës dokesore, flet jo vetëm për mbrojtjen që i bëhet asaj, por edhe për një tolerim gati brutal, flet për një gjenerim civilizues për kohën në të cilën u ngrit. „Barra e vrame „. Kjo fjalë veç në gojën e grave të kombit tonë ndihet“, thuhet ne Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ashtu si të gjithë kanunet në tërësi , edhe ky institucion në veçanti, tregon identitetin tonë si komb. Varroset Kostandini dhe ngrihet nga varri për të mbajtur fjalën e dhënë... Kombi ynë beson, edhe se ka barrë të vrame, edhe se shqiptari ngrihet nga varri për të mbrojtur kështu nderin e besën. Është kondicioni shpirtëror i shqiptarit, që i mbart të dyja. Barra e vrame, si institucion krejt i veçantë, e vret intolerancën dhe sjell në kohën tonë mesazhe tolerance, mirëkuptimi e pajtimi.

TAGRI I PASHKRUAR I FARKËTARIT ME NGJYRË, NË TRE BAJRAKËT E OHRIT

Tre bajrakët e Ohrit shtrihen në juglindje të Mirditës etnokulturore. Selita ,vëllu i parë, Kthella dhe Rrënxa . Shpesh quhen: “Tre bajrakët” dhe jo rrallë, “Bajrakët e Thkellës”. Ashtu si dihet, bajrakët ishin territore, që kishin popullsi me një toborr(bataloin)ushtarë. U ngritën këto struktura nga perandoria osmane, rreth vitin 1735, në zona me popullsi katolike. Akademiku, Mark Tirtja e lidh toponimin, ” Tre Bajrakët e Ohrit”, me të qenit territore në Sangjakun e Ohrit dhe jo me të ardhur prej andej, pa perjashtuar migrime të papërfillëshme. Sa i përket emërimit, “Bajrakët e Thkellës”, është një togfjalësh i vonë dhe lidhet me mbledhjet, (kuvendet) që bënin tre bajrakët, te Kroi i Fikut në Perlat si pikë e përshtatëshme për tri njësitë.

Këto njësi u bashkuan me unionin e 12 bajrakëve aty nga mesi i shekullit të XIX-të.

Vinin nga larg. Ndoshta prej pjesës veriore të kontinentit të zi.Vendasit i quajnë, gjypç , egjiptianë. Të zeshkët, sa me të drejtë janë quajtur njerëz me ngjyrë. Gjuhë , përveç shqipes, nuk dijnë. Thonë se kanë ardhur heret nër viset shqiptare.Se kur, nuk mund të jepet ndonjë mendim i kthjelltë. Edhe në tre bajrakët e Ohrit, nuk mbahet mend se kur, veç një gjë dihet mirë:Ishin nomadë, e thënë ndryshe, nuk qëndronin gjithmonë në një katund a lagje. Kishin

besimin mysliman dhe sa herë largohej një familje zevendësohej me një tjetër që vinte nga Mati e Dibra , por edhe nga Kosova (kishte që mbanin mbiemërin, Kosova). Ata pëbënin në vetvete një miniminioritet në këtë oaz të besimit katolik . Njiheshin si farkëtarë në profesion. Po çfar tagri u jepte atyre e drejta dokesore? Askund nuk gjendet një fjalë e shkruar për të drejtat e tyre . Përpos të tjerash, emërvendet në tre bajrakët e Ohrit si, Ara e Gjypkut, Djerri i Gjypkut, Kodra e Farkës, Varri i Gjypkës, etj., flasin se vendasit u kishin dhënë jo pak të drejta . Katundi a bajraku, u ka dhënë atyre troje , por edhe ndopak tokë për t'i integruar në rrjedhën që kishte jeta në Dheun, ku kishin ardhur familjarisht. Po si do të vepronin konkretisht me këta ustallarë, që gaditnin veglat e punës e gjithë gjërat që punoheshin në hekur? U duhej dhënë një tagër e, si për shumë probleme të tjera, Paria është mbledhur e ka pleqësuar edhe për farkëtarët me ngjyrë , që vinin, duke sjellur një dukuri të re në marrëdhëniet e tyre . S'pari, u është dhënë një truall për shtëpinë e familjes(ose familjeve) dhe të farkës . Pleqësia e Dheut(Këshilli i rregullimit të territorit të zonës), në vendimmarrjen e vet, ka pasur parasysh pozicionin gjeografik të truallit . Ai duhej të ishte sa më i përshtatshëm , për sa i përket lehtësisë së marrëdhënieve me krejt banorët, përndryshe me klientelën e farkës . Së dyti: Prona e kujt do të merrej e t'i jepej farkëtarit? Pleqësia ka shfrytëzuar korijet e katundit(tokat disponibël), brenda zonës së banuar dhe assesi jashtë tyre . Ndonjë fjale të hedhur në kuvend, se farka mund të ngrihej edhe në ndonjë skaj, i është përgjigjur reagimim i arsyeshëm: “Njerëz si na, janë edhe ata”. Heshtja, që ka vijuar pas këtyre fjalëve , ka qenë votimi unanim i ligjvënësve vendor për ndërtimin e banesës dhe të farkës . Ky ishte vetëm fillimi . Lajtmotivi për dhënien e të drejtave farkëtarit me ngjyrë, u bënë fjalët:” Njerëz si na, janë edhe ata”.. Kësodore, në sofrën e bisedimeve, u hodhën gjithë pikat e draftit si: udhët si me hy e me dalë nga farka, u vendosën të ishin si për çdo konak tjetër, që qet tym(që është familje më vehte), të mbante jo vetëm kafshë transporti, por dhe bagëti të imta e të kullosnin në

kullotat e katundit a Dheut si gjithë familjet e tjera.

Ndër bajrakët e Ohrit, popullsia ishte thujse krejt katolike , me ndonjë përjashtim të vogël në Dheun e Selitës e të Rranxës, laramanizim, pat filluar, në shekullin e 17-të. Në Kthellë, kjo nuk pati ngjarë përpos myslimanizimit të mbiemrave ,që vazhdon të jetë edhe sot si, Hasani, Sulejmani, etj. Në këto vise, farkëtarët me ngjyrë u tajtuan nga banorët me njerzillëk të madh. Mendojmë se kisha katolike, ka luajtur një rol mjaft pozitiv, lidhur me integrimin e tyre, në marrëdhënie me njerëzit e atyre anëve.

Gjatë intervistave, që kam bërë me të moshuar të Selitës, Kthellës dhe Rranxës, lidhur me argumentin e kësaj eseje, kam mësuar se : Sa herë këto familje, banin dasëm, krushq shkonin ata që thirreshin në fshat. Dhe ata nuset i merrnin larg, në Dibër, Mat, Krujë, ku asokohe nuk kishte transport me makina e kërkohej mund i madh. Në dasëm e në mort të farkëtaërve me ngjyrë, merrnin pjesë nga fshati dhe zona.

Kur milej tufa për herë të parë, në pranverë, gjithë qumshti i çohej në shtëpi ustajt, kjo bëhej edhe për ogur, për mbarësi të gjësë së gjallë. Kur lëvoshkej misëri, çdo katundar i dërgonte një kosh me kallinj misri, kjo edhe si një detyrim për punët e kryera në farkë. Interesant është gjesti, kur fshati kishte festë(fetare). Familjes së ustajt, i dërgohej mish nga çafa e kafshës së therur për festë. Mishi zgjidhej, që farkëtari të mos e marrë këtë dhuratë si një detyrim , por si një respekt, ku të mënjanohet çdo keqkuptim, e të mos vihej re asnjë element diskret. Këto marrëdhënie mes farkëtarëve dhe banorëve të zonës, sollën risi në jetën komunitare dhe krijuan një traditë, që u respektua ndër breza.

Në Kurbnesh, më treguan një episod mjaft interesant, ku shpaloset nje solidaritet i pazakontë: “ Kur shtabi i brigatës partizane, kishte hyrë në fshat, i kishte kërkuar kryetarit të këshillit nacinalçlirimtar, para popullit : Ose të gjendeshin dy kafshë ngarkese, deri në mëngjes, ose do varej në litar para katundit! Krytari i Këshillit kishte thënë: Nuk kemi mushka në katund! Komandanti partizan

kishte përsëritur edhe një herë tjetër të njejtat fjalë dhe kishte marrë të njejtën përgjigje nga kryetari: Nuk kemi kafshë ngarkese në katund!

Ishte viti 1944. Kohë lufte. Katundi i mbledhur në logun e kuvendit u shpërnda dridhshëm e vrikthi, pa thënë asnjë fjalë tjetër përveç atyre, që tha kryetari. Në mbledhje kishte qenë dhe farkëtari i Selitës, me të birin.

Ishin kthyer bashkë në shtëpi, duke menduar gjatë gjithë udhës se si kryetari nuk kishte përmendur pelën e tij për t'ia dhënë shtabit të komandës partizane...

Aty, pas mesnatës i troket në derë njëri prej parisë e i thotë: Unë kalin ia pata dhanë për do punë një miku në Kthellë, por çova djalin e ma sollli. Ne, nuk mund të vemë në litar shoqin tonë, për dy mushka . Erdha me të thanë , që nesër, ti me pelën e unë me kalin, të shkojmë e t'i dorëzojmë. Po, tha farkëtari menjëherë, duke shtuar se e kemi shoq të mirë e nuk e dorëzojmë për dy kafshë...

* * *

Askund nuk kam lexuar për tagrin e tyre, por të gjitha sa thashë i kam dëgjuar nëpër biseda me të vjetrit. Jam impresionuar me mënyrën se si janë trajtuar nga njerëzit e këtyre anëve ndër shekuj, këta mjeshtra të hekurit. E pra, asohere nuk ishte nënshkruar Karta e të Drejtave të Njerut, as Martin Luter Kingu nuk kishte ardhë në këtë botë e njerëzit me ngjyrë shiheshin si racë inferiore. E megjithëatë, thellë në viset e arbërit, kodet e kushtetutës antike, Kanunit të Maleve, iluminonin ndërgjegjen për humanizëm , drejtësi e paanësi.

Sot në Selitë nuk ka asnjë farkëtar. Ikën të gjithë, në fund të shekullit të XX-të, në qendra të mëdha urbane. Ata, qenë bërë shumë familje dhe punonin kryesisht në degën mekanike si farkëtarë, saldatorë e mekanikë. Të gjithë farkëtarët banonin në qytetin e Kurbneshit, që për shumë dekada, ishte një ndër qendrat më të rëndësishme të industrisë së bakrit, por që dallohej dhe për veprimtari kulturore .

Kishin një botë të pasur, që e shpalonin si valltarë e instrumentistë, si këngëtarë...

Kishte prej tyre edhe të zgjedhur në forume të ndryshme. Asnjë dallim nuk iu bahej në asnjë fushë të veprimtarisë shoqërore .

Tagri, që u kishin dhënë këtyre njerëzve, ishte kthyer në një traditë . Ani, se kurrë nuk qe hedhur në letër, por qe gdhendur në shpirtin e bardhë të etërve tanë të drejtë e njerëzorë.

REVISTA "MIRDITA", 2016



VËSHTRIM MBI LIRIKEN FAMILJARE NE MIRDITË

Dga shpirti i shkruftë i mirditasit rrjedh një lirizëm i kulluar Këtë e provon folku i saj i pasur, në tërë strukturën gjinore të lirikës popullore, në krejt tipologjinë e saj: Lirika familjare, lirika shoqërore, lirika intime.

Lirika familjare sjell emocionet nga ngjarje të gëzuara dhe të trishta. Ajo ka brenda saj humorin familjar e gëzimin e festave, dasmave e ngjarje, episode të përveçme të jetës familjare. Por, familja përjeton dhimbjen e ndarjes nga të dashurit, vdekjet, aksidentet, sëmundjet, tradhëtitë bashkëshortore, etj.

Nuk është e vështirë të identifokohet senë strukturën e poezisë popullore në Mirditë e më gjërë në rrafsh kombëtar, lirika zë pjesën dërmuese dhe se në strukturën e lirikës popullore, lirika familjare është e para. Aty ngjizet jeta. Familja është celula e shoqërisë njerëzore. Edukimi muzikor e letrar fillon, që në këngët e djepit, kur nëna, gjyshja a motra, duke përkundur djepin i këndon këngë e improvizojnë vargje. Këngët e djepit nuk kanë vetëm misonin relaksues te i vogli a e vogla, por shprehin dhe dëshirën prindërore për të ardhmen e tyre, që ata të bëhen trima e atdhtar, të mençur e të urtë, të duan prindërit e vëllazërinë?.

Gjyshja i këndon ninullë nipit të vë tëm:

*Rritu bir', shtylla e konakut
Ti m'u bafsh,.. si djal' Gjomarkut!*

*Motra:
Moj Mari, moj e vogla
Lumja ti, po t'perkund motra!*

*Nana:
Po t'përkund me të marr gjumi
Fli, or birë se po vjen pllumi!*

Shembuj të tjerë ka plot ashtu siç ka improvizime pa fund. Sollëm tri varjante të këngës së djepit (ninullës), në Mirditë, me gjyshen, motrën e nënën pasi në të shumtën e herës, thuhet se vetëm nëna thur, këndon ninulla.

Në lirikën familjare vend të dukshëm zë poezia humoristike. Në dasma, perendesha është nusja. Sido që të jetë performanca e saj, pra nusërimi , ajo shfaqet si ylli, dielli. Dhe ja antonimat:

*Nusja jonë si lule bjeshke
E kunata , kurris breshke*

*Nusja jonë si lule ari
Vjerri i saj si si hu qarri...*

Ja si këndon vjehrra nuses në ditën e dasmës:

*Mori nuse, paç nusni
Këto kulla, kan' prit ty
Me u cërkat e me u mshi*

*E në bafsh me pritue
I mshin nana si asht' msue
Se ka than' Gruja e Motit:
- Fillekat bolira plot,
Vet' e dyta asnji lot...*

Raportet e vjehrrës me nusen shfaqen të tencionuara jo rrallë herë ,
ndër biseda përdoret si refren:

*Zot pa reja, mos na le,
Po ksi rejash, mos na bje!....*

Poezia humoristike familjare shkrihet natyrshëm me këngët e dasmës. Rapsodia e dasmës ban hoka me gruen, që është caktuar të gatuaj bukën për dsmorët:

*Me m'sha, kush me m'sha
Bukën tane nuk e ha
Se e ke qit me duert pa la (pa larë)*

Ka nuse që nuk ambjentohen shpejt në shpinë ku është martue, ban gabime e devijime ndër punët që i takojnë e muza popullore nuk mund të hesht:

*E kam marrë nusen puntore
Me e vu n'gjumë e marr përdore
Nusja e mirë, e mirë po i thonë
Po bjen heret e çohet vonë
Kur kanë dal shoqet, n'arë me korrë...*

Tek e kundron lirikën familjare në tërësinë e saj, edhe se autorët janë anonimë, dëgjuesi a lexuesi i tyre e hamendëson se autore mund të jetë kunata, vjerra, motra, një dasmore e zakonëshme, që hareja e

dasmës e ngazëllen dhe ajo i këndon të dashurit:

Është e vleftë të themi se, vajzat e gratë, mund të këndonin çfar të donin ato vetë , jashtë çdo privimi e censure. Erosi i gegëve ka një fond të pasur, që tregon se sa i bukur e derdhnin në vargje ndjenjat e tyre poetet e brishta të viseve të sërta.. Po sjell si shembull një distik nga Mirdita:

*„ Ba me di sa fort të due/
Shet martinën e më merr mue...*

“Trimi i dashuruar(ndoshta i dashuri i vejshës) për mjedisin është krejt anonim, por vasha e don aq shumë sa po ta dijë ai këtë të vërtetë , shet armën (gjëja më e shtrejtë e shqiptarit), e merr atë për grua.

Dasma është skena ku bartësit e folkut të katundit, zonës a krahinës kanë thënë fjalët e gëzimit dhe haresë, që sjell ky moment i rëndësishëm në jetën e njeriut. U këndohet krushqve kur nisen me marrë nusen:

*Udha e barë o krushku i parë
Na e bje nusen, fort të bardhë!...*

Po kur krushqit duket se po vijnë, gratë këndojnë:

*Atje tej një gur i kuq
Po na vjen nusja me krushq...*

E kuqja, e bardha dhe e zeza dominojnë shijet estetike të mirditasve. Molla është argument i shumë lirikave popullore:

*Mollë e kuqe ç’ban andej
Merre udhën dil këtej...
###*

*Moj e mira belin e hollë
A ma fal, nji kokërr mollë?*

###

*Mollë e kuqe, kuq si gjak
Lene degën, eja pak*

###

*Shtegut bjeshkës shkon belholla
Bardh' e kuq faqet si molla...*

*Moj e bardha ,synë e zi
Nate e ditë mejtoi për ty...*

Lirika familjare dhe kënga lirike mirditase në tërësi, ende nuk ka një botim të plotë, qoftë edhe vetëm me ato, që Ansambli Folklorik Mirdita, ka paraqitur në festivalet folklorike kombëtare. Një botimi i tillë, do t'iu hapte udhë vlerësimeve profesionale të këtij visari të trashëgimisë gojore.

SHTEPIA

Revista , "Mirdita" nr. 23, 2019

TRAJTA TE KOMIKES NDER VAJET E MIRDITES

Kur qesh ba camardhok, nëna më merrte shpesh në ceremonitë mortore jo vetëm në fshatin tonë, por edhe në zona të tjera. Në fillesë nuk doja, qaja e ndjehesha keq. Nuk e duroja qenien time pranë një njeriu që nuk jeton ma, që nuk fol as frymon...I qeshë bindur vullnetit të çuditshëm të nënës sime...Më tregonte e ritregonte vdekjen dhe përcjelljen e katër djemëve të saj e vëllezërve të mi, që kishin ardhë e ikur nga kjo botë, para se unë të vinja në jetë. Fillova ta ndjej fort e më fort dhembjen e saj...E, që asohere i kam në kujtesë imazhet tronditese, mënyrën se si vinin gratë e katundit dhe të miqve të largët.

Me një rregull e solemnitet, banin një hap e thoshin një varg. Në fakt e këndonin me një drithërimë therëse. Pas tyre rrjeshti tjetër përsëriste si rregull po ato fjalë, por jo rrallë korrektonin ndonjë lapsus, duke i dhënë vajtimit ritmin e kërkuar... Prologu i vajeve, ishte idhnimi, që kishte sjellë lajmi se miku a shoqi kishte ndërruar jetë. Mandej në një farë mënyre rrëfehej nekrologjia e të vdekurit, bëmat, punët e mira, gjeneza familjare, gjendja civile e tij. Kënga e vajit në frymën e saj të përgjithshme kishte si mision ta sjellte profilin e njeriut që kishte ndërruar jetë, pozitivisht. Thuheshin atë ditë të fundit mbi dhe fjalë të mira, ani se nuk ishte e gjitha ashtu

Ka gjithfarë vdekjesh. Djemtë e ri, si me ta pre kocin, sillnin gjamë me trand bjeshkë e male. Por, diku vritej tjetri për ngatërresa, për hajni, për qentë (keto ishin shumë të rrezikshme), për shkelje morali. Kishte vdekje prej kalit si në legjendat tona, prej pakujdesisë me armë, prej budallallekut, ndonjeherë... Kësisoj, vajet nuk ecnin si në vaj. Vajtojcet nuk e ndinin vedin mirë pa ja përmend në një mënyrë atë që e rëndonte profilin e të ndjerit. Sidoemos, kur vajtojcet e çonin në qiell me lavdata të pa meritue, ku dukej bufonata, grotesku, trajtat e komikes në përgjithësi...

Në këto rasa fillonte reagimi i rendit tjetër të vajtojcave. Në fillim, me përmbajtje e me tone qortuese për vajtojcet, por kthjellonin edhe të pranishmit se i ndjeri nuk ishte aq sa e naltonin vajtimoret, përkundrazi ka qenë një njeri i ngratë. Fjalët e vajit ndiheshin me dy palë veshë, që rreshti tjetër të ishte i qartë përsa ishte thënë.

Por, kur vijohej të teprohej pafund me lavdrime, atëherë vajtojca e radhës merrte detyrën me e çart atë atmosferë hipokrite. Po, me se, me nderhyrje te drejtuesja? Jo. Ajo, nëpërmjet vargjeve therëse e herë-herë me humor, që me të ba me u shkye prej gazit, bash në mort. Nëpër kohë kam shënuar shumë episode të rrëfyera në vargje, ku trajtat e komikes, sarkazma, ironia jo rrallë e kanë shtang kortezhin e mbarë ceremoninë mortore.

Më,1983, një bijë e Bardhajve të Selitës , e datëlindjes 1924, më rrëfei se si e kishin vajtuar burrin, dy gratë e tij, në mort.(Në Mirditë ,Kisha nuk lejonte dy kunorë, por raste të rralla ka pasur e, kjo ndodhte , kur gruaja e parë ose nuk lindte fëmijë ose nuk kishin djalë. As kjo nuk përfillej nga kanuni i Kishës. Ajo i shkishëronte dhe e varroste jashtë varreve të katundit).. Në viset e Veriut të Shqipërisë, gruaja ka tagër me e qa me fjalë burrin e saj , por vetëm e pa ia prit askush, duke ju drejtuar me togfjalëshin : Or, tremthi em !Or, trimi im)

Gruaja e parë vajtoi:

Kur e vejshe vargjun e sahatit,

Or, tremthi em

E ja vejshe shalën kalit,

Or, tremthi em

Shtangshin krenët e bajrakut

Or, tremthi em

T'rrishin pushkët në frangji,

Or, tremthi em

Gjulshojshin qetë në hulli,

Or, tremthi em!

I ndjeri kish qenë një burrë i urtë, por një shkretan, që nuk e kishte shoqin. Jo vetëm që nuk kishte kulla e kalë, e qe me plugue tokën, por kishte jetue në mjerim. Kur gruaja vajton burrin ndiqet me respekt e kureshtje të veçantë, por në këtë rast gadi shpërthyen të qeshurat...

Grueja e dytë e korigjon të parën, por me një humor të rrallë. Ajo vajtoi:

Ej, ti s'ke qënë asoj burri,

Or, tremthi em

Veç ke pas një vargj unuri,

Or, tremthi em

S'ke pas kulla e saraje,

Or, tremthi em,

Po ke pas një ksollë me kashtë,

Or, tremthi em

Pula mrena e bishti jashtë,

Or, tremthi em!

Si shpallet më bukur komikja nuk ka. Kur kjo situatë krijohet, bash në ceremoninë mortore të një njeriu që ikën këso bote, në praninë e të afërmëve, miqve, shokëve merr ngarkesë të veçantë. Jo vetëm kaq, por mesazhi që jepet është i kthjelltë: ta përcjellim të ndjerin me kangavajin që meriton se ndyshe e rëndon më shumë jetën e tij modeste.

Kishte ndodh që, pa dashje, qe vra një bari në mes të moshës. Për t'a ba ngushëllimin sa ma prekës, vajtojca e çon në qiell statusin e bariut të gjorë, duke iu drejtuar:

Or, filani, or kapidan!

Reagimi është ba vrikthi nga vajtojca tjetër që priste radhën:

*Na, po qajmë e po vajtojmë
Shoqja-shoqen, s'po e ranojmë
Se janë vra, turli-turlish
Jo s'po vrasin, një çoban dhish...*

Ndër male të Mirditës dhe jo vetëm, për shkelje të moralit kriste edhe pushkae vritej njeriupanji pady. Edhesë shumë erëndë dhe epërdhosur shuarja e tij, gjindja ngrehte mortin e fjalëtorët merrnin udhën. Në këso ceremonialesh me ngarkesa të pazakonta, vajtimoret binin në hall sidomos ato të miqve. Duhej thënë e vërteta, sidoqoftë.

Në Fan, një i spaças e kishte shkel etikën me një grue të re...E patën vra. Në vaji merret disi në mbrojtje gjaksi se kish qit pushkë për nder. Pos të tjerash ajo tërheq vemendjen të pranishmëve:

*Kush të kaloje nëpër Fan
Mos ta ktheje kryet m'njant anë
Se merr plumbin anë e mbanë!..*

Po shënoj edhe një episod tjetër me këtë argument, pra si e kanë vajtuar të vramin e zënë në flagrancë për amoralizëm: Vajtojca këtu është racionale. Episodin e trajton si një moment fatkeqese njerëzianë për gjithë kohët kaba flirte eshkeljet të rëndaderinë inçeste...

*Të gjith' kta, qi t'kan' rrethue, or miku em!
N'pyll kan' hi, por s'kan' zhabllue,
M'spatë kan' pre, por s'kanë tokllue
Po, ty, t'met me e pague..., or miku em!*

Vdekjet e papritura e kanë vënë vajtojçën përballë përgjigjesisë për skjarimin e rrethanës. Kishte vdek një nusese e re. Pa e filluar vajin, kanë ba pyetjen e zakonshme se nga i erdhi vdekja e papritur. Njëra nga gratë e shtëpisë ka thanë se nusja kishte pirë një kafe,, Në rreshtin e dytë të vajit, ajo ka pyet me sarkazëm:

*Ajo kafe, që t'kanë dhanë
Kaq e idhët paska qanë?!...*

Njerëzit kanë shtag para kësaj akuze të beftë. Kanë ndie dhe prindërit... Është dashur që i zoti i shtëpisë të bëje be se vdekja e bijës së tyre kishte qenë një vdekje natyrale, se kafeja që kishte pirë bashkë me gratë e tjera nuk ishte shkak i vertëtë i shuarjes së saj.

Në zonën e Rubikut, një i ri refugjat kthehet i vrarë! nga policia greke. Vdekja ishte e randë. Pas fjalëve hyrëse vajtojca i drejtohet të ndjerit me plot sarkazëm:

*Fort kjo zemër, po na dhem, or miku em
Po a thue bane ndoj gabim, or miku em
Se do gjana, s'kan durim, or miku em...*

Mesazhi është i kthjelltë: Në dheun e huaj duhet të sillesh mirë e të mos bajsh faj se durimi ka një cak.

Nëpër eksplorimet e mia për këtë argument, kam identifikuar se vajtojat kanë reaguar me sarkazëm edhe ndaj zhvillimeve politike ndër stinë të ndryshme.

Në Fan, aty nga viti 1948, vrasin një të arratisun, ma shumë për me u ruejt se kishte dhanë bukë njerëzve të malit.

Vajtoja, që e njihte mirë traditën e maleve tona për nderimin e mikut (mirditasit, në pjesën dërmuese kishin dhënë bukë e ndihmuar miqtë e njerëzit e zakonshëm për të nderuar vatrën e tyre e traditën se ishte turp mos me pritur e përcjellë atë që të vjen në shtëpi e jo thjeshtë kunder shtetit), dëshmon:

*Paj, janë ul malet, or miku em
E janë çue prrojnat, or miku em!*

Qartësisht ironizon pushtetin e ri, që po ban padrejtësi e po shkel mbi traditat shekullore të mikpritjes...

Në vitet '90-të, në Thkellë, pasi i thotë punët e mira të të ndjerit, vujtet e tij në kooperativat bujqësore, e mbylli vajin me këto fjalë:

*Se e dashtuna, Partia e Punës, or vllau em
Na e pat pru shpirtin, n'maje t'hunës, or vllau em!...*

Nëna ime, si e thashë dhe kryehere, kishte përjetue një dramë me ikjen e katër djemëve të saj. Kisha vënë re se ajo, kur ishte vetëm niste e vajtonte, herë për njërin e herë për tjetrin, por edhe për të katër djemtë e shuar. E ndigjoja me vemendje atë elegji të nënës për bijtë e saj. Njëherë guxova e i thashë se tash nuk duhet me vajtuar. Më dha të drejtë. Tash po rriteni ju e nana do knoje për ju, në gzimet e dasmat tuaja. Fjala del prej shpirtit edhe kur dhemb edhe kur gzon, Të kisha

ditun shkrim, do t'i shkruaja,,Njeriu gjithëhere qanë për hallet e dhimbjet. Ai nuk qan vetëm të dekunin, por qan dhe hallin e fatin e tij...

Më tregoi se si një grua e martuar te një shtëpi e varfër, qante hallin e fatin e saj me këto fjalë:

S'e kam ardh ke ky lanok, of, moj nana eme

Jam veshun me spathok,

Jam ngjesh me një konop,

Kam pa ftyrën n'nji lugj qeni

Jam kref me një boç arrneni...

Me i pas zili gjithkush këto fjalë .Një autoparodizim i fatit të mjerë.

Mirdita po e përcjellë ndër breza kangën e vajit. Rrallë mungojnë vajtimoret nëpër ceremonitë mortore në këto vise edhe se me ndonjë devijim të vogël si fjala vjen, disa vajtojnë vetëm ,solo e pa pritje e percjellje si ka qenë motit...

Vajtojcet janë barde tipike. Perpos vargjeve hyrëse a përmyllëse , që thujse thuren në çdo vaji, vargjet e tjera improvizohen drejtpërdrejt në ceremoninë e varrimit dhe interpretohen (këndohen prej sosh). Në kronikën e këtyre ceremonive , këto barde të shquara kanë shpalosur jo vetëm dhembjen për shuarjen e mikut , shoqit a njerëzve të dashur, por kanë reaguuar ndaj shmangieve të identifikuara gjatë ceremonisë mortore. Shpesh edhe me sarkazëm, ironi e trajta të komikes, ashtu si u përpoqëm ta shkruajmë në këtë esse.

Botuar në revistën Illz, Tiranë, tetor, 2017

MIRDITA E KUQE, NJË TOGFALESH I MOÇEM

Kur kam udhëtuar jashtë Mirditës, më kanë pyetur shpesh: Përse krahinën tuaj emërmadhe e quajnë „Mirdita e kuqe“? E kam përcjellur me heshtje në fillim pastaj kam pyetur veten : Përse kjo kureshtje e bashkëbiseduesve të mij, në Lezhë, Shkodër, Tiranë, Tepelenë, Vlorë, Gjakovë ... Më qe dukur disi provokuese, jo thjeshtë, një kureshtje . Pastaj e vërteta ishte se nuk qeshë marrë kurrë me semantikën e këtij togfalëshi. Pyeta edhe unë , njërëz të moshave të ndryshme, shfletova për ta gjetur të shkruar gjëkund në çfarë do trajte që të ish. Bashkëfolësit e mij, më përmendën disa këngë, që këndoheshin nga mirditasit dhe jo vetëm. Këngë të shkruar në vitet , 50-të e ,60 të shekullit të kaluar, këngë që porositeshin nga Mirdita zyrtare për t’i kënduar në përvjetore të rënësh, në manifestime të madha folklorike. Për katër heroinat e Mirditës, për Bardhok Bibën(ne disa këngë e ligjërata, thuhej: Mirdita e kuqe e Bardhok Bibës dhe Ndrec Ndue Gjokës). Ne mundëm të gjejmë në disa këngë të asaj kohe, togfjalshin, që përmendëm si:

Skuqën malet katër nuse

Prandaj i thonë, Mirdita e kuqe.

Këto janë marrë nga një këngë e viteve 80- të , e cila u kushtohej katër heroninave të Mirditës.

*Lot, mos qit Mirdita e Kuqe
Ballin nalt për jet e mot
Ka me t'ba partia nuse
Si e desht Bardhoku jot.*

Marrë nga një këngë kushtuar Bardhok Bibës e shkruar në fillim të viteve ,70-të dhe e kënduar nga ansambli i Mirditës.

*Shkrepi dielli i mëngjesit
Shkëlqen vesa mbi burbuqe
Mirëmengjes, Mirdita jonë ,
Mirmëngjes, Mirditë e kuqe!*

Është e viteve shtatëdhjetë, e kompozuar nga një kompozitor profesionist.

Në një kronikë të kohës së diktaturës lexoxa: Mirdita e kuqe e partisë po i pret festat e nëntorit me rezultate të larta...

Ka dhe të tjera rasa, që për motive të kohës të jetë thirrur me këtë togfalësh nëpër konferenca, forma edukimi, gjyqe politike, etj. Ndjeva se pyetjet, që më janë drejtuar, herë mbartnin ironi e jo rrallë nostalgji. Mirdita , shënjestra e terrorit të kuq, Mirdita e rezistencës epike ant-komuniste, që i dha kësaj epepeje shumë martirë dhe e pagoi me burgje dhe internime , në vitet e pluralizmit në Shqipëri ka mbështetur të majtën... (!!)

Natyrisht nostalgjikët duan ta evokojnë këtë kohë si epoka e kuqe e socializmit fitimtarë, si e mira që populli ynë kishte kërkuar në shekuj... Ata inspiruan që Mirdita në propagandën e kuqe të ishte vetëm e kuqe, nenkupto: e shtypur nga diktatura, që në kërthizë të saj i ngriti burgun më famëkeq të Shqipërisë komuniste, burgun e Spaçit. Edhe sot e gjithë ditën këto këngë i hedhin në rrjetet sociale . Por, dhe disa filma si: “Besa e kuqe“, “Guri i besës“, “Komisari i dritës“, , “Plagë të vjetra“ etj...

Teksa, sdudiuesi Preng Gjergj Gjomarkaj, po përgatiste për botim monografinë e herëshme të Zef Mark Harapit, „Mirdita në gojëdhëna , histori dhe etnokulturë, deri në vjetin 1929“, gjeta të shkruar këtë togfjalësh, në një këngë të njohur të vitev 20-të, të shekullit të kaluar:

U çue Dibra me saruqe

Për me i ra Mirditës së kuqe.

Poeti popullor nuk e ka improvizuar togfjalëshin, thjeshtë e vetëm për rimë. Ai e ka bart prej motesh e dëgjuar prej paraardhësve të tij. E thënë ndryshe , Mirdita e kuqe qe thirrur shumë heret

Ka do vjet që shkruhet për Mirditën, por edhe mbarë e prapë si thotë një fjalë e popullit. Jo rrallë e ngrëjnë në qiell, me një etnocentrizëm të pashembullt, hiberbola që veçsa ia ulin vlerat e vërteta identitare. Njerëz që i shpifën kësaj pune, që vetshpallen „historian“, poetë, gazetarë, rapsodë pafund , që e quajnë veten „kantautorë“ ,etj. Mirdita, është një etni e krijuar jo shumë herët e që lidhet më së shumti me sagën e Derës Pnricërore të Gjomakut. Një etni që u formësuar nëpër kohna , deri kur rreh vitit 1850 , ajo si union numëronte dymbëdhjetë njësi (bajrakë, struktura lokale të Perndorisë Osmane , 1735, kryesisht në zona që banoheshin nga katolikët). Dikush ngrihet e thotë se Mirdita është 3000 – vjeçare se „Asht zemra e kombit ,ku u rrita,.. Diku mburret se: Jam Mirdita si kam qenë, një tjetër thërret :Qohu Mirdita e Kastriotit! Po kush po na sulmon?! Kujt kundër do ngrihem?!Mirdita – Vadikani i Ballkanit e Mirdita republikë,etj, etj. Këto këngë këndohen ne mjedise publike e as kush nuk reagon...

Le ta rimarrim argumentin e të përpiqemi të themi se përse krahina e mori epitetit „ e kuqe“.

Prej se, në ato male , brigje e kreshta, jetonte një fis luftarak? Se pirusët qenë metalurgët e parë, që i shkruanin

ceherorët e bakrit e llava e kuqe ngrihej deri në qiell?
A prej nenit të kodit penal të drejtës zakonore Gjak për gjak, pra të institucionit të gjakmarrjes?

Dikush mund të thotë me të drejtë: këto janë thjeshtë pyetje hipotetike , pjesë e procesit holomtues. Krejt e drejtë. Mirditasit janë të besimit katolik (besnikë të papërkulur te fesë katolike ,por jo aq besimtarë). Të ketëmarrë këtë mbiemërthelbësisht me ngjyresë religjioze(vena asht gjaku, e buka, korpi i Krishtit)?! Pat ardh një kohë, kur Mirdita rrethohej e gjitha nga popullësi e besimit musliman.Përpos kësaj krahina gëzonte autonomi nga Perandoria Osmane dhe për sa përmendëm ,zonat për rreth t'a kenë pagëzuar me epitetin „e kuqe“, për t'a veçuar prej te tjerash? Sa thamë nuk shkokëlojnë pse-në . Në kostumet popullore të Mirditës dominojnë e kuqja dhe e zeza mbi sfond të bardhë. Duvaku i nuses gjithashtu , i kuq si flamuri ynë . Në letërsinë orale, simbolet,metaforat, krahasimet kanë të kuqen. Kur vjen nusja në katund , gratë dasmore këndojnë:

Atje tej një gur i kuq

Po na vjen nusja me krushq.

Në këngët liriko- erotike:

Mollë e kuqe, Ç'ban andej,

Merre udhën dil këtej...

I moçëm sa kënga, togfjalëshi, Mirdita e kuqe...

Gazeta "Koha jonë"

SELEMI

Herët e mësova këtë fjalë. Si asohere, më duket se dëgjoj zërin e grave të Kurbneshit , që ishin nga ana e nënës sime. Paj t'u baftë hisja bjeshkë , oj Prenë Bardhokja! – Të lumtë ajo gojë, vijonte tjetra...Pas një grimëher pyesja veten , po ç'mrekulli ka ba nëna ime, që e urojnë me kaq solemnitet?!... Njëpër kuvendimet e tyre, mora vesh se ime më , kishte marrë një vendim kurajoz e bërë një gjest bujarie e njerëzie... Kishte ndodhur një fatkeqësi e madhe, djegia e shtëpisë me gjithë robe ,orendi, bagëti. Gjithçka qe ba shkumb. Ishte fund dimri. Kohë varfërie. Nëna u kishte thanë burrave të shtëpisë: “ Selemin (20 kokë dele) , që kam në Kumbull të Selitës , do ja fal shpisë...” Po, përse e çmonin shumë atë që kishte bërë nëna ime? Nuk më qe hequr nga mendja ky akt i saj, por as fjala Selem. Shikoja nëpër libra, më vonë edhe në fjalorë e nuk e gjeja dot... Ishte do kohë, që fjala kanun tingëllonte si fjala armik. Shtypi, radio, mbledhje pafund në lagje,në fshatra, shkolla ,institucione, forume grash sidomos, propaganda e kohës ulurinte kundër traditës, që qenë pagëzuar me togfjalëshin zakone prapanike(jo se nuk kishte të tilla). Bash ato kohë e pata pyet nënën prapë për Selemin. Ajo më qe gjegjur shkurt. Je shumë i ri ,or bir, por nuk janë gjanat krejt si po thonë sot. Këto gjana i kanë vendue heret, pleqtë e Dheut.Po ti mos u baj marak ,thonë se një prift i ka mbledh nëpër popull e lanë të shkrueme, e ti ke zell me mësue e do ti

knosh në libra. Or, djalë i mbarë, m'u kthye një herë tjetër, ta kam thanë se nuk ka qanë si po thonë sot. Kohët ashtu kanë qenë. A din ti se Selemi ishte vetëm i grues e s'kishte zot shpie me e prek pa thanë gruja. Po paja? Nusja sillte rroba edhe për dasma e festa e me dalë te kisha,por edhe për punë që mund të shkonin mbi 20 vjet...Po dhëndrri sa palë rroba i baheshin kur martohet? Qeshi fort e m'u drejtua: Ndodhte, që tirqit a xhamadanin e kuq ja merrte ndonji shoqi sa për ditën e dasmës. Qesha dhe unë ,por vrikthi më erdhi shumë i habitshëm fakti se dhëndrri, familja nuk i bënte për martesë sa nuses,bile ndodhte që ai t'ia merrte dikujt vetëm për ditën e dasmës. Kaq pak dhëndrri?! Këtu s'ka barazi ,s'ka... Ndahej shpia e robit ,por Selemi, arka e nuses nuk prekej me pajë e dhunti(dhurata), parallikë(stoli,bizhuteri).

Sa herë vinin shoqet e saj për vizitë më vinin ndërmend fjalët e tyre për Selem. Qeshja me vete.

Një burrë i vjetër, që kishte kryer Konviktin e Oroshit, më grish në kafe e më thotë: Nuk besoj t'a kesh këndue Kanunin e Lek Dukagjinit. Jo, i thashë. Nuk kam mundur as t'ia kërkoj askujt, bibliotekat nuk e kanë. Kur të kalosh nga katuni ynë,ndalu ke kulla ime. Ty , ia vlen me ta thane,por pas pak ditësh qe ndarë këso bote krejt papritur.

Aty nga fundi i viteve '80 të qindvjetëshit të fundit e hasa këtë fjalë edhe në botimin e Akademisë së Shkencave ,“E Drejta Dokesore shqiptare”. Te kanuni I Skenderbeut, më vonë.

Tashmë ,në bibliotekën time ishte Kanuni i Lek Dukagjinit, Kanuni i Skenderbeut, E drejta Dokesore Shqiptare, studime te prof. Ismet Elezit, Mark Tirtës, Ndue Dedajt, Xhemal Meçit,Tonin Çobanit...

Mora përsipër me korrektuar ato që më pat dhënë nëna para shumë vitesh .Dhe ja,ajo ma kishte thënë si të ishte bashkë me priftin që e mblodhi dhe e kodifikoi Kanunin

“Pajae grues nuk hin në pleqni të të damit. Dhantitë (edhe Selemi V.Gj) qi i mblidhen nuses në ditë të martesës si te prindja, si te burri,kanuja e të

damit nuk i përfshinë. (E Drejta Dokesore Shqiptare, neni 331, fq 259)
Te tagri i grues(po aty, neni 45 fq. 76), thuhet: Gruja ka tagër me lypë prej burrit veshën e mbathën. Selemi na paskësh qenë një pronë, kryesisht gjë e gjallë, që familja i jep dhuratë vajzës kur martohet. Por , kishte edhe një kusht. Ajo pronë ishte vetëm e nuses. Edhe po të shtohet bagëtia e të bëhet tufë ,ajo ishte vetëm e Asaj. Në asnjë rrethanë nuk mund të futej në llogari të familjes. Të drejtën e prokurimit e kishte vetëm gruaja... Dhe gruaja – nëna ime e ndjerë paskësh berë një gjest bujar e gjithëçka me vullnet të lirë e në respekt të traditës. Selemi ja fali shtëpisë në një ditë shumë të vështirë pa ia kërkuar njeri. Selemi. Sa herë më vjen ndërmend apo e lexoi diku më kujtohet nëna dhe ato të mirat gra të fshatit tim që e uronin: T’u baftë hisja bjeshkë, oj Prenë Bardhokja!

MUZGU
SHTEPIA BOTUESE



Intervista





SELITA - KËNGA DHE BRENGA IME

-Intervistë dhënë gazetarit, Gjergj Marku, për gazetën, “Mirdita“

Jeni ndër tre të rikondiduarit e PD-së, si drejtues komune e që e rifitoni këtë post. Motivi juaj dhe i atyre, që ju votuan?

Është e vërtetë , por jo fort e rëndësishme. E rëndësishme është të bësh gjëra të rëndësishme e jo të hiqesh si i tillë. Më kërkuan të rikandidoj dhe ashtu bëra. Isha i bindur se nuk e kam shkelur kontratën morale me ata, që kam përfaqësuar. Përsëritja e kësaj kontrate, më ngarkon me detyrime më të mëdha ndaj komunitetit.

Krahasuar me mandatin e parë, ç’gjë ka ndryshuar në këtë të dytin?

Sigurisht, që ka ndryshime. Mandati im i parë i përket fillimit të erës së pluralizmit në Shqipëri. Vështërsitë ishin më të mëdha..Ne vinim nga një sistem i centralizuar ekonomik. Integrimi me marrëdhëniet e reja të publikut, me administratën lokale nuk ishte aspak i letë. Çmimet liberalizoheshin e tregu mbushej, por edhe pagat rriteshin dukshëm. Sot tregu është me çmimet ndërkombëtare ndërsa pagat ende shqiptare...

Kurbneshi i njëmijë e një halleve , nga qytet i zhurmshëm, të cilin e keni përjetuar vetë edhe si punëtorë miniere, tani pothuajse i braktisur. Ç’ndjesi të jep kjo gjë?

Ndjej dhembje. Unë e kam përjetuar ngritjen , braktisjen dhe epilogun e këtij qyteti. Minorë pa minjerë nuk mund të ketë. Kanë mbetur rreth 650 frymë me prirjen, që boshatisja të vazhdojë. Sektori i shërbimeve është shkurtuar në maksimum. Nuk ka qoftë një punëtorë pastrimi. Edhe pensionistët i marrin pagat në Rëshen, që veç shpenzimet e udhëtimit i ulin ato 10%. Nuk është fjala se nuk kemi kërkuar, bile disa herë në mënyrë institucionale. Ndërkaq vazhdon të ulet fondi i ndihmës ekonomike.

Përsa i përket zhvillimit të investimeve për këtë vit, ç ‘projekte keni, mos ndiheni të “diskriminuar” nga qeveria e krahut “tjetër” politik?

Gjatë viteve të tranzicionit është bërë diçka edhe në Selitë. Të gjithë fshatrat janë lidhur me rrugë auto. Pjesa dërmuese e shkollave janë rikonstruktuar. Për këtë vit disa projekte kemi nisur drejt institucioneve, që duhet t’i financojnë. Fatkeqësisht nga buxheti i shtetit për këtë vit asnjë lek për investime. E keqja është se, qeveria nuk është racionale në investimet që kryen. Vendlindja ime i ka dhënë thesarit kombëtar flori me tonelata dhe nuk e meriton këtë përçmim...

Më duket se Doktor i partisë suaj, ju pat pyetur:”Ende jetojnë njerëz në Kurbnesh’?. Mos vallë kjo u kthye në dëshirë zyrtare për t’i shprazur malet nga ata malësor që jetuan atje prej shekujsh?

Sëpari, Doktor- President, gjatë takimit në zyrën e tij, në prill të viti 1994 nuk më ka pyetur kështu, kam rasën ta përgenjeshtroj njëherë e mirë.

Sëdyti; zbrasja e malësisë ka ndodhur edhe në vende më të zhvilluara se ne .

Së treti, Unë banoj në fshat , por ndeshem me psikologjinë time prej fshatari. Dhe këtë duhet ta bajë pjesa më e madhe e shqiptarëve... Thuhet dhe shikohet nga çdokush, që kalon atyre viseve, Grykës së Selitës, Didhes, Kunor-Valmorit me pamjen terheqëse të një perle

edhe pa vënë dorë njeriu, po sikur të ndodhte kjo e fundit?

Kjo do të ishte mrekullia, por nuk vjen sa herë e thërrasim ne. Pushuesit , thuajse nga gjithë Shqipëria , që vijnë të pushojnë te Kroi i Bardhë më shumë se kudo tjetër në Mirditë, janë “kasnescët” e parë. E nesër është e pamundur të mos vijnë investitorët. Çuditërisht, shpresoj...

Përveç “artit” të të drejtuarit , jeni ndër të veçantët pushtetarë, ku jeton dhe shpirti i poetit.Sa shkojnë bashkë këto dy ndjesi, Ç’ projekte keni nëpër duar?

Atëherë, kur Alen Boske , nuk arrinte bashkejtesën me realitetin ,thoshte:

Unë gjithmonë kam pasur dy kokë;

Të madhen për trishtim,

Të vocklën për zbavitje

Shpesh te unë këto dy ndjesi janë në unison. Kur pjesa ime prej poeti zemrërohet me atë të kryetarit, gjithëmonë, fiton poeti, sepse poeti gjithmonë ka të drejtë.

Po punoj për një vëllim të ri poetik dhe për një monografi për vendlindjen se, Selita është kënga dhe brenga ime.

ZOGJTË DUAN QIELL...

Pyetje: Njiheni si bartës i kulturës popullore në Mirditë, njohës dhe inspirues i saj, si poet i mbështetur në traditën popullore, autor shkrimesh (eseshë) mbi doket e gjer pjesmarrës në pajtime. Në mënyrë të veçantë kontributi juaj është i ndjeshëm në qëmtimin e folklorit dhe në këngët autoriale, që prej më se njëzet vjetësh janë kënduar nëpër festivale pa emrin e autorit?

Përgjigje: Bart i kulturës popullore në Mirditë ?!... Asesi nuk mund të ndodhte ndryshe. Unë kam ardhë në jetë, kur gjysma e dytë e shekullit të njëzet , po hidhte hapat e parë. I teti fëmijë i dy bashkëshortëve, që kishin lindur në fillim të atij qindvjeçari, i cili mbajti mbi supe dy luftra botërore. E ndjera gjyshe ishte e datëlindjes 1870. A-në e asaj që quhet Kulturë Popullore, ajo ma ka kumtuar e para, rreth votrës së një shtëpie përtrollëse në Kurbnesh. Këtu ishte e thënë të fillonte atdheu im dhe dashuria pa cak për këtë vis të mrekulluar, në luginën e thellë nën një fortifikim të sigurtë prej malesh. I pari monument natyror që kam parë në jetë ka qënë një gurë vigan që mban emrin Gjon, me shpinën zatetun në Bjeshkën e Valmorit e këmbët i ngulte në valët e kthjellëta si lot vajzërorë të një lumi syqielor, Urakës, që rrjedh thujse mospërmas Selitës... Po le të kthehemi tek votra e shtëpisë përtrollëse, në vendlindjen time. Besoj se kam arsye dhe të drejtë, që ju tregova moshën e prindërve dhe të gjyshes për të thënë se përcjellja e traditës nga brezi në brez është bërë në mënyrën më autentike që mund të bëhet,

të paktën deri në fëmijërinë time (deri tek im bir nëpër tre shekuj). Vargjet e para që kam mësuar kanë qënë: “Ka thanë frati /Shko ke shtrati/ N’mos t’marrtë gjumi / T’pushon shtati.” Mbrëmjeve kur kotoshim rreth votrës, gjyshja na i këndonte lehtas këto rreshta për të na thënë se kishte ardhë koha të flinim.

Kur më merrnin prindërit me vete nëpër dasma, kënaqësia ime më e madhe ishte kur i zoti i shtëpisë merrte në dorë çiftelinë dhe e drejtonte nga sofa e parë. E dëgjoja me endje dhe fiksoja portretin e këngëtarit, të cilin sido që të kishte kënduar, e kujtoja si njeriun e veçantë të dasmës. Kishte mjaft raste kur dasmorët pasi uronin: Të knoftë zemra, thonin: Sa bukur e ka qit (e ka krijuar) , ashtu ka qënë sak, bash si i ka ba fjalët (vargjet). Kështu mësova se kishte këngëtarë që këndonin fjalët e të tjerëve dhe që bënin fjalët dhe i këndonin vetë, e thënë tjetërsoj rapsodë tipikë. Kjo ishte sa i përket epikes. Oreali i dasmës ishte shumë më i larmë.

Grania lirshëm e gëzueshëm ia merrnin këngës , ku shpalosej lirizmi brilant dhe humori i hollë. Jo rrallë aktohej. Të gjithë orealin e kanë krijuar, ruajtur dhe pasuruar gratë rapsode. Në Mirditë, bartet femra, kryesisht janë përmendur si vajtimore e është lënë thuajse në harresë poetja e dasmës. E kush tjetër përveç asaj i ka thurë vargjet? “Ba me di sa fort të due/ Shet martinën e më merr mue”, ose: “Nuk kam pak me t’pa me sy /Jo me ra e me u qu me ty” etj. (Shpresoj se një ditë ky oral të derdhet në plumbin e shkronjave, i plotë e i begatë siç është). E çmoj të vlerë që, për të dalë tek kontributi im modest, të shtoj edhe diçka tjetër. Në fillim të viteve ‘60 të shekullit të 20-të, Kurbneshi u bë një qendër e rëndësishme e industrisë së bakrit. U ngrit një qytezë që më vonë u shpall qytet. Kishte shtëpi kulture, kinema dhe bibliotekë. Kësodore filloi lëvizja amatore dhe u ngrit grupi i parë folklorik. Në këtë lëvizje u përfshiva që i vogël, në fillim si recitues, bashkë me poetin Preng Maca e muzikantin e talentuar Servet Cara etj.

Asohere në këtë qytet vinin gazetarë, shkrimtarë, poetë dhe artistë të përmendur të skenës shqiptare. Kujtoj këtu, Dh.Shuteriqin,

K.Jakovën, Ll. Siliqin, Gjergj Zhejin, T. Milotin, Gj.Becin e të tjerë. Ansambli shtetëror i këngëve e valleve vinte me Krajkën, Zekthin, V. Zelën. F.Rexhën, estrada e Shkodrës, por edhe teatri "Migjeni" me emrat e mirënjohur T. Banushi, J.Alia, T. Kurti, Gj .Vasia, R. Ljarja, etj. Të gjithë këto emra të mëdhenj janë ngjitur asokohe në atë skenë të vogël. Të gjitha këto shfaqje i kam ndjekur.

Në këtë mjedis më lindi dëshira e madhe të bëhem artist i vendit tim, kur isha nja dhjetë a njëmbëdhjetë vjeç. Një shtysë të veçantë më dha edhe takimi me shkrimtarin e poetët e njohur Kolë Jakova, Tonin Miloti, Gjokë Beci, etj.

Mbasi mbarova të tetën klasë nuk më dhanë të drejtë të vazhdoja më tej shkollën. Më dhanë në dorë parmendën, këtë vegël të moçme të lavëtarit për të lavruar tokën e kooperativës...Më bënë më vonë bukëpjeksin e parë të fshatit tim. Nën atë qiell të hirtë të ëndrrës pranë parmendës a magjes së brumit një mik më ndodhej gjithherë njat. Ishte libri, ky visar i paçmuar i shpirtit njerëzor, me të cilin mbetem përjetësisht i dashuruar...

Pas dy vjetësh punë në kooperativën bujqësore të Kurbneshit, nga që kishte dhe mjaft nevojë, dikush u bë fjalëmirë(në çdo kohë ka njerëz të mirë)dhe unë vashdova një shkollë dy vjeçare për ekonomist kontabël. E mbarova shkëqyeshëm, por nuk quhesh shkollë e mesme. Nuk mbahet mend sa pengesa kam pasur për të dhënë lëndët plotësuese. Studimet e larta, për gjuhë-letërsi, i kam kryer vonë, pas viteve '90-të.

Bartët e folkut mirditas dhe atij mbarëshqiptar, tradita e vyer e poezisë shqipe, është shkolla poetike që formoi tek unë atë ndërgjegje estetike, që t'i çmoj këto vlera e të mbështetem tek ato në të gjithë krijimtarinë time. Korifejtë e kësaj tradite; Fishta, Naimi, Çajupi, Lasgushi, De Rada, Serembe, Agolli etj, në themel të krijimtarisë poetike kanë frymën popullore, kumtin e thjeshtë e ndjesinë e thellë.

Sa u përket këngëve autoriale, që janë kënduar pa emrin e autorit, ka qenë ajo pjesë e krijimtarisë që më ka dhënë kënaqësinë më të

madhe. Kur ato janë pëlqyer nga spektatori e ndigjuesi i radios ,ka qenë testi më i madh për mua. Një festë të vërtetë letrare kremtoja kur ato botoheshin nga Instituti i Kulturës Popullore.

Përse këndoheshin pa emrin tim?...

-Dua të harroj edhe pse nuk mund t'i harroj të gjitha....

Pyetje: Ç'përfaqëson veçmas areali i Selitës në këtë kulturë unitare, thellësisht origjinale autoktone: me folkun, ritet, zejet, doket, traditën kishtarë etj. Cilat kanë qënë urat e komunikimit kulturor me zonat fqinje, si Lura etj.

Përgjigje: Selita është njëri nga 12 flamujt e Mirditës. Duke qënë skaji jug-lindor i saj, ajo është kufijare me Matin dhe me Lurën, që edhe pse, kjo e fundit është pjesë e Dibrës, në etnokulturë, e mendoj një zonë të ndërmjetme. Qarkullimi folklorik ndërzonal ka qenë me një intensitet të mjaftueshëm për të dhënë e marrë me njëri-tjetrin . Kjo ka ndodhur dhe ndodh për shkak të marrëdhënieve miqsore me Lurën dhe miqsore e tregtare me Matin. Pazari i Derjanit, por dhe i Lisit të Matit , kanë qënë pika lidhëse për shkëmbime tregtare e që natyrshëm pastaj kanë pasur vajtje e ardhje tek njëri-tjetri për festa, dasma, morte etj. Kësodore Selitasit kanë shpallur në Mat e Lurë këngët e zakonet e tyre dhe ato kanë bërë të njëjtën gjë. Edhe laramanizimi i fesë në disa fshatra të Selitës si Gjoçaj, Lami i Madh, Zajs e Lufaj, i ka shtuar marrëdhëniet e karakterit që përmenda më sipër. Ky proces është i hershëm. Siç na e bën me dije relacioni i ipeshkëvit Mark Skura, në vitin 1641 Selita kishte 1423 frymë të krishterë, gjë që të lë me kuptue se relatori e bën cilësimin “të krishterë”, pasi kishte edhe myslimanë, deomos me pakicë, pra laramanizimi kishte filluar para atij viti, kur shkruhej relacioni, i cili thotë, se Kisha e Shën Lekës (Shënllzhdrit) është ngritur në kodër të Selitës me gurë ku shërbejnë dy priftërinj, etj. Nga ky relacion del se kjo kishë , kishte qënë nën hierarkinë e Dioqezit të Lisit të Matit . Në kufi me Matin, janë fshatrat që

përmenda . Represioni perandorak qe mjaft i egër. Gojëdhëna thotë, se në fshatin Lëkundë i kanë bërë synet burrat në vig të parmendës. Kumonen e Kishës së Shllezhdrit e qëlluen me gjyle. Ajo heshti për pak kohë , derisa Paria e Selitës u mblodh, organizoi qëndresën dhe bëri që kumona të tingëllojë sërish e shërbesa fetare të vazhdonte. Toponimet, “Varri i Sinanit”, d.m.th. i turkut të vrarë, ose “Shpella e Fretërve “ , që ndodhet në majë të Gallit, tregojnë se Selitasit i qëndruan me trimëri rrëbeshit osman dhe nuk lejuan që laramanizimi i fesë të futeshe më në thellësi. Edhe pse ndodhi kështu si e thamë, myslimanë e katolikë kanë bashkëjetuar, duke respektuar mrekullisht njëri-tjetrin.

Pjesa jo e krishterë edhe sot e kësaj dite kremtojnë festat katolike. Gjoçajt, ky fshat krejt mysliman me mbiemra Gjokola, Pepmarku etj., kremton Shënrefin në fillim të muajt nëntor që është një festë katolikësh. Gjurmë të kësaj kisha të Shën Refit duken edhe sot”.

Ndërsa Zajsi e Lufajt, që janë në pakicë mysliman, kremtojnë Shënllëzhdrin. Katolikët nuk bëjnë të njëjtën gjë për festat e myslimanëve, por i respektojnë në mënyrë të veçantë kur shkëmbejnë vizita. Në se një matjan apo dibran vinte për mik në Selitë, i zoti i shtëpisë urdhëronte që në prani të mikut të përvëloheshin enët që përdorëshin për të gatuar e ngrënë, që i ardhuri të bindej se çdo gjë ishte e pastër në lidhje me përdorimin e mishit të derrit, që ata për bindje fetare nuk e hanin. Shumë familje, që për arsytet që thamë u bënë myslimanë, pas do kohe u kthyen në fenë e parë. Këtë e dëshmojnë emrat Prengë, Pjetër, Ali Osmani etj. etj.

Selitasit i jepnin vajzat në myslimanë, por nuk merrnin tek ato.

Në vitin 1983, në fshatin Bardhaj mblodha dy motërzime të baladave të njohura “Kostandini e Doruntina”, që barti ma tregoi me titullin “Të nantë vllaznit që kishin qanë” dhe “Ç’ke Hasime, që po qanë” (Balada e Hasimes).

Kisha mësuar që asohere se G. Majer, të parën këngë të Eposit të Gegëve e kishte mblledhur në Mirditë. Djepi i tij dihet, por mendoj se jo vetëm në Mirditë, por edhe në Mat , e ndoshta më në jug

shtrihet gjeografia e tij. Lahuta qarkullon edhe në Mirditë e në Mat. Ajo që më bëri përshtypje, në baladën “Të nantë vllaznit që kishin qanë”, ishte inercia e bartit katolik , që me çdo mënyrë, heroin e saj Halili, ta çojë në identitetin e vet të krishterë si në moshën e vërtetë të baladës. Ja disa vargje që e dëshmojnë këtë që thashë: E Halilit me m’i thanë/ Besën’e Zotit ku e ke lanë / Ka shkue korbi tu fluturue/ N’kryqë t’ djalit asht’ ndalue...

Pra, Halili, në krye të varrit ka një kryq, si çdo i krishterë. Nëse prozodia poetike në Selitë, nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm, me meloritmin nuk ndodh përherë kështu. Vihet re një interferim i melosit të Matit, sidomos në këngët lirike, tjetër se timbri tingëllon origjinal, duke bërë që prurjet nga Selita në folkun mbarëkrahinor të jenë të dallueshme nga zonat e tjera, si bie fjala, nga Fani, Oroshi e çuditërisht nga Kthella, që në etnokulturë është e tre bajrakëve të Ohrit. Mjaft këngë të suksesshme si “Për liri s’ të fal shqiptari” e Gjok Becit e Servet Carës, të dy nga Zajsi, “Vallja e Zajsit” ku shpaloset një lirizëm i kulluar, por edhe këngët, “Buzë Valmorit”, “Eja, kam një fjalë” të autorëve, Gjokë Beci e Mark Gjoka, janë mbështetur mbi motive burimore të Selitës e, sidomos në rrafshin melodik. Të tre mjeshtrat e këngës janë njohësit më të lavdëruar të këtij areali. Nëse në këngën popullore, Mirdita ka bërë emër në krejt Shqipërinë, në Kosovë e diasporë, proza popullore thuhet se është e lënë e tëra në harresë.

Mendoj se edhe kriteri ideologjik ka qënë një pengesë serioze. Ende nuk është vonë, që ky visar të mblidhet e të botohet. Me prozën popullore kam parasysh gjithë strukturën gjinore të saj, si fabula, rrëfime, përralla, etj.

Krahinat per rreth nesh, si bie fjala, Dibra, ka mbledhur e botuar vëllime të tëra në këtë gjini. Duke lexuar, “Folklor nga Dibra”, të folkloristit të mirënjohur nga Lura, Hilmi Kolgjegja, me të cilin në gjallje të tij më ka lidhur një miqsi e afërt, kam konstatuar se shumë rrëfime e fabula janë burimore mirditase, që ai i kishte mbledhur në Lurë. Unë ja pata thënë këtë fakt, e Hilmiu më qe

përgjigjur: Jemi kufjarë e thonë se kufini - kufinin e han. Ti a i ke parë gratë katolike të Lurës, që vishen si kaurreshat e Mirditës? Edhe mua - pati vazhduar me humor Hilmiu - më quajnë Hilmi, që është emër mysliman, por Kola e Gjegja janë dy, dhe të dy kaurrë. E pata mirëkuptuar mikun tim me lehtësi. Krejt i veçantë në arealin e Selitës është arkivi i tij i nëndheshëm. Këtu nuk është fjala vetëm për xeherorët e bakrit, kromit e metaleve të tjera, që sidoqoftë është shfletuar me mund pa fund, por janë edhe shpellat karstike, që nga ajo e Mërkurthit në kufi me Lurën e gjer tek Shpella e Fretërve në Majë të Gallit, të cilat presin speleologët. Por edhe dy Qafëqytezat e Selitës, njëra në Sorokol e tjetra në Kunorë, presin arkeologët...

Pyetje: Jeni autor i dy librave poetik; “Kam shtëpinë e vogël” dhe “Shira dhe ylberë”, që vijnë pas një krijimtarie të hershme, por të pabotuar, ndërkohë që jeni cilësuar “Poet i kënduar”. Më 1998 libri juaj poetik ishte i pari libër artistik që doli me siglën “Mirdita”, që më pas pati një bum botimesh në poezi, prozë etj.?

Përgjigje: Grekët e moçëm poetët i quanin këngëtarë. Edhe unë jam një këngëtar mirditas, që dikur këngën ma dëgjonin e emrin jo. Ani, përderisa më dëgjonin zemrën.

Ka qënë do kohë në jetën time, që as mendoja që njëherë të isha autor i një libri poetik. Ata që më mbajtën gjallë, frymën e një krijuesi, kanë qënë miqtë e mi që punonin në sektorin e kulturës në Mirditë e jashtë saj. Mundësitë e pakta për të komunikuar me ata që i muzikonin vargjet e mia, kanë bërë që shumë prej tyre të dalin shpejt nga qarkullimi. Përfytyroni që baladën e famshme si “Dasma e Kamber Loshit” ta këndonim me lahutë, a do të kishte ajo suksesin që i dha interpretimi i Grupit të Burrave? Siç mund të jetë vënë re në pjesën e botuar të krijimtarisë, unë nuk jam nga ata që mjerohem gjer në asht, për rrjedhën jo normale të jetës time. Vërtet rinia u ndal pak tek unë, ajo më fluturoi si dallgë mbi krye, por kjo gjë s’ka ndodhur vetëm me mua.

Thuajse të gjithë krijuesit mirditas kanë pasur privime të dukshme. Gjokë Beci e Pal Përlala, që kishin botuar nga një vëllim poetik u ndaluan të botonin, por edhe të tjerë. Zogjtë duan qiell, jo kafaz, se muza nuk mund të heshtë. Dhe nuk heshti ...

Nga vera e vitit të mbrapshtë 1997, u ktheva tërësisht te ëndrra ime e hershme. Zgjedha 50-60 poezi, do prej të cilave i pata shkruar atë vit dhe ia pata dhënë presidentit të shtëpisë botuese, “Mirdita”, shkrimtarit dhe studiuesit të taletuar Ndue Dedaj. Deri aso kohe ky ent botues pati nxjerrë në qarkullim vetëm një libër të shkruar nga një grup autorësh studiues të historisë. Sipër dosjes që mbante poezitë, pata shkruar: “Kam shtëpinë e vogël”.

Klima e çuditshme e ngjarjeve të atij viti kishte bërë që shtëpia jonë e përbashkët, e vogël sa na e lanë të mëdhenjtë në 100-vjetëshin e fundit, po përpihej nga flakët e pushkëve dhe të urrejtjes. Shtëpia e “vogël”, që kishte nxjerrë njerëz të mëdhenj në atë stinë të zymtë, ishte për mua, kryemetafora.

Në shkurt 1998, libri doli në qarkullim. Unë e dorëzova pengun e kaq viteve i pari. Vetëm kaq. Përsa i përket botimeve që pasuan librin tim modest, janë thënë e duhen thënë fjalët e falenderimit të lartë, të merituar pa asnjë drojë. Librat poetik, monografitë, vëllimet me tregime, botimi i Barcatës, Stavri Frashërit, Antologjia e poetëve të Mirditës etj., janë kontributi më i çmuar që i është dhënë kulturës së trevës së Mirditës në tërë historinë e letrave, që për fat të keq nuk pati traditë. Është detyra jonë të pasurojmë atë me botime gjithësesi më cilësore. Garant për këtë është fryma e sinqertë e marrdhënieve mes njerëzve të penës, një frymë, që përbën vlera qytetarie.

Një grup njerëzish idealistë që i janë përkushtuar kësaj fushe më kujtojnë atë që thoshte Korifeu i letrave shqipe E. Çabej, në librin mbi gjenezën e literaturës shqipe kur flet për qarqet kulturore e letrare: “Më së pari na dalin në dukje trajtat e ndryshme, pastaj këto konvergojnë në njësinë literale.

Komponentja fisnore regjionale dhe komponentja fetare, megjithë

jetën kulturore e sociale përkatëse, na japin së fundi rezultanten nacionale”.

Pyetje: Synimi ynë përmes edicionit “Mirdita (intervista)” është dhe të evidentojë e fokusojë, sa të jetë e mundur, bartës, profile, individualitete të traditës popullore, në rastin e këngës; poetë, rapsodë, këngëtarë, vajtimore, etj. A mundeni të skiconi disa prej profileve të tyre?

Përgjigje: Synimi juaj është i drejtë dhe vizionar. Kam rastin të vlerësoj punën e mundimshme, por të frutshme, që keni bërë me vëllimin e parë të edicionit “Mirdita”. Vijimin e kësaj sipërmarrje e çmoj gjithashtu si një kontribut qytetar të një studiuesi a shkrimtari të përkushtuar.

Mirditasit janë artistë në mënyrën se si e shtrajnë një ide, apo se si reagojnë ndaj një qëndrimi ndryshe. Ata, urtësisht e kërkojnë fjalën dhe, duke aktruar pak, tregojnë një fabul, a një ngjarje të ndodhur diku, për t’i bërë me dije mjedisit, a thjeshtë partnerit bindjen e qëndrimit të tij rreth diskutimit të hapur apo që kërkohet të hapet. Tradicionalisht, kur takoheshin me njëri-tjetrin (ky zhargon përdoret dhe sot), pyesin se si je? Partneri përgjigjet: Gjallë. Një fjalë, që në mënyrë emocionale paraqet një gjendje mbijetese me ngarkesa jo të rëndomta. Mirditasit i dinë ato që quhen “Fjalët e rakisë”, ose ndryshe hapja e një ceremonie. Herët, por edhe sot pasi lavdërohet Jezu Krishti bahet një urim krejt i fillikatshëm: “Shumë jetë bashkë!”. Mjaft e bukur, apo jo?. Mirëpo në librin “Përmes Mirditës në dimër” të Stavri Frashërit, pikërisht kjo fjalë nuk shkruhet në ritualin e pijes. Po kështu tek “Brenga e Ballkanit” të Edit Durhanit shkruhet: Kthella përbëhet nga tre bajrakë: Kthella, Selita dhe Perlati. Udhërrëfyesi, a ndonjë i pranishëm ia ka dhënë gabim Inglizes së njohur të dhënat për tre bajrakët, pasi Perlati është qendra e Kthellës e jo bajrak. Bajrak është Ranxa dhe jo Selati, por Selita.

Ribotimi i këtyre veprave të rëndësishme duhet përcjellë me shënimet e duhura, ashtu siç ka ndodhur me romanin “Lule”, të Barkatës, apo “Përmes Mirditës në dimër”. Në këto që ju thashë, dua të nenvizoj faktin se, më mirë nga etnologët, historianët e studiuesit e folkut mirditas nuk mund ta bëjë tjetër. Kontributi i etnologut Dr. Mark Tirta në këtë lamë, tashmë, është një vlerë nacionale dhe një pikë referimi për pasardhësit e tij. Para se ai të bëhej etnolog i madh e i dëgjuar, është bard i madh, bir i këtij relievi, ku më mirë se kudo është ruajtur autenciteti dhe pastërtia genetike. Besoj se filluam të flasim për atë që më pyetët, për personalitete, bard e profile? Çdo katund, herët a vonë ka pasur dhe ka këngëtarët, rapsodët, vajtimoret e kuventaret e tij. Flamuri ka pasur panteonin e vet. Unë mendoj se pionierë të folkloristikës në krahinën tonë kanë qenë klerikët filologë, ku mund të veçohet, Dom Prend Suli. Mbas luftës dytë botërore, por edhe gjatë saj u evidentuan disa poetë popullorë si, Mat Doda e ndonjë tjetër.

Organizimi i festivaleve folklorike e i ekspozitave të herë pas hershme, identifikoi bartës, poetë, këngëtarë dhe instrumentistë, që u bënë të njohur në gjithë vendin. Spikat në mënyrë të veçantë krijimtaria poetike e mjeshtërit të këngës shqiptare, poetit të njohur Gjokë Beci. Kompozimi, që ai i bëri poemës folklorike të ansamblit “Mirdita”, Gjirokastër, 1978, është ndër arritjet më të larta jo vetëm të autorit, por dhe të poezisë popullore mbarëshqiptare. Vargjet lapidarë të kësaj poeme u përhapën rrufeshëm në krejt Shqipërinë, në Kosovë e diasporë, ani se ndonjë herë për defiçensa profesionale disa nga këto këngë u parodizuan.

Në këngët autoriale të këtij autori nuk e ndan dot poetin nga rapsodi dhe rapsodin nga poeti. Një unison me timbrin origjinal epik e ndonjëherë epiko-heroik. Kjo krijimtari u ngrit gjithnjë nga festivali në festival, deri tek cikli i mrekullueshëm i këngëve të gjakut për Kosovën. E begatë dhe e lauruar disa herë është krijimtaria e tij me këngët e festivaleve në RTSH, duke u ngjitur kështu tek emri mjeshtër e duke bashkëpunuar me emrat më të shquar të muzikës

shqiptare. Po ju tregoj një episod: Në një fjalor enciklopedik , kur shkruhet për biografinë artistike të Artistit të Popullit, Gaço Çako, thuhet se një ndër arritjet më të mëdha të tij në muzikën vokale është edhe kënga “Rrjedh në këngë e ligjërime”. Tekstin e kësaj kënge e ka shkruar para shumë vitesh poeti Gjakë Beci.

Në vitet 60-70 të qintvjeçarit të kaluar, spikat dukshëm edhe krijimtaria dhe interpretimi i Fran Vorfit, Kolë Zefit, Jak Tucit etj. Për tu pasuar më vonë me dy nga muzikantët më të talentuar të Mirditës, Mark Gjoka e Servet Cara.

Assesi nuk mund të lësh pa përmendur Grupin e Burrave e në veçanti, Ndue Përkolën, që jeta ju ndal para kohe. Ndue Nikollë Gega, pjesëmarrës i disa festivaleve kombëtare, ka kënduar me pasion këngën humoristike të Mirditës. Lahutari, instrumentisti virtuoz, Simon Beleshi, luante në të gjitha veglat muzikore të traditës së Mirditës (pipës, lahutë, çifteli, kavall, fyell). Do të ishte e padenjë të mos përmend këtu mikun tim të penës dhe të privimeve, poetin e talentuar, të ndjerin Ndue Kola nga Kaçinari. Në 1988, veç të tjerash, ai shkroi baladën, “Nuse e bukur t’ka dal motra”. Në 16 vargje e ngjeshi me mjeshtëri gjithë dramën e nuses së Shtufit, që ndërroi jetë në udhë pa shkuar në shtëpinë e dhëndrrit. Unë mendoj se vajzat e gratë mirditore kanë shpalosur me origjinalitet e mjeshtëri këngën e krahinës. Këtu mund të përmend, Luljeta Përbashën, Mrika Trumshin, Gjyste Cekën, Prena Beleshin, Prena Becin ,etj. Megjithë këto kontribute të vyera, asnjë nga këto profile, bartës, poetë, këngëtarë, nuk është propozuar të bëhet ,”Artist i merituar”, që unë them së disa nga këto e meritojnë. Më mirë të kesh disa artistë të merituar, se disa politikanë të përkëdhelur.

Pyetje: Po jashtë Mirditës administrative, cilët mendoni se janë përfaqësuesit më cilësorë?

Përgjigje: Harta administrative e Mirditës ka pasur disa ndryshime pas luftës së dytë botërore. Arsyet mendoj të kenë qënë politike.

Kështu zona e Fanit ishte për disa kohë me Kukësin, Selita e Rranxa me Matin. Po kështu, një pjesë ju kalua Lezhës, Pukës, Biles dhe Dibërës disa fshatra. Kësodore, unioni i dymbëdhjetë bajrakëve u tjetërsua, por areali si krahinë, si etnokulturë mbeti i pa krisur në kuptimin e ruajtjes së folkut e fondit dokësor. Aktualisht, nocioni rreth ka rënë. Studiuesit mirditorë po bëjnë e duhet të vazhdojnë të bëjnë përpjekje, që areali i krahinës të fokusohet në punimet e tyre si i tërë. E çmoj si shumë të rëndësishme se mirditorët janë mjaft të ndjeshëm në këtë vështrim. Në veprimtaritë folklorike Kombëtare, pjesa jashtë kufirit administrativ, është përfaqësuar me emra të mirënjohur. Instrumentisti virtuoz, “Artisti i Popullit”, Ndue Shyti nga Gojani i Dheut të Spaçit është, po kështu, “Artisti i merituar”, Frrrok Haxhia dhe Ded Ndue Lazdri, janë mirditas. Kësaj treve etnokulturore i përkasin edhe emrat e Gjin Shkozës, Dava Gjergjit, etj.

Këto profile, që përmenda dhe pse kanë përfaqësuar pakicën në rrethet e tyre, kanë pasur vlerësime mjaft të larta, ndryshe në Mirditën rreth. Vlerësimi zyrtar ju bë ansamblit, që i dhanë shkëlqim të veçantë folkut të trevës. Nuk është vonë të rishikohen vlerësimet e personave të veçantë, t’u bëhen nderimet që meritojnë.

Pyetje: “Grupi i Burrave” dhe “Trioja Lirike”, dy formacione karakteristike të këngës mirditore, me jehonë kombëtare e më gjërë. Ç’përfaqësojnë në vetvete dhe sa ju si krijues keni qenë i lidhur me to?

Përgjigje: Edhe “Grupi i Burrave” edhe “Trioja Lirike” e Rubikut, janë dy formacione vokale-instrumentale, më të suksesshmet në jetën koncertale të Mirditës të të gjithë kohërave. Ajo çka i veçon nga njëri-tjetri kuptohet lehtë. I pari është i rrafshit epik, por dhe liriko-epik, ndërsa treshja është krejt lirike. Formacioni i trios është ngritur pas Grupit të Burrave nga dyshja Gjokë Beci e Mark Gjoka, së pari në Rubik, ku punonin edhe këngëtarët Anton Gjoka e Dodë

Prendi. Suksesi i saj ka qenë i menjëhershëm e i pakontensueshëm. Mjafton të përmendim se kënga “Buzë Valmorit” ka pasur me dhjetra interpretime, deri tek kantautori Ardit Gjebrea, që e ka kënduar edhe në spektaklin “Miss Bota”. Ende kjo këngë nuk mund të quhet këngë qytetare shqiptare?

Ky formacion, veç të tjerash shpërfytyroi atë mendim që ishte ngulitur në disa qarqe muzikore se kënga mirditore është marciale dhe vertetoi sakaq, se nga shpirti mirditas buron një lirizëm i ngrohtë dhe i kthjellët. As kjo trio nuk ka lindur nga hiçi. Themeli i saj është kënga lirike e krahinës. Lidhjet e mia me këto dy formacione janë së pari shpirtërore. Së dyti Grupi i Burrave ka kënduar disa nga këngët e mia në festivalet folklorike që nga viti 1988 e deri në Fest-Folk Gjirokastër 2004

Kam bashkëpunuar thuajse me gjithë krijuesit mirditorë por më të suksesshme kanë qenë bashkëpunimet me Mark Gjokën, Servet Carën, Kol Zefin, Mark Gjonin e tjerë. Ka vite, që puna që kam kryer nuk ka qenë fort e favorshme për tu marrë me këngën, por dashuria e parë nuk harrohet...

Gjon Marku: “Mirdita, intervista 2”, 2002

Shenime per libra

MUZGU
SHTEPIA BOTUESE



DËSHMI TË MENDIMIT TË SOTËM PËR HISTORINË, ETNOKULTURËN, BOTIMET DHE JETËN REGJIONALE TË MIRDITËS

Edicioni “Mirdita (intervista) I, II, III” i studiuesit dhe tregimtarit mirditas Gjon Marku është një kontribut i çmuar në udhën e përpjekjeve për të ridimensionuar vlerat më të spikatura të historisë dhe etnokulturës së Mirditës, e cila zë një vend të rëndësishëm në relievin e zhvillimeve gjithkohore e mbarëshqiptare. Areali i saj për vetë pozicionin gjeografik në Shqipërinë e Epërme ka ruajtur në mënyrën më konservative vlerat autentike të folkut, të së drejtës dokësore, në ravën e krishterimit dhe elementet vetëqeverisës të saj.

Më heret se sa sot, studiuesi dhe botuesi i tij, Ndue Dedaj, e ka quajtur këtë edicion me të drejtë, “bashkëbisedim i gjërë kulturor për Mirditën.” Autori Marku pasi ka njohur hulumtimet e mjaft dijetarëve të huaj për këtë trevë, të klerikëve dijetarë vendës Prend Suli, Nikoll Kimza etj, si dhe të studiuesve të sotëm prof. Dr. Mark Tirta, dr. Pal Doçi, Kol Shtjefni, Dr. Nikoll Toma, Simon Prendi, Ndue Dedaj, Nikoll Doda etj., ka vënë re se opinionimi do të mirëpriste në faqet e një libri mendimin e sotëm të studiuesve, shkrimtarëve, sidomos të atyre që i shkruan veprat e tyre me motive nga kjo krahinë e që për fatin e mirë nuk janë të paktë, të publicistëve, klerikëve, diplomatëve dhe studiuesve të huaj që e vizituan Mirditën në dhjetë vjetshin e fundit dhe ja përse: Së pari, kufizimet në trajtimin e mjaft aspekteve të historisë si roli i klerikëve dhe i klerit katolik në terësi.

Së dyti, vendi dhe roli i derës princërore të Gjomarkajve në historinë e kësaj treve dhe në krejt Shqipërinë e Epërme.

Së treti, këndvështrimi i sotëm për Kanunin e Maleve si vlerë fundamentale e se drejtës dokësore shqiptare, për të cilën ka pasur dhe ka mendime të ndryshme.

Autori, me guxim e zell të lavdërueshëm, ka vijuar punën për sendërtimin e një antologjie të Mendimit të sotëm për Mirditën,* duke bashkëbiseduar lirshëm me personalitete të kulturës kombëtare, studiues mirditas, por dhe të huaj dhe ia ka arritur më së miri qëllimit, që i ka vënë vetes, për të përfshirë një gjeografi autorësh, që ngërthen gjithë hapsirën shqiptare.

Gjon Marku, ka lindur në Gëziq, bash aty, ku Dhimitër Shuteriqi, rizbulon në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar Mbishkrimin Epigrafik të Arbërit (Ndërfanë). Troket herën e parë në derën e profesorit të nderuar dhe ai i jep autorit një ndër intervistat e fundit të jetës së tij, duke ripohuar se, Mirdita është një krahinë nga më qëndroret të shtetit të Arbërit sidomos në vitet 1190 –1216. Prof. Jup Kastrati, që nuk jeton më, i pyetur se ç’përfaqëson Abat Doçi në Rilindjen Kombëtare, ai bën një shpalim të saktë mbi një studim për topografinë e Lezhës botuar, në nëntor 1885, te “Flamuri i Arbërit” i De Radës, ku sqaron disa toponime dhe të dhëna mbi onomastikën. Akademiku, Zef Mirdita, me origjinë të hershme nga kjo krahinë, e quan dheun e të parëve të tij, “shtyllë të katolicizmit, mbrojtëse të identitetit kombëtar.” Prof. Jorgo Bullo pohon se kronisti i kryengritjeve të maleve dhe poeti demokrat, Risto Siliqi, ka të drejtë kur e quan Mirditën “I Arbëris’ Fis i kryekreut” dhe se ajo është minierë e pashterrur vlerash kulturore. Tek shfleton librin e parë të këtij edicioni prej tre vëllimesh, studiuesi i përmendur Moikom Zeqo nënvizon se, minierat dhe teknologjia e shkrirjes së mineraleve janë dy të dhëna të padiskutueshme në ekuacionin kulturologjik të pirustëve ilirë e, që zë vend kryesor në historinë e Europës si kontinent dhe si qytetërim.

Ishte e natyrshme, që në këtë libër, do të jepnin mendimin e tyre dhe

studiues, krijues dhe publicistë mirditas. Kështu, Prof. Dr. Mark Tirta, pasi flet për impresionet e tij gjatë eksplorimeve në terren, bën një pasqyrë të vendit që zë Mirdita në shkrimet e të huajve dhe si e kanë bërë atë shumë të njohur në botën e jashtme. Huluntuesi i dokumenteve arkivore, Dr. Pal Doçi, përpos vlerësimeve për Abat Doçin, Ambroz Marlaskajn, Preng Marka Prengën, vëren se disa botime në fushë të drejtës zakonore, më fort kanë prishur se kanë ndrequr punë në këtë lamë dijesh. Poeti i njohur, Gjokë Beci, evokon kontributin e lavdërueshëm të bartësve e krijuesve të krahinës së Mirditës, në festivalet folklorike kombëtare në vitet '70 e deri sot, duke zënë një vend nderi në këto veprimtari.

Publicisti, Frrok Çupi përveç metaforës brilante të mallit për vendlindjen dhe bukuritë e saj, kthjellëton se krahina e tij, që nuk ka pranuar pushtimin 500- vjeçar otoman, ka ruajtur pastërtinë e rracës dhe se kjo është një ndër arsytet, që albanologët e huaj, kanë treguar interes për përshkrimin e veçorive të kësaj rrace, që rron në një "oaz katolik" i rrethuar me popullësi myslimane, ku vëren se jo gjithëherë, është ruajtur pastërtia katolike.

Edhe pse në vlerësimin për derën princërore të Gjomarkajve, ka patur dhe ka gjykime të ndryshme, në intervistën e tij, Ndue Dedaj thotë se, "Nuk ka Mirditë të bardhë e Gjomarkaj të zezë, edhe pse pa dyshim ka pasur zgjidhje të gabuara, dilema e gabime të krerëve tradicionalë, si kudo, kjo derë ka bashkëqeverisur dhe nuk ka sunduar si krerët feudale të fushës. Preng Bib Doda që ministër biles dhe nënkryetar qeverie bash atëhere kur hidheshin themelet e shtetit shqiptar".

I pari Ipeshkëv i Dioqezës së Rrëshenit, Angjelo Massafra e quan Mirditën "shtëpi të katolicizmit". Administratori Apostolik Cristoforo Palmieri, flet në libër për punën baritore si dhe për impenjimin dhe zellin për të rindërtuar kishat e rrënuara nga shteti ateist deri tek Katedralja e re në qytetin e Rrëshenit. Ipeshkvi ndihmës i Shkodrës Zef Simoni, me prejardhje të hershme nga Mirdita, i quan mirditasit, shqiptarë të kulluem dhe kontributin e

shumë personaliteteve të saj të rëndësishëm, për mbarë kulturën kombëtare.

Në librin e dytë autori bashkëbisedon me Akademike Andromaqi Gjergjin, e cila jo vetëm cilëson se Mirdita ishte një trevë e begatë për gjurmime etnografike, por vlerëson edhe punën studimore të Nikoll Lokës, Nikoll Gjonit, Preng Gjikës, etj. Kolë Jakova, poeti dhe dramaturgu i njohur, vetëm pak ditë para se të ndërronte jetë, dëshmon në intervistë se, të parët e tij ishin nga Repsi i Mirditës dhe se gjuha e këtyre anëve ishte gjuha e tij dhe e veprës së tij letrare.

Peter Bartl, Profesor në Universitetin e Mynihut, njëherësh historian dhe albanolog i njohur gjerman, e cilëson Mirditën si krahinën më të madhe të bashkuar në Shqipërinë veriore, ndërsa Profesor Ismet Elezi e konsideron atë si “Atdhe të Kanunit të Lekë Dukagjinit”. Imzot Rrok Mirdita pohon më krenari se Mirditasit e kanë ruajtur të paprekuar pasurinë shpirtërore.

Dëshmitë arkeologjike nga Mirdita, janë pika referimi për gjithë zhvillimin historik, shkruan ndër të tjera, Profesor Myzafer Korkuti. Interesante shpaloset në këtë libër intervista e Prof. Aleksandër Dhimës, me të dhënat antropologjike të Mirditës dhe banorët e saj. Profesori mirditas, Pal Nikolli shkruan mbi rrugët e vjetra, rrjetin rrugor tradicional të Mirditës dhe perspektivat e zhvillimit të tij në kohën e sotme.

Për profile të krijuesve mirditorë në botimet e entit botues të kësaj treve (“Mirdita”), që për fatin e mirë kanë qënë të begata, Bardhok Pulaj, botuesi i një gazete shkollore dhe i një libri mbi Mirditën, bën një pasqyrë të vlerave që sjellin në prozë e në poezi: Gjok Beci, Ndue Dedaj, Preng C. Lleshi, Gjon Mark Ndoj, Zef Zefi, Viktor Gjokolaj, Preng Macaj, Ndue Gjika, etj. Të njejtën gjë ai bën edhe për shtypin lokal të kësaj treve.

Lidhjet etnokulturore me trevat përreth siç është Luma, i ka trajtuar Dr. Shefqet Hoxha, në intervistën e tij. Mentor Quku, si biograf i poetit të madh Ndre Mjeda, e quan të nderuar Mirditën, që i ka dhënë kombit një personalitet të tillë kulturës kombëtare.

Mikel Prenushi ,që dhe më heret ka shkruar se Gazullorët dhanë një kontribut shumë të çmuar në Rilindjen Europiane, rithekson, duke vërtetuar se këta humanistë, dijetarë, ambasadorë të Skëndërbeut, ishin mirditas.

Kështu, në këtë bashkëbisedim të lirë që autorit i ka kushtuar shumë mund, lexuesi ka të arkivuar mendimin e sotëm mbi historinë, etnologjinë, folkun, traditën dokësore, botimet, jetën regjionale të Mirditës si dhe vlerësime mbi dukuritë e reja bashkëkohore.

Në këtë vëllim të tretë të këtij edicioni, të tjerë të intervistuar si, At' Zef Pllumi, Vili Kamsi, Akademik, Mark Krasniqi nga Kosova, sjellin gjykime, fakte dhe opinione kulturore e shkencore me mjaft interes. Prof. Krasniqi nënvizon se, në Mirditë studiuesi i dokeve e zakoneve, i veshjeve popullore, i letërsisë gojore si dhe i shumë dukurive të tjera etnografike, gjen një burim të pashtershëm. Zef Pllumi, ky prelat i kishës katolike, shprehet se, Mirdita është zona më aktive në të gjithë vendin për kryengritjen kundër turqve dhe për independencen e vendit. Studiuesi, Musa Kraja vlerëson se, mirditasit janë arsimdashës të mëdhenj dhe veçon kontributin e mësuesit iluminist, Ndrec Ndue Gjoka. Arkeologu i njohur Neritan Ceka, pohon se Mirdita, lugina e Matit, dhe e Drinit, ishin boshti i Arbërit të herëshëm. Po kështu, Anton Fistani, anëtar i Akademisë së Shkencave të Nju Jorkut, sjell dëshmi të reja për historinë e Mirditës, të nxjerra nga arkivat e huaja dhe nga hulumtimet e tij në terren, në Blinisht.

Mendime dhe mbresa mjaft interesante sjellin në këtë libër shkrimtarët e mirënjohur, Pjetër Arbnori e Dritëro Agolli, por dhe gazetarja e TVSH Ariana Qatipi, që një pjesë të jetës e kaloi në Mirditë. Ndërsa poeti dhe publicisti Mark Marku, nënvizon se, e krijuar në fillësën e saj nga priftërinjtë, kultura shqipe lindi si përëndimore dhe formësohet si e tillë. Pedagogjia mirditore Dava Përlala argumenton jo vetëm për intiligjencën fluide, por edhe për inteligjencën e kristalizuar të mirditasve.

Përmbledhja “antologjike” “Mirdita (intervista)”, duke mbajtur

në fletët e saj me dhjetra pyetje të autorit drejtuar afro 50 personaliteteve, në fusha të ndryshme të dijes, ku natyrshëm mund të ishin intervistuar edhe të tjerë, ka fokusuar përmes përgjigjeve, mjaft aspekte të ndryshme të historisë dhe etnokulturës dhe jam i bindur se nga viti në vit, do të çmohet përherë e më shumë, duke u bërë pikë referimi për studiuesit e ardhshëm dhe jo vetëm të Mirditës.

Në fund të këtyre rradhëve, për autorin do të them atë, që aq bukur ia ka thënë atij, shkrimtari i shquar Dritëro Agolli: “Së fundi dua të them se edhe ti, i dashuri Gjon Marku, hyn në veprimtarët e dalluar për vlerësimin e historisë së Mirditës, histori, që është pjesë e pandarë e historisë së kombit shqiptar.” *

* Pas botimit të tri vëllimeve me intervista, kolana u botua nën titullin ‘Antologji e Mendimit të Sotëm për Mirditën’, ekstrat i nxjerrë nga ky shkrim.

** Mbajtur në promovimin e librit
“Mirdita-intervista 1,2,3” në
Muzeun Historik Kombëtar ,
në Tiranë më 08.06.2004.*

POETI REPORTER

Shënime rreth vëllimit “Ajsbergu i Hanës”, të poetit Ndue Dedaj

Mirdita, me qëndresën e historinë e vet, me një relief epik, në pamje të parë të ngjan se kënga e saj është një marsh luftarak. Por, nuk është aspak kështu. Nga shpirti i shkrihtë i mirditasit, rrjedh një lirizëm i kulluar . Këtë nuk e provon vetëm folku i saj i pasur, por edhe mjaft botime të traditës dhe ato bashkëkohore.

E sjellin këtë lirizëm edhe librat, që ka nxjerrë në qarkullim shtëpia botuese “Mirdita”, vitet e fundit.

“Ajsbergu i Hanës”, i poetit Ndue Dedaj, është njëri nga këta libra, që sapo është publikuar. Nëse autorin lexuesit e kanë njohur prej motesh nëpëmjet dhjetra e dhjetra shkrimesh publicistikë si: esse, reportazhe, skica dhe mjaft artikujsh që lidhen me studimin e vlerave etnokulturore të trevës, ai ka takuar njëkohësisht reporterin poet. Kjo, se në keto shkrime, ndjehet kumti poetik. Tek “ Ajsbergu i Hanës”, lexuesi ka përpara poetin reporter. Kjo vërehet kjartë në larminë e motiveve, që sjell në pesë ciklet e vëllimit jo si kronikë e realitetit, por si impresion i përfutur nga e përditshmja.

Hëna, ky idil i lashtë i poetëve, herë si fytyra e bukur e një vajze, herë si fytyra e verdhë e një kufome, herë misterioze si vetë nata, kur mungon shkëlqimi hënor, është një plan i poezisë. Mes natës me hënë dhe natës pa hënë, qëndron ajsbergu në ajrin e ngrirë...

Përtej asaj që shohim nuk janë vetëm ,“zotat e lashtë”, por edhe

“mbretëria e të vërtetës”. E vërteta, që mbretëron fare pranë nesh dhe po aq larg njëkohësisht. Imazhi poetik rrok paqen e rreme, ku “mbijnë cubat” e ku, “humbasin lulet”; të dielën, që “zgjohet” nga çangat e shkopinjve/ mbi qilima, tapetë, çarçafë...

Sa shumë pluhur i thatë

I lagësht

Sa shumë baltë...

Mbretëria e së vërtetës së hidhur, e bën poetin reporter të “ ikë udhës së madhe nga bie shi, shi. Udhës, ku gjamojnë gjamëtarët/që ngrenë nga varret të vdekurit/por jo nga vdekja të gjallët!...Ikën udhës me krisjen intelektuale mbi vete, për t’i rënë lirshëm një kambane. Zërat e vjeshtës e ndjekin nga pas, e pyesin për nënën, pranverën, vajzën. Nuk ndalet udhës me shi, me “librin e mungesave”nën stjetullën e stinës me mjegull, me shpirtin , që i dhemb mes njerëzve të kallur në “kullën moderne të ngujimit”- lojrave të fatit.

Ecën...

Në muzgun e rrëzuar ikën dhe njeriu, dhe kali i nuses me një baladë mbi shpinë si një lajtmotiv tragjik. E ky tragjizëm sikur s’ka ditur të pushojë:

Tubull-tubull moti

Pika-pika loti.

Poeti i “ mëngjezeve të thinjura” e kërkon ndryshe pagëzimin e shekullit të ri.

Në emër të Atit, Birit, Dashurisë njerëzore, që pëllumbat të mos trishtohen më nga “Përroi i thatë”, as kuajt, që tallen me natën solmne të njerëzve: ”Ne s’kemi faj/Ne jemi kuaj...” Vibrimi poetik dhe nënteksti filozofik të grishin të meditosh. Poeti ka një zot. Dheun. Ndërsa i falet atij ndjen se “gjysma tjetër e vetes”, dridhet tash njëqind vjet e përndarë, nën tingujt e kitarës së Jusuf Gërvallës, poezitë e Ali Podrimjes, kullat e Anton Pashkut, nën harqet e “Ylberit të Çamërisë”...

Edhe pse poezia është shkruar në një hark të gjatë kohor, ajo vjen e freskët në sofrën poetike, me një leksik të begatë e një lirizëm

karakteristik. Ndue Dedaj vjen në poezinë shqipe nga publicistika si shumë poetë të tjerë të vendit tonë.
Vjen me identitetin e poetit reporter.

Gazeta „Mësuesi“, 3 mars 1999



TOKA E KATEDRALEVE, NJË LIBER PANTEONI

Mirdita, ky toponim i çuditshëm, trevë e unionit të dymbëdhjetë bajrakëve të saj, i ka dhënë historisë së popullit dhe shtetit shqiptar, mjaft ditë të mira me plot shkëlqim. Ndërfana, porta e maleve epike, ruajtja në gjirin e saj , dy thesare unike: Stemën me shqiponjë të shtetit të parë të Arbërit dhe Arkitraun në Bazilikën e Shna Premtes, me mbishkrimin kushtuar këtij tempulli, Sundimtari i Arbërit la me testament ndërtimin e një kisha kryesore, ndaj me të drejtë mendohet se Mbishkrimi i Gëziqit mund të hedh dritë mbi princërit e Arbërit e viteve 1190 – 1216 dhe epiqendrën e shtetit të tyre.

Por, ndër vlerat më të vjera historike e kulturore të Mirditës është rava e Krishtërit. Kësaj teme qendrore të historisë e qëndresës së saj i ka i kushtuar vemendje të veçantë edhe publicisti e studiuesi i njohur, Ndue Dedaj.

Pas një pune të lodhshme hulumtuese dhe eksplorimeve në krejt arealin etnokulturor, këtë vit ai botoi studimin “Toka e katedraleve”, i cili ndriçon punën e jashtëzakonëshme të Klerit Katolik në Shqipëri e veçmas në Mirditë, këtë fortesë të pathyeshme të Krishtërit e Kishës Katolike Shqiptare. Pa medytshje kjo e bën atë një libër panteoni, në këtë lamë.

Jo vetëm kaq. Kompozicioni interesant dhe gjuha e zgjedhur, fraza e zhdervjelltë, janë vlera të tjera të librit. Studimi nuk është vetëm një sintezë, por edhe një analizë imtësore, ku qartasi, rava e Krishtërit fokusohet që nga shkrimet e klerikëve dijetarë,

Gazullorët e famshëm e një varg margaritarësh të letërsisë e të kulturës nacionale, si: Pal Engjëlli i “Formulës ë Pagëzimit”, Buzuku i “Mesharit”, Budi i “Doktrinës ë krishterë”, Bogdani i “Çetës së Profetëve”, hartuesi i memorandumit të mirditasve, poeti i madh, Ndre Mjeda, mjeshtër i tingëllimës. I përndritshmi Prend Doçi , abati , që me vjerrshat e thekura: “Një kushtim shqyptarëve dhe “Shqypnia nën zgjedhë” , i priu letërsisë së Rilindjes, do bëhej njëri ndër propogandistët më të shquar të kohës së vet. Mbi veladon i shkëlqente kryqi, në dorë pena e prehtë , në buzë fjala e shenjtë e meshtarit poet, që lëshonte kushtrim për atdhe, në brez nën petkun e klerikut rrinte ngjeshur arma e luftëtatarit të lirisë e Pavarësisë. Është rast i rrallë , kur një klerik drejton kryengritje të armatosur , ashtu si bëri Doçi, në kryengritjen e Mirditës të viteve 1876 – 1877, çka do i kushtonte 11 vjet internime në tre kontinente. Ai themelon shoqërinë “Bashkimi” Shkodër, më

1899, e cila,bashkoi rreth vetes personalitete të spikatur të kohës. Si abat, bashkë me Parinë e Krahinës, sidomos me mbështetjen e Gjomarkajve, ringriti Abacinë e Oroshit, që e shtriu juridiksionin e saj në gjithë trevën. Jo vetëm Abacinë , por dhe shkollën e parë shqipe(1899), do ta kishte Oroshi, kjo qendër mjaft e përmendur për zhvillimet historike ne Veri.

Klerikë të ardhur nga krahina të tjera apo vendas, si Gjeçovi, Marlaskaj, Kimza, Suli etj, si shkrimtarë, etnologë e filologë, do të ishin bashkëpunëtorë të shtypit më në zë të kohës. Nga Rubiku e Gomsiqja, ku shërbente, Gjeçovi do ti dergonte shkrime “Albanies “ së Konicës. E dëshmuar edhe prej ti se lëndën kryesore të Kanunit të Lekë Dukagjinit e mblodhi prej bartësve të Mirditës.

Duke cituar si monumentet më të rëndësishme, katër abacitë e vjetra: Shën Llezhdri e Oroshit, Shën Palin, Shën Mërinë e Ndërfanës dhe Shelbumin e Rubikut, harta e kishave me rëndësi ngërthen gjithë krahinën . Studimi ,“Toka e katedraleve“, qet në dritë , gjithashtu , përpyekjet e klerikëve për konsolidimin e kishës shqiptare,

identitetin nacional. Kështu, ata kurorëzojnë përpjekjet e tyre dhe , në mesin e shekullit të XVII-të , hapin në Velë shkollën e xhakojve në gjuhën shqipe ashtu si disa të tjera në Shqipërinë e Epërme. Invazioni otoman shembi e dogji shumë kisha e katedrale, por ato u ringritën me mundim, falë zellit të këtij fisi krenar e besimtar në Krishtin. Edhe se në Selitë e Rranzë pati ndonjë laramanizim, ku pak familje në kufi me Matin e Lurën u kthyen në mysliman, ndodhi një proces tjetër thuajse unikal, ai i rehabilitimit në fenë katolike. Veç kësaj, sidomos në Selitë , ato pak famije të besimit mysliman të kremtet kryesore kishin festat e katolikëve, si Shën Llezhdri, Shengjergji etj.

Po epilogu i këtij studimi?

Pas luftës së Dytë Botërore, me një egërsi të pashembullt, diktatura do të rebelohej ndaj klerikëve edhe në Mirditë. Ekzekutohet Abati i fundit , Frano Gjini, vdes nën tortura në qeli, Dom Mark Gjini, Mark Bica etj; ndërsa largohen nga Shqipëria Dom Nikoll Kimza e Dom Zef Oroshi, i cili më pas do të bëhej i pari kapelan i kishës katolike në Amerikë. Dom Vlash Muça e dom Ndoc Ndoja, burgosen. Nuk dihet cili mbeti pa pranga ndër duar. Një bilanc i vogël i tragjedisë së madhe të Klerit shqiptar: 160 klerikë, që mendohet të kenë kryer 450 vjet studime në 24 universitete të Europës martirizohen. Shtetëzohen objektet e kultit, po kështu pasuritë e tyre. Stuhia e propagadës ateiste derdhej me tërbim kundër “meturinave fetare”, ndërkaq, besimi të Zotit, mbeti përherë zgjuar ndër zemrat mirditore. Që nga viti '90-të e deri sot, kur ka mbërritur 2000-vjeçari i Krishtërimit, harta e kishave është përtrirë e pasuruar. Në mijëvjeçarin e ri katedralja e re e Shën Mërisë në Reshen, që po ndërtohet, do dëshmojë edhe një herë udhën e mbarë, udhën e Zotit, në tokën e katedraleve, që quhet Mirditë.

Gazeta, RD, mars 2000

SAGA E NJE MONOGRAFIE TË HERËSHME PËR MIRDITEN

Është fjala për monografinë, "Mirdita në histori, në gojdhënë e në zakone të veta deri në vjetin 1929", e shkruar para tetëdhjetë vitesh nga Zef Mark Harapi dhe e botuar në revistën më të njohur të kohës, "Hylli i Dritës".

Autori i kësaj monografie njihet si një figurë interesante e kulturës shqiptare në gjysmën e parë të qindvjetshit të kaluar edhe pse në gjysmën tjetër u qit në harresë. Pa veprën e këtij personaliteti, jeta teatrore e qytetit verior, do të ishte më e vakët; historia, letërsia, etnografia e Shkodrës dhe e Shqipërisë nuk do të kishte vlerat që ka, pa ndihmesën e jashtëzakonëshme të shkrimtarëve, dijetarëve e etnologëve si Zef Mark Harapi.

Përpos dramave që e mbajtën gjallë jetën teatrore të vendlindjes së tij, Shkodrës, ky autor shkruan edhe poezi, publicistikë, vëllimin me tregime "Lule fushe", romanet: "Pushka e trathtarit", "Peng a rob?" etj.

Harta e veprimtarisë së tij si mësues shtrihet në disa vise të Shqipërisë së Epërme si mësues në Pejë, ku edhe shkruan librin "Dit' t e trishtimit në Pejë e ndër rrethe 1911-1913", mësues në Durrës, për t'u kthyer sërish në vendlindje si pedagog në Kolegjin Severian, bash aty ku, me 1910 kishte kryer studimet. Më 1928, emërohet Drejtor i Konviktit "Mirdita", në Orosh.

Ndoshta emërimi i tij në Oroshin e përmendur si qendër e shumë

zhvillimeve historike në Veri, inspiroi hartimin e kësaj monografie krejt të veçantë për një nga krahinat që kishte grishur qysh heret etnologë e historianë, të huaj e vendas për vlerat unikale që bart prej thellësive të shekujve.

Për mësuesin e konviktit të Oroshit, Mirdita nuk ishte krejt e panjohur, pasi siç dihet marrëdhëniet e vendlindjes së tij më këtë krahinë ishin shumë të hershme e në të shumtën e herës mjaft të bereqetshme. Por, eksplorimet e studiuësit në terren, bashkëbisedimi i gjërë me klerikët dijetarë si Dom

Prend Sulin, Gjinalin, etj, si dhe me bartët e kulturës materiale e shpëtore i kanë dhënë dorë autorit, që përveç referencave të marra nga udhëpërshkruesit e huaj De Grand, Durham, Nopça etj, të mbledhë mjaft të dhëna për historinë, etnokulturën dhe folkun nga goja e bartëve dhe individëve okularë në zhvillime të rëndësishme të kohës.

Është me rëndësi të nënvizojmë se autori edhe se është i njohur me disa nga studimet e shkrimet për doket, mitet, folkun, etj, nuk citon shumë prej tyre, por hedh në letër ato që dëgjon, sheh e përjeton. Duket kthjellët se autori nuk ka ndonjë dijeni se një tjetër bashkëkohës i tij nga Korça, Stavri Frashëri, duke shoqëruar një antropolog amerikan në rrafshin verior nga brigjet e Matit deri në Malësinë e Gjakovës dhe Dukagjinit, ka marrë impresione të veçanta nga kjo krahinë, duke kompozuar një libër interesant, të cilin studiusi Ndue Dedaj e ka quajtur "...librin e parë për këtë krahinë, në stilin e udhëpërshkrimeve, i shkruar nga një shqiptar..." Po kështu, deri aso kohe nuk ishte botuar as Kanuni i Lekë Dukagjinit, pjesa më e madhe e lëndës së tij e mbledhur nga Gjeçovi në Mirditë.

Secili prej autorëve, vendas a të huaj, ka sjellë në veprat e tyre një areal me vlera të veçanta të identitetit kombëtar, ekzotikën e atij relievi, ku ka jetuar e jeton një fis i moçëm, krenar e luftarak, i vetëqeverisur me kushtetutën e vet antike, me kodet morale të një sistemi social, që qëndronte ende në këmbë edhe pse nën presionin

e dukshëm të zhvillimeve moderne në Shqipëri(konsolidimi i shtetit shqiptar).

Këta autorë e të tjerë, kanë pasur si themel një paratekst të pasur të shkruar, por më së shumti atë oral. Përqasjet në këtë rrafsh janë të pashmangëshme dhe të shpjegueshme se kanë të njejtin argument, Mirditën, me historinë dhe etnokulturën e saj interesante.

Saga e kësaj monografie, vijon me botimin e lëndës në vijimësi, në “Hylli i dritës”, por që kurrë nuk u botua si libër më vehte. Sidoqoftë në fletët e “Hyllit të dritës” u shpalos një pjesë e rëndësishme e historisë dhe etnokulturës së Mirditës, deri më 1929.

Një vend të rëndësishëm zë në monografi qëndresa antiosmane, marrëdhëniet e kësaj krahine me Bushatlinjtë, me Ali Pashën, me Shalë e Dukagjin, që në thelb kanë traditën e organizimit të krahinës në luftë, strukturën ushtarake dhe drejtimin e luftimeve në përbërje të forcave perandorake. Episodet që sillen në vepër shpalosin karakterin luftarak të mirditasit, besimin në fitore, inteligjencën, humorin e hollë dhe bujarinë, por njëherësh dhe varfërinë e skajshme të një fisi, që sidoqoftë përfton egërsi nga ai relief i egër me male, shkropa e hone...

Gjenealogjia e Derës Princërore të Gjomarkajve si dhe kontributi i saj jo vetëm në historinë e Mirditës, por edhe në atë gjithkombëtare, natyrshëm që është një pjesë e rëndësishme e monografisë, pasi epopeja e qëndresës anti-osamne, vetqeverisja me doket e vendit, janë të lidhura pazgjidhmësisht me emrin e kësaj Dere.

Por, autori jo gjithëherë ka mundur t’ia dal në skaj me hulumtimet dhe eksplorimet e tij, si fjala vjen, pema gjenealogjike e Gjomarkajve për të cilën, studiuesi Preng Gjomarkaj, pasi e ka këshilluar me të moshuarit e këtij fisi si dhe me arkivin familjar, na e sjell përkrah asaj të botuar para tetëdhjetë vjetësh te “Hylli i dritës”, me ndryshimet e nevojshme.

Nuk po ndalohe mi nëpër episode të tjera, pasi s’kemi si qëllim të bëjmë mirëfilli një analizë teksti, por të rrëfejme sagën e monografisë, në strukturën e së cilës, gjejmë të pasqyruar një pjesë

të mirë të dokeve riteve, oralit të dasmës mirditore, etnografisë, epikës, miteve e gojëdhënavë, zejeve, mjeksisë popullore, jetës religjioze e kulturore, edukimit, etj.

Është kjo arsye, që jo pak studiues të historisë dhe kulturës popullore i janë qasur fletëve të verdha të revistës emërmadhe dhe kanë marrë jo pak referenca, që shpesh nuk janë cituar prej tyre.

Por, monografia nuk ka qenë “fatkeqe” vetëm në këtë kundrim.

Me gjithë përpjekjet e bëra për të kthjelluar se, përse autori u mjaftua vetëm me botimin e saj në revistë e jo si libër më vete, nuk kemi mundur të gjejmë dëshmi, që të sjellë ndonjë gjë të re për lexuesin.

Ndoshta lidhet me angazhmet e autorit në jetën sociale të qytetit të tij, me veprimtaritë e shoqërisë “Bogdani”, kreu i së cilës ishte për shumë kohë, me densitetin e lartë të punës krijuese, me jetën private, etj.

Zef Mark Harapi, u shua me 31 tetor 1946, kur po jepte mësim, duke lënë pas një vepër të lavdrueshme shkrimtarie e atdhetarie.

Vepra që po i paraqitet sot lexuesit e përgatitur për botim nga studiuesi, Preng Gjomarkaj, nuk mund të botohej gjatë diktaturës për shkaqe politike dhe ideologjike, pasi aty shkruhej për Gjomarkajt, për kontributin e Kishës katolike, Klerit, Parisë, që stuhia e propagandës së kohës hidhte mbi to baltë e mjegull.

Autori i saj, gjithashtu kalohet në harresë për pesëdhjetë vjet, dhe jo pa qëllim. Ai ishte filiz i një vatre dijetarësh, artistësh e atdhetarësh të shquar, që sistemi i kishte mënjanuar e persekutuar, pa mëshirë. Ashtu si e cekëm edhe më heret, lënda e kësaj monografie u shfrytëzua edhe në mënyrë abuzive nga disa pseudostudiues dhe studiues të indoktrinuar dhe ky është një argument më tepër për të thënë se pse mungoi interesi dhe mirësia për ta botuar, fill pas levizjeve të viteve '90-të.

Në këtë botim, monografia, “Mirdita në histori , gojëdhënë e doke te veta deri më 1929”, vjen para lexuesit e përgatitur për këtë qëllim nga z. Preng Gjomarkaj, i cili bashkë me dëshirën për botimin e

saj të plotë, bashkoi edhe vullnetin, durimin , përkushtimin e dijet e tij për ta sjellë atë të plotë e origjinale, duke respektuar rendin kronologjik dhe strukturën e kapituvje të botuara në revistë e duke e paisur me ndonjë shënim skjarues a ndonjë sjellje të disa fjalëve në gegërishten letrare pa çënuar frymën e përgjithëshme të gjuhës së përdorur nga autori.

Kjo sipërmarrje është një gjest qytetar dhe një angazhim intelektual, që meriton të përshëndetet. Botimi i saj në trajtën e plotë si monografi është me rëndësi për historinë e studimeve për Mirditën, e cila është pjesë e pandarë dhe mjaft e vyer e historisë sonë kombëtare.

Studiuesit,mësuesit ,nxënësit e studentët, do të kenë në bibliotekën e tyre një dëshmi të hershme për vendlindjen e tyre, e cila do ju shërbejë si pikë referimi për shumë aspekte të historisë, etnokulturës, folkut.mitologjisë,etj.

Duke menduar se në këto rreshta sollëm për lexuesin sagën e një monografie të kahershme dhe një profil modest për autorin, urojmë që udha e saj të jetë, udhë me dritë.

TRUPËZGJU
SHTEPIA BOTUESE

DRITA E NJË AMANETI...

R*reth monografisë, "Brezni të Kelmendit , Hasanajt e Selcës" , të publicistit ,Gjovalin Gjeloshi*

... Shkëlqen me krejt bukurinë, dashurinë, forcën e kthjelltësinë e saj, në këtë monografi, për njërin nga rrathët e lisit të moçëm, në Shqipërinë e Epërme, Hasanajt e Selcës së Kelmendit.

Libra kësdore, janë shkruar shumë, por në mjaft raste, ato nuk i kanë shpëtuar subjektivizmit të skajshëm. Duhet thënë, që në krye të herës se , autori, falë përvojës së gjatë si reporter i shtypit shqiptar, por edhe si hulumtues i vlerave etnokulturore të arealit në fjalë ,Malësia e Madhe e më gjërë, ka mundur ta kapërcejë me sukses fillin e hollë , që ndanë një memorial, libër familje a gjinije, me një monografi të kompozuar për botim , në tërë strukturën gjinore të saj

Dhe ja përse:

Së pari: Amanetit të gjyshit, për të lënë të shkruar gjenezën e familjes, autori i ka dhënë një frymë historiko-shoqërore, por edhe emotive. Ai e ka ndjerë thellësisht sëbrendshmi se atdheu, fillon thellë, te rrënjët e lisit të gjakut, bash aty ku kanë lindur të parët, me gjysh e stergjysh. E, të shkruash për viset e Kelmendit si "Filizi më i pastërt i trungut të vjetër ilirik", do të thotë të jesh vërtetë shkrimtar me fat...

Së dyti: Referencat e shumta prej albanologëve të huaj si, Shuffaj,Shtatmyler, Baldacci, apo historianëve si At' Zhan Klod Faverial, Jozef Suire, etj, autorëve vendas , e sidomos prelatëve të kishës katolike, e kanë kthjelluar edhe më tej profilin patriotik dhe

religjioz të kelmendasve trima, të urtë, të squet, por dhe hokatarë të përmendur. Duhet të veçojmë se si autori, qartëson jetën e dyfishtë fetare të malësorëve në kushtet e terrorit osman, rolin e pazevendësueshëm të prelatëve të kishës katolike, në ato vise.

Së treti: Eksplorimet e vemendshme në terren, bashkëbisedimet e shumta me të moshurit, bartës të vlerave historike dhe etnokulturore, e kanë pasuruar mjaft librin me të dhëna të reja ,të pashkruara më heret. Së katërti: Mbështetja në folkun e pasur të Kelmendit, citimet nga këngët e trimërisë për burrat me emer të kësaj pjese të Kelmendit, i kanë dhënë monografisë jo vetëm vërtetësi,(Kënga –kronikë e gjallë), por edhe ngjyrim emocional, duke e bërë atë të lexohet me endje. Dhe Hasanajt, nuk patën pak burra me za. Që nga Turk Isuf Hasani e Ali Rama e deri te Prek Cali e Ded Shabani, në harkun kohor të dy shekujve, nga ky rrem, dolën një araadhë margaritarësh , që kanë shkelqyer si meteor në qiellin e shqiptarisë. Mjafton të shfletosh “Lahutën e Malcisë”, këtë enciklopedi të trimërisë shqiptare, e të mësosh se një pjesë e poemës janë djemtë e këtyre viseve si ,Turk Shabi, Memi i Smajlit, Muç Hasi etj, të cilët pena e artë e Fishtës , i ka gdhendur, siç dinte ajo, në këngët e poemës madhore.

Është meritë e autorit , Gjovalin Gjeloshi, që me maturi, modesti e sinqeritet, por edhe me një frazë përgjithësisht elegante e leksik të pasur, ku ndjehet toni i përmbajtur i kumtit , të shmangë teprinë, që jo rrallë i ndeshim në këso rastesh.

Lënda pamore, fotot, e personazheve të kësaj monografie, pema gjenealogjike e Hasanajve, me gjithë “zjarrmet” e saj, pasuria etnokulturore, qendresa heroike ndaj turqëve, sllavëve dhe diktaturës komuniste, të strukturuar me njeshtri në arkitekturën e librit, dëshmojnë se sipërmarrja e vështirë e intelektualit krijues , është e suksesshme , dhe lexuasi ka në dorë një monografi me vlera. Autori e ka krye amanetin e gjyshit të tij. Drita e këtij amaneti shkelqen në fletët e kësaj monografie...

Korrik, 2006

MALI I KËNGËS

Vëllimi poetik “Plis në Luvër”, i Gjokë Beci, promovohet në 75 -vjetorin e lindjes

Datëlindjet e njerëzve , që lënë gjurmë me veprat e tyre shënohen si ngjarje në historinë e kulturës së një krahine , nacioni a mbarë njerëzimit.

Relievi etnokulturor e historik i Mirditës, ka malet e veta në roje të identitetit arbëror si

Malin e Shenjtit, që e ngritën der në qiell abatët historikë, që nga i përndritshmi Prend Doçi, Zarishi e deri tek martiri i fundit, Frano Gjini, Malin e shtetit etnokulturor të vetëqeverisjes , që mban emrin e Derës Princërore të Gjomarkajve, Malin e qëndresës përballë dimrit osman e dimrave të kohrave moderne, që mban emrin e një fisi krenar e luftarak, filiz i pastër i identitetit arbëror. Mirdita, ka gjithashtu malin e këngës që mban e do të mbajë emrin e Mjeshtrit të madh, poetit, Gjokë Beci.

Në këtë ditë jubilarë të 75 vjetorit të lindjes po e kujtojmë nëpërmjet bashkëbisedimit për librin e tij të fundit, botuar në gjallje të tij ,Plis në Luvër.

Ky, është 30 korriku i parë pa poetin e panteonit të këngës.

Gjokë Beci u lind në Zajs të Mirditës, më 30 të korrikut 1939, në një famijle me tradita liridashëse. Ai mbeti herët jetim , por pranë ndjeu gjithëhere dashurinë e përkujdesjen e njerëzve më të afërt të gjakut. Kështu djaloshi imcak e i etur për dije e la vendlindjen e zambakëve të gurit e të lulezonjës për të vazhduar shkollën pedagogjike. Aty, do takonte shkrimtarin e shquar Petro Marko, i cili do të ndikonte fuqishëm për rugëtimin poetik të Gjokës. Poeti i ri mirditas , do shfaqet në faqet e shtypit letrar të kohës, që nga mesi i viteve '60-të.

Më 1969 ,boton vëllimin e parë, “Kur zgjohen bjeshkët”. Pastaj, në kulmin e krijimtarisë së tij, kur po kalonte në shtyp vëllimin e dytë, që nuk u botua kurrë, Mirdita zyrtare, me platonizmin e saj të njohur e largon nga biblioteka e qytetit dhe e dërgon punëtor në ndërtim, duke i hequr edhe të drejtën e botimit. Pas pesë vjetësh “riedukimi”, thirret për të punuar e krijuar për Festivalin Kombëtar të Gjirokastrës. Poema folklorike, që ai kompozoi ishte e një niveli të lartë dhe u mirëprit e u vlerësua me flamurin e festivalit. Shtypi i kohës e vlerësoi, gjithashtu shumë lart për frymën dhe nivelin artistik sepse muza e tij, ishte ngjizur në mitrën e muzëz popullore dhe atë të homerit të gjakut tonë, poetit kombëtar Gjegj Fishta.

Kthehet në sektorin e kulturës dhe nuk vonojnë ftesat për bashkëpunim nga etrit e muzikës si, Zadeja, Dajia, Feim Ibrahim, Kujtim Laro, David Tukiçi, Edmond Zhulali , Aleksadër Peçi, etj., dhe u lauruar me shumë çmime, duke u bërë pjesë e panteonit të këngës shqiptare.

Gjokë Beci bashkëpunoi me të gjithë kompozitorët mirditas dhe me ata që punuan në Mirditë si me të paharruarit, Dorian Nini e Fran Vorfi, me Mark Gjokën , Servet Carën, Dod Prendin, Zef Tushën, etj. Fjalët e tij u kendum nga zerat më të spikatur të melosit shqiptar, që nga aureora e këndimit shqip, Vaçe Zela, Gaqo Çako, Kastriot Tusha, Aferdita Laçe, Frederik Ndoci, Myfarete Laze, Bashkim Alibali, Arif Vladi, Ilir Shaqiri, Nertila Koka, Luljeta Perbasha, Mrika Tumshi ,Shkurte Fejzo, etj.

Të gjitha tekstet e këngëve autori i botoi në kolanën, „ Antologjia e shpirtit“ , vepër e cila është një gjerdan i artë në visarin e këngës shqipe.

Autori botoi edhe vëllimet poetike:”Qiell e dhe”,“ Thuaj vetes, ec..“, ”Ligjërime” dhe” Plis në Luvër”.

Si çdo krijues tjetër edhe mjeshtri Beci, kishte shumë pengje si: Të botonte romanin eseistik për Mark Brungën ose Nastradinin mirditas si dhe ato, që mes miqsh i quante vjerrshat e bllokut .

Pasi vëllimi i fundit, “Plis në Luvër”, u vlerësua me çmimin, “Gjergj Fishta”, që organizon dhe mbeshtet financiarisht nga Këshilli i Qarku i Lezhës, na thoshte se sa të bahem pak më mire, do mblidhemi e të bisedojme për librin. E kishte peng ...Dhe i tillë mbeti se,

Fluturoi dhe shterg i fundit

Madhështor me shpirt të gjorë...

Lumi heroik i tij u ndal. U ndal në një ditë të madhe, në ditën e të dashuruarve jo për të çartun festën e bekuar, por për të na thënë dhe atëbotë, kur zemra tij e madhe jetoi rrahjen e fundit, kur sytë prej shkaboje u fikën e drita e përrjtësisë shkroi plot shkëlqim në qiellin arbëror:

Qoftë mallkue kush s’na don bashkë!

Në çdo çast na dashti bashkë, mish e gjak, bashkë si malin me borën se në këtë jetë me diell mbi krye, kemi ardh me e dashtë njëri tjetrin e kurrë me urre. Kurrë!

Zoti e pat thënë të rritej jetim, pa babe, por edhe pa vëlla. Edhe shoqja e jetës iku shumë para tij.Ai, me guxim i tha vetes: Ec!

Dhe hapat lanë gjurmë të arta në rrugëtimin dinjitar e të paepur, duke na lenë një visart të vyer në gjerdanin e vlerave shpirtërore të popullit tonë. Mirdita , të ciles i këndoi me madhështi, Kosova e Çameria, mbarë shqiptaria ,

do e mbajnë në buzë refrenin madhështor:

Po ku ka si ti , o Shqipëria ime

O, fisnikja përmbi gur,
Rrjedh në këngë e ligjërime,
Ballëlarta me flamur .

Për tiparet dalluese dhe frymën thellësisht kombëtare të poetikës Gjokëbeciane, kanë shkruar studiuesit, Ndue Dedaj ,Mark Marku, Behar Gjoka, etj,etj.

Veprimtaria e tij poetike dhe atdhetare është nderuar me urdhërin: “Naim Frashëri” si dhe me titujt:

“Mjeshtër i madh “, nga Presidenti i Republikës, “Personalitet i Shquar i Qarkut Lezhë” , nga Keshilli i Qarkut Lezhë, ”Qytetar Nderi ”, nga Keshilli Bashkiak i Rubikut, ”Nderi i Klubit Kulturor Mirdita”, etj.

Edhe libri, “ Plis në Luvër”, ka si kryemetaforë, identitetin nacional . I shkruar në gegnisht dhe në gjuhën standarte ashtu si e ka thënë dhe studiuesi i njohur, Behar Gjoka .: „Kuptohet, se me këtë përmbledhje kemi të bëjmë me një eksperiment të dyfishtë gjuhësor, ku rimerret gegnishtja si gjuhë e autorit dhe e poezisë , dhe vihet krahas ligjërimit të gjuhës së njësuar, por këtu kemi dhe një fakt poetik, që na jep shansin, që brenda një libri të lexojmë dhe shijojmë poezinë e autorit, tashme në dy variante“.

Botuar te Telegraf, 25 gusht 2014

SHPIRTI I VISAREVE

Nga Llesh Zefgjini-

Shumë vepra të letërsisë dhe artit shqiptar e kanë marrë argumentin nga areali etnokulturor i Mirditës. Në vitet 30-të, të qindvjetëshit që lamë pas, janë dy etnologë shqiptarë, që botojnë monografi për Mirditën, historinë dhe etnokulturën e saj. "Permes Mirditës në dimër" nga korçari Stavri Frashërit dhe "Mirdita në histori dhe etnokulturë deri në vjetin 1929", nga ish- drejtori i Konviktit të Oroshit, shkrimtari, dramaturgu dhe etnologu, Zef Mark Arapi, botuar periodikisht në "Hylli I Dritës"(Tash e përgatitur dhe e botuar si libër nga Preng Gjomarkaj) ...Një vepër tjetër e prozës së gjatë e sjellur në shqip nga Karl Gurakuqi, ishte edhe romani,

"Lule" i franceskanit austriak, At' Fabian Barcata, vepër, e cila, sjell pas të tjerash, edhe shumë të dhëna mbi traditën dhe etnokulturën anise një vepër mirëfilli artistike.

Pas luftës së dytë botnore, shënohen disa vepra, që u vlerësuan nga kritika e kohës si poema "Mësuesi" e Lllazar Siliqit e, ma vonë filmi : "Komisar i Dritës", Opera "Mrika", Drama, "Cuca e maleve", filmat "Besa e Kuqe", "Guri i besës", "Plagë të vjetra", "Këngë në minierë" e Shuteriqit,"Prilli i thyer" i Kadaresë, "Këndo Mirdita ime " e Pal Përlalës, "Kur zgjohen bjeshkët" e Gjokë Becit etj. Kësso kohe u shkrua dhe u vu në skenë edhe drama "Përmbysja " e dramaturgut, Bardhok Sulejmani.

Mirdita ishte e shquar për trashëgiminë orale dhe atë materiale, por

nuk trashëgoi thujtjse asgjë nga arti skenik.

Shkrimtari dhe studiuesi, Llesh Sefgjini , e merr argumentin e librit të tij, “Shpirti i visareve”, bash në këtë kohë, kur filloi organizimi i jetës artistike në Mirditë. Kjo risi në jetën e vendlindjes së autorit, pati edhe protagonistët e saj.

Duke vënë në qendër të këtij libri, krejt të veçantë , një personazh të zhvillimit të kulturës artistike në Mirditë, dramaturgun dhe shkrimtarin, Bardhok Sulejmanin, autori ka bërë zgjidhjen e duhur në rrafshin kompozicional të veprës. Ai sendërton jo thjeshtë një monografi për zhvillimin e artit skenik në ato vise, por arrin të shpalojë me kreativitet e të dimencionojë me realizëm përpjekjet pozitive për zhvillimin kulturor. Te shfleton librin , ku ngjarjet ndjekin shtjellën kronologjike, ndjen se autori, duke qenë njëherësh bashkëkohës e mik me personazhin e tij, identifikon në mënyrë imtësorë dukuritë e këtij zhvillimi në zonat e thella të Veriut. Me një gjuhë të pasur e me idensitet të lartë të kumtit narrativ shpalohet fati dhe drama e shkrimtarit në provincë, fati i individit në një shoqëri të izoluar, raportet e tij dramatike me politikën dhe realitetin e një stine nën diktaturë. Skëndërbegasi i zbritur në kryeqytet nga Kthella e Mirditës nuk intonohet lehtë me jetën e rreshtit, në gjithë ngarkesën semantike të fjalës rrjesht ase si thotë autori, rresht- jeta, rresht...Dhe ja, vjen një moment e Bardhokun e largojnë nga rreshti, po ku do rreshtohet?...Këtu autori me squetësi dhe elegancë, na jep konfliktin brenda sistemit të kohës komandant - komisar ase ma mirë shtet - politikë... Komisiari : “ E preve kostumin rus... Komandanti: “Shoku kryetar, Bardhokun e kemi djalë me aftësi, ndimojeni se do ju ndihmojë” Dhe fati -fat. Kadeti i përjashtuar nga shkolla, emërohet, pergjegjës kulture , në fshatin e tij... Me një gjuhë të pasur, plot stilema e shprehje frazelogjike të folmes mirditase, autori i jep ritëm rrëfimit të tij, për kulturologun e ri, duke na e shpaluar me imtësi çdo hap në udhën e nisur , që nga shfaqja e parë deri te momenti kulmor në krijimtarisë ë tij , kur dramën “Përmbysja”, do ta shikojë vetë kreu komunist i kohës, i

cili dhe e pat vlersuar...

Vlerë e veçantë e librit është edhe pasqyrimi me realizëm i përpyjekjeve të njerëzve idealist të kohës, për zhvillimin kulturor të Mirditës, e cila trazhëgoi një prapmbetje të madhe sidomos në fushën e arsimit. Me mjeshtri, autori ia del të sjellë në faqet e këtij libri personazhet e spikatura të zhvillimit kulturor në vendlindjen e tij, Meshtri i madh, Gjakë Beci, Prof. Mark Tirta Këngëtar, Fran Vorfi, kompozitori Dorian Ninit, Kolë Zefit e Luljeta Përbashës, Mark Gjokës, Servet Carës, Zef Tushës, Anton Gjokës, Dod Prendit, Bardhok Koka, Angjelina Leka, Dava Gjini, piktori Lin Loci, regjizori Zef Nikolla, kulturologu Ndue Tusha. etj ,etj.

Ashtu si e shënon dhe shkrimtari Ndue Gjika, në fillim të viteve '70 e në vijim institucioneve kulturore në Mirditë, u erdhi një kontigjent i mire nga shkollat artistike dhe nga Akademia e Arteve si instrumentistë, aktorë, piktorë e kulturologë, të cilët i dhanë zhvillim të dukshëm jetës kulturore, në gjithë krahinën e Mirditës. Teatri amator, estrada, ansamblet artistike nga risi u kthyen në një traditë të bukur. Natyrisht, që këtu i rëndësishëm është kontributi i shkrimtarit Bardhok Suljmani, që për shumë kohë ishte Drejtor i Drejtorisë Kulturore të Mirditës. Janë pikërisht këto arriitje, që përpos sa thamë, në Mirditë u zhvillua edhe Kultura Masive, një zhanër i panjohur ma heret, por që specialistët e ri të akademisë bënë, që këto veprimtari të kishim sukses e të vlerësoheshin me çmime kombetare. Ndue Gjika me libretet e tij disi ndryshe patetizmit të kohës u pëlqyen nga publiku për frymën qytetare, që solli me veprimtaritë e dendura e të larmishme... Banda e qytetit e drejtuar nga i palodhuri Kolë Picaku, i dha solemnitet festimeve në Rëshen. Nga ana tjetër, mësuesit e Mirditës dhanë një ndihmesë të paçmuar për mbledhjen e trashëgimisë orale dhe leksikut të krahinës.

Të gjitha keto, i paraprinë një veprimtari shumë të vlerësuar në FF. Gjirokatër 78, ku fjala dhe melosi mirditas shpaloi nëpërmjet kompozimit të një poeme folklorike, shkëlqimin e visareve të këtij

fisi inteligjent , që ka ruajtur në menyrë konservative identitetin historik e etnokulturor Arbënor.

Me një ritëm gati marcial, autori na pasqyron kontributin e artistëve, që kanë ardhur në Mirditë në ato kohë si shkrimtarët, Shuteriqi, Jakova, Miloti, Koreshi, Agolli, Siliqi, Prifti, etj, Aktorët : Sallaku , Banushi , B.Pepa, etj, kangëtarët: Zela, Rexha, Miloti, etj.

Natyrshëm e në trajtë refleksive, libri trajton përpjekjet serioze të kreut të Lidhjes së Shkrimtarëve të Mirditës, z.Sulejmani, për një trajtim të matur e njerëzor të krijuesve me perbërje klasore jo të mirë për kohën. Edhe se lufta e klasave në Mirditë , ishte e ashpër nuk kanë munguar përpjekjet për skjarime sa me imtësore, që individë të talentuar të kultivoheshin ose të rehabilitoheshin siç ishte, bie fjala, për poetin, Gjokë Beci, regjizorin Kasemi a ndonjë tjetër.

Autori ka mundur, që të jap një pasqyrë të plotë të gjithë Mirditës etnokulturore jo vetëm nëpërmjet numrit të madh të bartësve të visarit , por edhe duke bërë citime nga trashëgimia orale si të Rrëxës së tij ashtu të Fanit , Selitës, Kaçinarit, Kashnjetit...

Profili i përonazhit të “Shpirtit të visareve”, plotësohet edhe më thellë, kur autori pasqyron veprimtarinë e tij si pajtimtarë e veprimtarë shoqëror deri te titulli “Ambasador i paqës”. Përgjatë kësaj shtjelle, shumë emra të njohur të kohës citohen natyrshëm në këtë vepër si mësuesi iluminist, Ndrec Ndue Gjoka, deputeti Bardhok Biba.. etj. Por, thukët, shkrimtari Sefgjini , shpalon qendresën shekullore të mirditasve dhe shkëlqimin e prijësve të vet trima të squet e atdhetarë. Si: pashallarët e krishterë Bib Doda , Preng Biba e Vaso Pasha si dhe Preng Marka Prengën, Zefin e Vogël, etj

Në vend të epilogut, libri ka një falenderim të shkrimtarit dhe kulturologut Bardhok Sulejmani, që jo vetëm tregon modestinë e tij, por bën edhe disa plotësime të nevojshme, që i rrinë shumë mirë kompozicionit dhe arkitekturës së librit në përgjithësi. Ai citon këtu emra të shkrimtarëve e

poetëve mirditas si: Preg Cub Lleshi, Preng Maca , Zef Bardhi, Viktor Gjokolaj ,shkrimtarët e talentuar të viteve '80 –të e në vijim, Ndue Gjika , Ndue Dedaj, Zef Zefi e Mark Marku, Gjon Marku, poetin popullor Jak Tuci etj..

Në këtë ditë, me dy jubile, atë të ditëlindjes dhe të 20- vjetorit të shkrimtarisë, me këto rreshta, thamë krejt pak. Vepra e Llesh Sefgjinit është dhe do mbetet një kontribut i vyer i produktit letrar bashkëkohorë dhe një dëshmi, që e pasuron fondin historik të zhvillimit të kulturës në Mirditë , visarin e traditës dhe atë bashkëkohor nëpërmjet dy tipareve dalluese të shkrimtarisë së tij , gjuhës së pasur të begatuar me fondin e fjetur të Gegnishtes dhe nëndialekteve të saj si dhe një stili të dallueshëm në kompozimin e veprës.

Në një festë letrare si kjo, me dy jubile, nuk mund të bëhen analiza imtësore se e tillë është dhe gjuha e një veprimtarie si kjo.

I bindur se mendimi kritik profesional, ka një materie letrare me vlera të spikatura , ku mund behen dhe duhet të bëhen studime e analiza të thelluara.

Por jo vetëm për këto vepra të botuara në këto 20 vjet... Llesh Sefgjinin, ushtarakun shkrimtar, muza e grish për vepra të reja.

DRAMA DHE QENDRESA E FAMILJES KOLZIU NË DIKTATURË

Shënime për monografinë “FAMILJA KOLZIU” nga Martin Dedaj

Sa herë më qëllon të lexoj a të dëgjoj mbiemrin Kolziu, më kujtohet episodi i një procesi politik, kur zhvillohej gjyqi i bashkëfshatarit tim Gjokë Mikeli , këtu e 40 vjet ma parë. Një nga akuzat kundër tij ishte se, Gjoka , në mes disa puntorësh kishte thanë se “armiku i popullit”, Dede Kaziu, ka qenë trim e burrë besnik.

Dija se familja e Kolziut kishte qenë në internim bashkë me axhën tim në Tepelenë, por nuk kisha njohje imtësore. Duke dalë nga ajo sallë, ku qenë zhvilluar jo pak gjyqe politike në vitet '70, dëgjova të thonin se Deda kishte qenë armik i rrezikshëm dhe se prapë njerëzit e tij janë në Myzeqe, në internim.

Vrikthi më pat pushtuar një kureshtje drithëruese...

Dhe ja , pas kaq kohësh, njihem me sagën e kësaj familje të nderuar nëpërmjet një monografie ,të shkruar nga gazetari Martin Dedaj . Pasi e shfetova lëndën e shkruar nëpër kapituj, mora persipër të hedh disa mendime e konsiderata rreth saj . Në rrafshin gjinor i përket letërsisë dokumentare ose si është quajtur shpesh, letërsi e munguar për vetë temën që ngërthen.

E kompozuar, mbështetur në kriterin kronologjik, monografia shpalos me vertetësi gjeografinë dhe pemën gjenealogjike të Familjes Kolziu, por në mënyrë më analitike periudhën , 1943- 1990-të.

Ishte periudha, kur kjo familje e njohur e Mirditës, përjetonte lavdinë dhe dramën e saj ashtu si mjaft familje të kësaj krahine, që u bë simbol i rezistencës antikomuniste.

Kjo stinë e mjegullt dhe e lavdishme, është pasqyruar edhe më herët në veprat e shkrimtarëve e studiuesve mirditas. Këtu mund të veçojmë shkrimet e Gjon Mark Ndojt, Gjon Markagjonit, Filip Gjomarkut, Gjon Nikoll Dedës, Lekë Shtisë, Gjet Dodës, Preng Gjomarkajt , pa përmendur disa vepra të tjera në prozë e poezi , të cilat i kane marrë motivet nga kjo kohë dhe janë përfshirë këtu thuajse gjithë krijuesit mirditas.

Horizonti kohor, në të cilin shënohet epika e ngjarjeve politike e historiko-sociale në Mirditë, është trajtuar edhe në studimet dhe veprat letrare të botuara pas luftës së dytë botërore. Por, këto vepra kanë qenë jo vetëm tejet të politizuara, por kanë shtrembëruar realitetin . Martirët e qëndresës antikomuniste janë shpallur armiq dhe vrasësit e tyre heronj. Mjafton të përmendim qëndrimin armiqësor ndaj klerikëve dhe kishës katolike në filmin, Komisari I Dritës, injorimin që i bën shtresave të larta të Krahinës, filmi “Besa e Kuqe” , por dhe “Operacioni Zjarri “, drama Cuca e Maleve, ”Permbyttja e madhe “dhe shumë artikuj e studime, monografi për individë pa peshë në zhvillimet e kohës dhe që në thelb dëmtonin rëndë trashëgiminë dhe identitetin mirditas të formësuar ndër arenat e qëndresës shekullore e të konservuar me fanatizëm tipik.

Kronika e kësaj periode shpalon edhe disa veçori në teatrin e zhvillimeve politike në Mirditë. Janë një pjesë e konsiderueshme e parisë tradicionale, që i mbështesin të parët këto zhvillime të panjohura më parë dhe duke u bërë njëherësh protagonist të tyre. Kështu Bardhok Biba (Gjomarku), Pal Melyshi vihen në ballë të lëvizjes komuniste...

Edhe familja e Kolziut ,që ishte një familje e kamur për kohën, ndjek raven e zhvillimeve të reja. Bahet strehë e luftarëve të lirisë dhe vihet në krye të pushtetit nacionalçlirimtar. Jo vetëm kaq ,por Lleshi hidhet në radhët e brigatës së 17 –të S. dhe me çlirimin e vendit, mobilizohet me Forcat e Mbrojtjes Popullore në Berat.

Por, zhgënjimi nuk vonon dhe Deda , kur pa se pushteti i ri po shkelte

me dhunë traditat dhe lirinë , kur pa ndjekjet dhe vrasjet pa gjygj, doli në mal në krah të focave të rezistences deri sa e vrasin e trupin e tij pa jetë e përçundojnë, duke e tërhequr nëpër Lezhë.

Lleshi largohet nga komanda ku shërbente,e nuk kthehet në shtëpi, por në mal, duke fshirë çdo iluzion për një të ardhme nën diktaturë.

Në kujtimet e MonsinJOR Zef Oroshit për jetën në arrati, shpaloset kontributi dhe personaliteti i Llesh Kolziut si trim, besnik e drejtues i çetës së tij, deri kur forcat e ndjekjes e vrasin në Molung e trupin e tij e tëheqin zvarrë në Rubik e Rëshen...

Në monografinë e Familjes së Kolziut, pasqyrohet me vërtetësi drama e burgimit dhe persekutimit 40- vjeçarë.

Në kapitujt e saj janë përfshirë dhe shkrime të njerëzve të malit dhe të mërgatës si ato Ndue Melyshit dhe Ndue Pjetër Gjomarkajt. Një vend të rëndësishëm zënë dhe dëshmitë e bashkëkohësve dhe bashkëvujtësve të martirëve dhe gjithë familjes. Në rrëfimet e tyre tronditëse një vend të rëndësishëm kanë zënë rrëfimet dhe rrefenjat e Anton Kolziut , i cili lindi dhe u burrnue në internin, në sektorë të ndryshëm në rrethin e Lushnjës. Rrëfimet e me të mëdhenjve për trajtimet mizore në kampin famëkeq të Tepelenës, ndarjen e familjes në dy kampe e kanë pasuruar monografinë jo vetëm me episode të shumta , por i kanë dhënë emocion e ritëm, që e tërheqin lexuesin furishëm në rrjedhën rrëfimtare.

Gazetari Martin Dedaj e ka pasur pervojën e mjaftueshme edhe me botimet pararendëse për ta shkruar monografinë me një rregjistër të përzier, duke respektuar standartin. Landa pamore e ka pasuruar veprën, duke na dëshmuar vende, stinë dhe familjarë e bashkëvujtës, por dhe vazhdimin e lisit të gjakut të kësaj familje. Kësodore ky libër e begaton fondit e letersisë dokumentare me argumenta nga dhuna dhe persekucioni komunist dhe hedh dritë mbi dramën dhe qëndresën e familjes Kolziu, që është pjesë e dramës dhe qëndresës së Mirditës në Diktaturë

POETI POPULLOR JAK TUCI

Poeti popullor Jak Tuci i përket asaj plejade të bardëve mirditas , që krijimtarinë e tyre e shkëputën nga krijimi dhe transmetimi gojor, duke ravijëzuar një dukuri të re: këngët autoriale. Në vitet '50-të dhe '60-të , të shekullit të kaluar, krahas teksteve popullore që këndoheshin me çifteli, u lëvruan dhe rapsoditë e gjata që recitoheshin nga autorët e tyre. Të tillë ishin artistët e merituar: Aziz Ndreu, Frrok Haxhia, Ded Ndue Lazri, Sokol Arifi etj. Në këtë ravë eci dhe krijimtaria e Jakut, por duke krijuar profilin e tij, të veçantë nga të tjerët.

Në 60 vjet krijimtari , ai shkroi qindra këngë me frymë epike, liriko-epike, lirike dhe humoristike, duke dhënë një kontribut të vyer për kulturën popullore.

Këto këngë u kënduan nga zërat më të dalluar të melosit mirditas . Duke qenë se poeti popullor recitonte, por nuk këndonte, krijimet e tij të para i këndoi djali i axhës së tij , shumë i njohur në vitet '60-të, rapsodi Simon Tuci. Pastaj me këngëtarin e shquar Fran Vorfi, ka disa bashkëpunime , të cilat e banë shumë të njohur jo vetëm në Mirditë, pasi Ansambli Shetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore bëri pjesë të reportorit të tij disa këngë, që u përcollën nga zëri i Sali Brarit, etj.

Në lëvrimin e rapsodisë së gjatë ose të poemës folklorike, poeti popullor Jak Tuci, trajtoi temën kombëtare dhe atë sociale, ku shquhet poema për Kosovën me motive nga ngjarjet e vitit 1981. Këngët e Jak Tucit nuk u kënduan vetëm nga Ansambli Mirdita si

e cekëm dhe ma herët, por dhe nga grupe të tjera të Krahinës e individë jashtë saj.

Kështu, poeti popullor në fillim të viteve 80-të bëhet Kandidat i Lidhjes së Shkrimtarëve, Dega Mirditë.

Po të flasim për tre librat e botuara dhe tekstet që janë në fondin e fonetekës së Radio Tiranës e Radio Kukësit, do të thotë se kemi thënë pak. Me mijra bejte ka thurur Jaku nëpër vite. Ishte hokatarë i pashoq, por dhe i kujdesshëm ...Edhe nëse nuk e kishte shkruar ai, emri i tij përmendej i pari.

Duke punuar një pjesë të jetës me transportin, ai njihte gjithë kantieret e Mirditës, trimoshat e bakrit e skelat e trupave, peshoret e fabrikave e uzinave dhe kooperativat bujqësore. Shofer, e ma vonë brigadier transporti në Parkun e Mallrave Mirditë, Jak Tuci shkëlqeu me vullnetin e tij të epërm në atë sektor shumë të vështirë. Në Fanë, Orosh, Kurbnesh, Lurë shkonte plot gazment me krijimet e tija ma të reja dhe jua tregonte miqëve krijues nëpër këto zona. Kur vinte në Kurbnesh ne kishim festë letrare. Te Klubi i Kulturës, te hoteli i vogël i qytezës a në hije të pemëve brigjeve të Urakës, lexonim të rejat që kishte shkruar. Nuk harronte kurrë të na sillte të falat nga Gjokë Beci, Ndue Gjika, Bardhok Sulejmani, Kolë Zefi, Preng Maca, Zef Bardhi e Dorian Nini.. Nuk harrohen diskutimet pa fund për poezinë, për folkun e etnokulturën në përgjithësi, me Servet Carën, Bardhok Kokën, Mark Gjonin, Luan Ramën, Ndreç Kolndreun, Gjovalin Ndojn, Gjovalin Pepën, Kolë Becin, Nikoll Ndokun etj... Kur vinte nga Lura na sillte të falat e folkloristit të shquar, Hilmi Kolgjegja...Kthehej për në Rëshen i ngarkuar me motive të reja, me fjalë të rralla , me thënie të mençura....

Harta e episodeve të tilla ngërthente gjithë keto hapësira etnokulturore.

Prandaj krijimtaria e tij poetike ishte e pasur me frazelogji popullore, fjalë të zgjedhura. Antiteza ishte një ndër figurat letrare, që përdorte shpesh e me mjeshtri të rrallë. Nuk ka nevojë të sjellim shembull tjetër përveç këngës shumë të njohur, Kur u danë, kështu na ranë, të

kënduara nga vllazërit Lleshi.

...

Pas viteve '90, poeti popullor Jak Tuci, vizitoi gjithë trevat shqiptare bashkë me miqtë e tij këngëtarë, duke bërë realitet një ëndërr të herëshme. Shumë këngë thuri në ato vizita të paharruara në Strugë, Pollog, Shkup, Tetovë, Prizren, Gjakovë, Prishtinë, duke shpallur si lajtmotiv vargun: Në Kosovë pranvera s'ndalet.

Kishte të drejtë miku ynë i paharruar, që besonte në pranverën kosovare, në integrimin e Shqipërisë në familjen evropiane. Besoi pa fund në bashkimin e trojeve tona. Besoi deri atëbotë që ju fikën sytë, por duke lënë për brezat një vepër plot me dritë dashurie për Dheun e njerëzit e gjakut tonë.

*Botuar te revista, "MIRDITA", nr. 2. Botim i Shoqërisë Kulturore
Artistike MIRDITA*

MUZOU
SHTEPIA BOTUESE

RRËKEZË E KULLUAR, RRJEDHËS SË PROZËS SHQIPE

Reth librit, “Tregime“ nga Bardhok Pulaj

Autori i librit me tregime, vjen nga ato vise, ku është rrëfyer bukur për ngjarje e për drama njerëzore, për mite e legjenda, për histori erotike, fate e fatkeqësi individësh, e thënë tjetërsoj, vendlindja e shkrimtarit Bardhok Pulaj, është një terren i pasur me tregime gojore... E bëra këtë ekspozitë për të thënë se proza e kultivuar në Mirditë është lëvruar vonë dhe nuk trashëgon nga e kaluara thujasë asgjë.

Në vitet '70-të e në vijim, deputuan me shkrimet e tyre në shtypin letrar të kohës, një tufëz tregimesh të mirëpritura, që kishin për autor shkrimtarin Ndue Gjika. Po kështu spikatën me publicistikën kreative Frrok Çupi e Ndue Dedaj, ku nuk munguan as çmimet letrare. Ky fillim i mirë u pasurua me librat e parë në prozë si: "Dilema të pabrakisura" e N.Gjikës, "Dashuri në kullën e ngujimit" e N.Dedës, "M'at anë të muzgut të grave", të Zef Zefit, "Njeriu që ikte e vinte natën" të Gjon Markut, për të kulmuar me romanin "Shembja" të Ndue Dedës, etj. Në këtë klimë krijimtarie ka shkruar edhe Bardhok Pulaj, prozën e tij. Ai u shfaq heret në shtypin e kohës me artikuj të ndryshëm. Më vonë si gazetar i shtypit lokal, redaktor i disa librave të botuara nga shtëpia botuese, "Mirdita". Libri i parë i autorit është, "Mirdita", njohuri për vendlindjen, ku spikat kompozimi elegant i lëndës nëpërmjet një tipologjie

tekstore të përzier, ku dominojnë tekstet narrative , deskriptive dhe argumentues.

Libri i dytë i autorit mban një titull të thjeshtë ”Tregime”, anise brenda strukturës së tij janë hedhur që nga skica deri te novela. Proza e Pulajt sjell para lexuesit një areal me bukuri të rralla, me njerëz me fate, mendime e drama të ndryshme nëpërmjet një shkrimtarie të kultivuar. Përsonazhet e këtij libri përballen me një realitet të vështirë në një sistem, që rropatet të qëndrojë në këmbë nëpërmjet depersonalizimit, dhunës e varfërisë së skajshme. Vizatimet realiste të autorit te skicat antologjike “Kolla”, “Nënsupa” e do të tjera, të kujtojnë krijimtarinë e kesaj gjinie në vitet ‘30-të të përfaqësuar nga Migjeni, Bulka, etj. Njerëzit e kësaj stine të ligësht e të mbushur me trishtim e dhembje, janë njëherësh bashkëkohës të autorit, të cilët i japin atij impresione, që e trandin mendimin e shpirtin e intelektualit me integritet. Shqetësohet e hesht për do kohë ,por thellë qenies së tij nuk ka qetësi.

Dhe vjen një ditë, që me frymë të shëndetshme refleksive hedh në letër dilemat e konservuara prej kohësh , plot emocion ashtu siq dinë t’a shpalosin vetëm krijuesit e talentuar. Atlasi i episodeve që sjell autori në këtë libër është i larmishëm, plot kolorit. Nëpërmjet tyre pasqyrohet jeta jo vetëm e vendlindjes, por shumë më gjërë. Psikologjia mbi tokën, tradita, konflikti i brezave për marrëdhënie të reja në shoqëri, pesha e virtytit , abuzimi me detyrën, përdhosja e individit nëpërmjet një sistemi antihuman, vuajtja , shpessa dhe triumfi i tij , vijnë bindshëm në faqet e këtij libri nëpërmjet një leksiku të pasur dhe një fraze të ndërtuar bukur, ku koherenca dhe kohezioni tekstor respektojnë kërkesat e gjuhësisë së tekstit. Lënda përcillet me një rregjistër të larmë në dobi të ritmit të përgjithshëm narrativ. Gjuha fabulistike si fjala vjen te tregimet ,”Cjapi apo gjarpëri i vjetër”, simbolika, metafora, dialogu i zhdervjelltë sidoemos te novelat, janë disa tipare të stilit të autorit.

Një miku im shkrimtar më tha para do kohe : Mirdita është tokë pa det, andaj ne nuk mundemi të çojmë në detin e gjërë të krijimtarisë

nacionale ndonjë lum shungullues , ne po çojmë prroje e rrëkeza, që veç nga nga ai relief konservativ mund të rrjedhin. Proza e Bardhok Pulajt është një zë që rrëfen pastër e shqip, është një rrëkezë e kulluar rrjedhës së laboratorit të tij krijues drejt vlerave, që e ballafaqojnë me produktin letrar të promovuar.



SELITA, NJË QIELL ME ZOGJ, BECAJT, NJË TUFË ME BILBILA

I thashë këto fjalë, në një veprimtari mbresëlënëse në Pallatin e Kulturës në Mirditë. Ishte një koncert recital i këngëtares Gjela Duka Beci... se Becajt këndojnë i madhe i vogël. Një këngë popullore thotë për selitasit: Bash si bredhatn'bjeshkt' e bardha / Hije u ka kanga e fjala. E tillë është Selita, një oaz me bardë të shquar dhe me prurje krejt të veçanta në folkun e Mirditës. Një qiell me zogj...

Aty nga viti 1983 e pata pyetur më të vjetrin e Becajve , Bib Ndue Becin, asoherë mbi njëqind vjeç, për prejardhjen e fist të tij. Më pat thënë: "Të parët e mi kanë ardhë në Zajs të Selitës nga Malcia e Madhe. Herën e parë jemi ngul në anën e Valmorit. Po pse erdhën të parët e mi në Zajs, e thotë kanga e Bec Patanit. Unë kam ardh me kangë në këto anë. E ka pas knue Dod Lëkunda (axha i Artistit të merituar, Preng Lëkunda), sofër më sofër. Ka pas 150 fjalë (vargje) , por unë mbaj mend disa ‘ ‘ Dhe i shënova siç, m'i tha plaku shekullor: Kur krisi pushka e Bec Patanit, Vrau Bimbashin e nizamit

Mir' ja dogj palat fistanit

Mir ja dogj krahat e xhamadanit.

Plaka e Becit del në derë,

Rref dy shplakat menjihërë,

Vramë bimbashin me tetë neferë...(ushtarë)

Pra, Becajt, janë të ardhur në Zajs jo fort heret se edhe sot nuk është ndonjë fis i madh, por i njohur me emra të përveçshëm të fisit jo

vetëm si krijues e këngëtarë. Lek Beci ishte ndër drejtuesët me cilësi të rralla e me rezultate të pazakonëshme për kohën. I biri, Tonin Beci, u bë diplomat i karrierës..

Edhe Pashk Ndue Beci, ka drejtuar në sektorë të rëndësishëm në Mirditë. Poeti Gjokë Beci, Mjeshtër i madh, i lauruar në disa festivaleve të Këngës në RTSH , shkelqeu edhe si lëvrues i këngës popullore, sidomos këngës mirditore. Ai është autor i një varg perlash të këngës shqipe, që e kanë pasurur visarin tonë kulturor. Por, ma herët se Gjoka, kjo vatër kishte këngëtarë të njohur jo vetëm në Selitë. E kush e këndoi ma mirë këngën maje krahu se vëllezrit Preng e Dod Beci?!

Doda ishte një rapsod tipik, që i shkrunte fjalët e i këndonte me çifteli. Bukur, si ai. Por vetëm në festivalin e 1968-tës mori pjesë, pastaj do t'i mungonte këtij tempulli të visarit kombëtar përgjithmonë, ani se ndër sofrat e dasmave e festave në Mirditë, çiftelinë, atij ia jepnin, të parit...Brezi që erdh pas Prengës e Dodës, shkëlqyen me zërin e tyre krejt të veçantë në melosin mirditas. Kola, Biba, Marku, Gjela e deri te Prenë Beci Deda, laurate e FF Gjirokastër, 1988, ku këndoi një këngë të vëllajt të saj, Kolë Becit, autorit të këtij libri me poezi e këngë popullore. Kolë Beci, lindi dhe u rrit në një klimë të begatë të krijimtarisë popullore, i rrethuar me bardë të spikatur të trashëgimisë orale dhe asaj materiale. Kur Kola shkonte, te dajat në Kthellë Epër, për festa a dasma, i gjente dajat , duke këndue, shkonte te dajat e nënës, në Orosh te Perbashajt, të cilët të gjithë këndonin bukur. Shkonte te miqtë e tij, te Gjinajt e Lufajve dhe aty çiftelia nuk dinte me pra...

Kola u bë pjesë e veprimtarive artistike të Kurbneshit, që i vogël. Këngëtar dhe instrumentist i talentuar, me grupet artistike të shkollës në fillim e pastaj me Klubin e Kulturës Kurbnesh, që ishte njeri ndër klubet më të dalluara në gjithë jetën artistike të Mirditës dhe më gjërë. Artistët amator të Kurbneshit kanë përfaqësuar disa herë Mirditën në veprimtari kombëtare si në teatër, estradë, fjalë artistike etj. Por, Selita , vendlindja e poetit popullor, Kolë Beci, është shquar

për bartësit e folkut , që e ruajtën dhe e përcollën ndër breza. Nëse Mirdita shkëlqeu me Grupin e Burrave, tre prej tyre ose një e treta, ishin këngëtar prej Selite. Jo vetëm kjo, por edhe krijuesit më në zë ishin prej këtij areali. Këtu, përpos Gjokë Becit, një kontribut të rëndësishëm ka dhënë dhe kompozitori dhe këngëtar ,Servet Cara, i cili krijoi këngë hite për ansamblin “Mirdita”.

”Për liri s’ të fal shqiptari”,

“Guri i randë rrin n’ troje të veta” ,

“Dasma e Kamber Loshit”, (bashkëautor),

”Vallja e Zajsit”,

kanë edhe kontributin kreativ të Servetit , pa përmendur këtu shumë lirika e këngë të tjera në bashkëpunim me autorin e këtyre radhëve. Kolë Beci, është bashkëkohës me të gjithë drejtuesit e kulturës në Kurbnesh. I pari ishte poeti e dramaturgu, Ndrec Kolndreu , i cili hodhi themelet e levizjes amatore. Ai krijoi këngë popullore e vuri një dramë të tijën në skenë, me regji të mësueses nga Shkodra, Pina Martini. Meritë e vaçantë e tij ishte ngritja e bibliotekës së qytetit të ri. Të gjitha këto , ishin risi për ato kohë. Pas tij, do vinte drejtor një korçar, që ishte instrumentist modest, por një dizeniator e organizator shumë i mirë. Me largimin e Mihal Bacës , në Korçë , për shumë kohë drejtoi këtë institucion, mësuesi Sulejman Kamberi, që ishte në thelb një kulturolog i mirë dhe administrator i kapitalit kreativ të zonës. Ai mblodhi reth tij krijuesit dhe interpretuesit më të mirë dhe lëvizja amatore pati sukses. Bardhok Koka , që punoi drejtues deri sa u mbyll institucioni, vinte nga Shkolla e Mesme e Kulturës , me një formim të mirë profesional sidomos atë muzikor. Gjatë kësaj kohe mori zhvillim kënga popullore burimore, ku dhanë kontributin e tyre edhe Mark Gjoka, Mjeshtër i madh, Servet Cara, Mark Gjoni, etj. Krijimet nuk do kishin suksesin e njohur, pa interpretimin e këngëtarëve: Nikoll Kala, Kolë Gjini, Bib Beci, Fran Gjokolaj, Fran Kolmarku, Koxhë Cara, Ndrec Buraku, Geg Gjini, Ndre Buraku, Prena Beleshi, Prena Beci, Prena Gjokolaj, Liza Lala, Gjela Beci Duka, Flora Beci, Marte Bushi, Zina Beci , motrat

Kolndreu, motrat Shahini, Davida Gjokolaj, etj. Bardhok Mikel ishte laurat i imitimeve me gjeth.

Kjo përcjellje më jep rasën të përmend edhe disa emra që lanë gjurmë në lëvizjen artistike në Kurbnesh, si : ish- drejtori i shkollës, zoti Ndre Picaku, që në vitet '60-të, krijoi një grup artistik nga më të mirët e kohës në Mirditë. Përherë të parë u ngrit një orkestrinë me vegla folklorike, u ngrit grupi i valleve , ku koreografi i parë ishte i zalldardhasi, Nazif Luca.

Aktorët amator, Dali Buci, Frrok Cara, Lek Lala, Demir Shahini, Gjela Vishi, Dionis Çaro, Gjovalin Ndoj, Liman Koçi, Bilbil Cara dhe recituesit, Preng Maca, Margjela Arapi, V. Gjokolaj, Luan M. Rama, Eva Shurbi, etj. Nuk mund të mos shënojmë këtu, kulturologun e palodhur , Ndue Tusha.

Atmosfera dhe emocioni, që sillnin asokohe , ardhja e trupave profesioniste, shënuan ngjarje kulturore, që nuk mund të harrohen . Në atë skenë të vogël të qytezës minatore, u ngjiten emra të mëdhenj të artit shqiptar. Ansambli i Ushtrisë, Ansambli Shtetëror i Këngëve e Valleve Popullore, Teatri “Migjeni”, Estrada Pofesioniste e Durrësit dhe e Tiranës, etj. Në këtë klimë, krijoi edhe Kola. Herë pas here na sillte vargje e melodi të krijuara prej tij dhe disa prej tyre jo vetëm u bënë pjesë e reportorit të grupit artistik të Kurbneshit, por patën edhe sukses. Kështu pak e nga pak u bënë shumë krijime, të cilat para do kohe m’i besoi t’ia përgatis për botim. Në këtë libër me poezi popullore, vendin kryesor e zë tema e atdhedashurisë, e cila në të shumtën e herës shpalohep nëpërmjet dashurisë ndaj vendlindjes. Në fund të fundit, atdheu fillon, aty ku lind. Autori, shumë krijime ia kushton vendlindjes dhe njerzëve të saj. ..

Në këtë libër ka disa vjersha, që autori u ka kushtuar artistëve të Selitës si: poetit Gjokë Beci, lahutarit të pashoq, Simon Beleshi, këngëtarit Kol Gjini, parodistëve dhe instrumentistëve, Mark Gjokolaj e Dod Buraku, të cilët nuk jetojnë më, por ka krijime edhe për krijues e këngëtarë të tjerë selitas se ashtu si e cekëm kryehere, Selita është një qiell me zogj...Në këtë libër, shumë motive janë

marrë nga kuvendet ndër odat e Selitës dhe nga traditat e saj, ku ndjehet ndikimi i humorit dhe sarkazmës së mirditasve. Motivet kosovare, janë gjithashtu, krijime me frymë patriotike , ndjeshmëri të thellë e të mbështetura fort në kengën burimore shqiptare.

Me librin , “Zogj në qiellin e vendlindjes”, poeti popullor, Kolë Beci, i bashkohet natyrshëm leksikonit të krijuesve selitas e me gjërë.



LIBRI “MIRDITA NËN TERRORIN KOMUNIST”- DËSHMI TRONDITËSE E NJË STRATEGJIE KRIMINALE

Mora përsipër me thanë dy fjalë për librin , “ Mirdita nën Terrorin Komunist” për arsye se vij nga ato familje, që e provuan keqas këtë dramë nacionale, nga ato familje, që ende nuk i ka gjetur varret. Varret nuk janë gjetur, por gjashtë emrat e tyre, si të shumë familjeve të tjera mirditore, janë shënuar në këtë libër.

Një motiv më shumë , ishte dhe autori i librit , studiuesi Prengë Gjergj Gjemarkaj ,me të cilin jemi rritur në një qytezë të vogël mes maleve dhe kemi ndarë bashkë mendime rreth kësaj sipërmarrje të mundimshme.

Vetë mbiemri i autorit kallxon kthjelltë se Prenga vjen nga një derë princërore, **Dera e Gjemarkajve, me të cilën lidhet historia e Mirditës, vetëqeverisja me kodet antike të kanunit të maleve, qëndresa antioasmane dhe qëndresa e rezistenca anti- komuniste. Ishte Mark Gjemarkaj në krye të kësaj rrezistence, ashtu siç ishin edhe dëshmorët e saj të parë, të internuarit e parë, të bugosurit e të zhdukurit e parë...**

Terrori komunist është një togfjaësh i vonë ndër shqiptarë. Ashtu si vihen re dhe nga autori , në fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe nuk gjendet togfjalëshi, “terrori komunist” dhe as fjala, antikomunist. Ndoshta herën e parë e thanë klerikët e përmendur të kësaj krahine konsevative.

Autori na e qartëson kryehere, përse komunizmi i druhej një krahine si Mirdita?

- Për cilësitë luftarake, të njohura nga brigjet e Moraçes, ku printe Preng Markola, der ne brigjet e Danubit e Krime, ku komandonte, Bib Dod Pasha
- Për orientimin e natyrshëm perendimor
- Për besimin katolik të palëkundur
- Për kontributin e klerikëve, korifej të kulturës nacionale
- Për instirucionin veteqeverisjes
- Për një Princ jo sundues. Gjomarkajt ishin Kreu e bajraktarët, shtëpitë e para ,pra Paria , ishin parlamenti krahinor e kushtetutë-Kanuni i maleve.

Mendoj se autori ka mundur ta jetësoi projektin e guximshëm të tij , duke i sjell lexuesit shqiptar , gjithë opinionit , dëshmi tronditëse të këtij terrori. Pas shfletimit ndër arkiva , Ai ka eksploruar në gjithë Mirditën etnokultuore të unionit të 12 bajrakëve. Në respekt të metodës akademike, libri ka mjaft referenca dalë nga bibliografia e pasur e shletuar prej ti si dhe emrat e përsonave të afërt ose trashëgimtarë të martirëve nationalist, antikumunist'. Mbi të dhënat e observuara prej tij në një horizont kohor 10- vjeçar, autori ka menduar t'a periodizojë strategjinë dhe dramën që solli terrori komunist.

Dhe kështu në libër kemi: **Terrori komunist 1943-1944 dhe 1944-1990. Strategjia e këtij terrori ishte identifikimi i këndërshtarëve, strategji, e cila filloi të zbatohet me atentatin kundër major Ndrec Preng Bajraktarit, komandat i Xhandarmërisë për Shkodrën , deri te plani operativ i vitit 1990 për pushkatimin pa gjyq të 40 përsonave mirditas e të internuar në Mirditë.**

Bash atëhere, kur perandorisë së kuqe të Lindjes po i dridheshin nyjet e po jepte frymë, në Shqipëri baheshin skenar të tillë krimi , ashtu si shkruan Prof.Agron Tufa, ”Praktika e dhunës në Shqipëri në ato vite, është e gjitha e huazuar dhe e zbatuar sipas modeleve më të egra sovjetike të terrorit të madh Stalinist”.

Në periudhën 43- 44 u goditën kryesisht ushtarakë të monarkisë, që

vazhdonin të punonin si ushtarakë. Ishin atentatorët komunist, që hapën siparin e vrasjeve politike. Vetë Vasil Shanto, mori persipër vrasjen e major Prengës në Shkodër, në nëndor '43. Në libër janë identifikuar të gjithë martirët e kësaj periode.

Në kreun: Kundrajë mbi terrorin komunist në Mirditë, autori bën një analizë imtësore të zhvillimeve politiko-luftarake, duke argumentuar me fakte të dokumentuara, strategjine e terrorit komunist në Mirditë. Episodet janë të shumta , por po ndalem me hyrjen e forcave partizane në Selitë , që qëlluan banesat e fshatrëve ... se si dogjën shtëpitë e Gjet Kolë Ndojt e të Can Bardhok Daçit në Rrazë, se si vranë në Baz, dy bazianë, krejt të pafajshëm. "Çlirimtarët" po sillnin terror. Pastaj dhe vallen e kendueme:

Hidheni , hidheni goca kamën/Për shyqyr që e shkelëm Trangën
E kështu, me 26 tetor 1944, partizanët shpallën marrjen e Shpalit, qendër e nënprefektures së Mirditës, pra pushtimin e saj...

"Ndoshta kësaj here kemi të bajmë me pushtimin më të sofistikuar, që kishte parë ndonjëherë historia e popujve" , citohet të ketë shkruar studiuesi, Gjet Ndoj,

Përgjegjësia historike, nënvizon autori, bie mbi ushëheqjen e PKSHE drejtëpërdrejt mbi Enver Hoxhën , i cili ideoi, nxiti e zhvilloi luftën e përgjakshme civile,vëllavrasjen mes shqiptarëve.

Një ngjarje tronditëse me një bilanc tragjik , ndodhi natën e 25 korrikut, në Dukaj të Tepelenës. Forcat e brig. VI-të e VIII-të Sulmuese qëllojnë në befasi trupat e batalionit të xhandarmërisë,"Vermoshi". Kufomat 97 xhandarëve(për numrin ka të dhëna të ndryshme) të bërë shoshë nga plumbat u hodhën në një përrua. Ky ishte një masakrim. Kjo betejë e fituar, është kremtuar me vite të tëra me bujë. Këndohet dhe kënga:

Në Dukaj, në Tepelenë

Filloi lufta e paprerë

Me gjermanë e me rebelë.

Rebelet nga Mirdita

Me llogore gjer te gryka.

Edhe se viktimat ishin nga disa zona të Veriut , vargjeshkruesi, veçon

Rebelët nga Mirdita. Në Tepelenë e në krejt Shqipërinë Mirdita njihej si shinjestra e Diktaturës.

Në këtë studim thuajse shterrues evidentohet se grafiku i strategjisë së terroit ka kurbat më të larta më 1946 dhe 1949.

Në horizontin kohor të këtyre viteve kemi zhvillime intensive të organizimit të rezistencës antiomuniste me Mark Gjomarkun në krye dhe kundërpërgjigjen e ashpër të shtetit komunist ndaj frontit nacionalist, deri në vrasjen e Mark Gjomarkut në Prosek, në Qershor 1946. Pinjollit i Derës Princorë ra, por rezistenca vazhdoi me heroizëm të pashoq. Ata që vrisnin luftëtarët e lirisë shpallehin heronj dhe të rënë të nacionalist “armiqtë e popullit”. Sikundër e cekëm ma herët, 49-ta ishte viti i terrorit të paparë kurrë. Vritet deputeti i Mirditës Bardhok Biba, një vrasje e pastër politike dhe postrënia e tij shoqërohet me terrorin më të egër që njihet historia e kësaj krahine. Katërmbëdhjetë burra varen e pushkatohen bash aty ku qe vra krykrahinari komunist . Burgje, internime. **Edhe autori i këtij studimi, ka qenë fëmi i internuar në kampin famëkeq të Tepelenës.**

Rezistenca vazhdonte maleve të Mirditës e Veriut. Shumë prej tyre u arratisën. Disa u zhdukën dhe shteti nuk jep asnjë të dhënë për atë që ka ndodhur me nacionalistët .

Në libër janë shënuar numri dhe emrat e të pushkatuarve, të varurëve në litar, të vrarëve pa gjyq, të pushkatuarve, të burgosurve, të internuarve, të grave e fëmijëve... Po ta krahasosh me krahinat e tjera e në raport me popullsinë, Mirdita nën terrorin komunist e pësoi më rëndë se askush. Ajo u shpall rreth politik, u nda në pesë rrethe. Bijtë e martirëve e të përsekutuarve iu privua shkollimi, jeta sociale, etj. Trajatat e këtij terrori arritën deri aty sa, për 100 mijë lek të reja shpërdorim, një përgjegjës tregëtie të pushkatohet në mesin e viteve 80-të ose një sondist të pushkatohet për një fuqi naftë të derdhur te sonda. I rëndë e i papërshkruar ishte terrori psikologjik që bënin të ashtuquajturat organizatat e masave, gjykatat e fshatrave mbi familjarët e të përsekutuarve e të përndjekurve.

Pas lëvizjes demokratike edhe letrarët, poetët e studiuesit mirditas

bënë përpekje serioze për t'a pasqyruar dramën që shkatoi diktatura komuniste në Mirditë. E tillë është krijimtaria e shkrimtarit Gjon Mark Ndoi, i cili duke qenë dhe kryetar i shoqatës, botoi edhe disa studime me këtë temë. Kjo letërsi e munguar u pasurua në shumë krijime letrare me këtë argument. Janë botuar monografi e studime, janë shkruar mjaft artikuj me këtë temë, ku përmendim: Nikoll Tomën, Nikoll Lokën, Gjet Dodën, Gjon Nikoll Deda, Ndue Dedaj, Gjet Ndoj, Lek Shtia, Gjergj Marku, Martin Dedaj, Preng S. Gjokolaj, Ndue Bushkola etj.

“Mirdita nën terrorin komunist”, në vlerësimin tim, është vepra më plotë, me të dhëna shterruese për terrorin komunist në këtë krahinë. Kjo është arritur falë përkushtimit dinjitar të studiuesit Preng Gjomarkaj, bashkëpunimit të frutshëm me pasardhës e familjarë të kësaj shtrese, me arkivat, me bibliotekat, me krijues të fushave të ndyshme e, në mënyrë të veçantë, me Prof. Agron Tufa, Drejtor i **Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojeve të Komunizmit, që mundësoi botimin**.

Libri është shkruar me një fjalor të pasur e me ritëm narrativ të lavdrueshëm, ku nuk mungojnë edhe fjalë të reja si për të hedhurit në guva e gropa, ai përdor fjalën, gropos e jo varros dhe kur janë gjetur eshtrat e martirit, autori shkruan, zhgropos e jo zhvarros se varrosja bëhet sipas riteve e dokeve e nuk hidhet në gropë si të ishte një rrobe e vjetër.

Rinia mirditore, do gjej në faqet e këtij libri emrat e gjyshërve e stërgjyshërve të tyre të martirizuar, por edhe të humbur jo për t'u hakmarrë me bijtë e tyre, por për të kuptuar se e shkuara mund të përsëritet.

Po mbyllim këto shënime me një sentencë të poetit nobelist Aleksandër Solcshenicin si kryemesazh për të gjithë brezat që vijnë:

“Nëse merremi vetëm me të kaluarën, na plastë njëri sy, po nëse do të harrojmë të kluarën, na plaçinn të dy!”

Gazeta 55, datë 15 qershor, 2017

SHËNIME NGA KRONIKA E NJË JUBILEU

-Tetëdhjetë vjetori i shkollës shqipe në Selitë, 2003

Tetëdhjetvjetori i shkollës së parë shqipe në Selitë, u kremtua me vendim të Këshillit të Komunës Selitë, në pranverën e vitit, 2003 Dom Vlash Muça, famullitari i Selitës, në vitet 1921- 1949, njëri ndër klerikët që sherbeu më gjatë në atë famulli, më 1923, hapi shkollën e parë në Selitë, duke shënuar ngjarjen e parë arsimore, në atë zonë.

Më, 2003 , në 80-vjetorin e shkollës së parë, shkova në një fshat të Fushë-Krujës dhe me ndihmën e Ndue Llesh Arapit , gjeta shtëpinë, ku kishte lind dhe kish ndërruar jete inspiruesi dhe mësuesi i parë, Dom Vlashi. Qëllimi ishte, të mund të gjenim ndonjë relikë, shënim a kujtime, por vetëm tri foto të tij mundëm të gjejmë. Familjarët, që mbanin mbiemrin Lesi, kishin migruar në Mallkuqe nga Oroshi, na i dhane ato. Njerën prej tyre, pikerisht atë që piktori Pjeter Marku e pikturoi në një format 80x60 dhe e vendosëm në shkollën e Bardhajt, krahas Fishtës , Naimit, Kadaresë, Konicës dhe Artistit të merituar, birit të Lëkundës, Preng Lekunda.

Këshilli i Komunës Selitë i ka dhënë titullin:”Qytetar Nderi”, pas vdekjes. Në ceremoninë e dorëzimit të titullit, erdhën në jubileun e 80-te, të shkollës në Selitë, familjarët e klerikut patriot e arsimdashës si dhe prifti i famullisë së Bilajt, ku Dom Vlashi pati sherbyer në vitet e fundit të jetës së tij.

Kronika e këtij jubileu, që ishte një ngjarje për arsimin e kulturën

në Selitë , shënoi shumë episode mbresëlënëse për breza të tërë nxënësish dhe mësuesish . Në atë pranverë të vitit 2003, Komuna Selitë, organizoi të parin përvjetor të shkollës së parë në Bozhiq(Bardhaj) . Kishte patur edhe më heret perpjekje për të berë kremtime , por ato kishin mbetur në kuadrin e disa referimeve , që asohere i quanin sezone shkencore. Në keto referime nuk citohej kontribuesi kryesor për hapjen e saj, famullitari Dom Vlash Muça jo vetëm se ai ishte një klerik katolik, por se , më 1947, qe dënuar me burgim për bashkëpunim me reaksionin ...

U përmendën atë ditë emrat e nxënësve të parë të shkollës, por i pranishëm

ishte vetëm, Ded Përndreu, që asokohe jetonte. Kujtuam me nderim e respect ish- drejtues të shkollës së Bardhajve dhe të shkollave të tjera të Selitës.

Ndër të tjerë drejtori i Shkollës 8-vjeçare të Kurbneshit , Ndre Picaku (1965-1968) jo vetëm se për herë të parë, do të hynte në program një gjuhë e huaj(gjuha ruse), por se nën drejtimin e tij mori vrull lëvizja artistike në atë shkollë, që për shumë vite kishte ndër grupet më të mira artistike në shkallë rrethi. Natyrshëm, artistët e vegjël të kësaj shkolle u bënë fidanishtja e shtëpisë së kulturës së Kurbneshit, duke shënuar kështu një traditë të bukur.

Përpos gjithë strukturave të pushtetit lokal, mori pjesë në kremtime ish- kryetare e Bashkisë Rëshen, Marije Biba, N/prefekti i Mirditës, Bardhok Pulaj, përfaqësues të Qarkut Lezhë, Drejtorisë Arsimore, veteranë të arsimit në atë zone. Mes tyre dhe ish mësuesi i Zajsit, poeti Gjokë Beci ,Mjeshtër i madh. Asnjëherë nuk kishte patur në oborrin e saj kaq selitas e të ftuar ,kjo shkollë, e cila qe zbuluar me një dekor festiv e me një mikromuze, që u pasuria edhe me relika të zbuluara rishtas.,

Folën aty drejtori, Kolë Margjini, ish – drejtorët: Pashk Lika, Nikoll Bushkola, poeti Gjokë Beci, Familjarët e Dom Vlash Muçës, që mori titullin e nderit .

Për mua mbetet një kujtim shumë i bukur bashkëpunimi , që pata

me n/prefektin, Bardhok Pulaj , piktorin Pjetër Marku. trupën pedagogjike të shkollës si dhe me gjithë arsimdashësit e asaj komune të largët e të varfër.

Në këto kremtime u bë homazh për ata , që kanë ikur këso bote... Në krahun tim, kryetar i komunë Selitë asokohe, në këtë jubile ishte, ish- kryetar i Bashkisë Rëshen , Pashk Biba(ma vonë Drejtor Rajonal i Arsimit), që kishte ardhur me statusin e familjarëve të ish- drejtorëve. I biri i ish -shefit të arsimit dhe kulturës, në Mirditë , Zef Ndue Prenga. Më kishte mbetur në mendje e , që nuk do ta harroj kurrë , një episod, në vitin 1961, kur vazhdoja klasën e parë dhe mësues Zefi na pati pyetur me radhë , se çfarë do bëheni, kur të rriteni?. Shokët e shoqet e klasës u përgjigjën sipas dëshirës së tyre . Dikush tha, mësues, dikush, minator, inxhinier...Po ti, m' u drejtua mua, që isha në bankën e fundit. Drejtor, iu përgjigja ngadalë.. Më pa me një vështrim prindëror, buzëqeshi dhe më hodhi dorën e tij të butë mbi supin tim të njomë...Kështu i thashë në atë mot të largët, por statusin e drejtorit nuk e mora kurrë...

Një ish -nxënës , foli me mall, respekt e mirënjohje për Mark Arapin, ushtarkun e Akademisë Ushtarake të Modenas, Itali, që i kishte mësuar matematikën. Dhe jo vetëm ai. Të gjithë bezat, që kishte mësuar Mark Arapi, sollën kujtime e vlerësime pafund. Edhe një student i Akademisë së Leningradit, Llesh Tarazhi, pas ndërprerjes së studimeve , vazhdoi për mësuesi. Por , pati edhe mësues, që u bënë ushtarakë...

Në vitet “60-të e në vijim u zgjerua numri i shkollave tetëvjeçare në Selitë, deri sa në vitin 1969 , u hap Shkolla e Mesme Elektromekanike(natën) e ma vonë shkolla bujqësore, ku ndiqnin mësimet nxënës nga gjithë zona.

I kujtuam atë jubile , që nga mësuesi i parë në Qelën e kishës, Dom Vlash Muça, Mark Legisin, por edhe mësuesit e parë pas luftës së dytë botërore si Xhelal Ukën, Preng Pjetër Burakun, Bib Gjini Gjokolën ,Nikoll Bib Lleshin, Frrok Përgjoni, Kol Picakun, Pjetër Tomën, etj, që shumë vite shërbyen në shumë shkolla të Mirditës.

Në Selitë erdhën mësues nga Kosova, Mati, Dibra, Shkodra, Durrësi, Vlora, Saranda, Korça, Tirana...

Mësueset e para ishin Vasilka Bojaxhiu, Vasilika Baca dhe Pina Martinini, të cilat ishin edhe veprimtare të shquara në lëvizjen artistike. Pina Martini vuri disa drama në skenën e qytetës minatore si, Hijet e Natës, Gjaku i Ri, Heronina... Mësueset e para selitase ishin: Marije Kolndreu Marku, Marije Gjokolaj Llusku, Martine Mikeli, Marte Gjokolaj, të cilat dolën nga shkolla "Shejnaze Juka", Shkodër.

Shumë nga mësuesit e mësueset ishin qifte. I pari ishte qifti Martini. Kolec Martini vinte nga Tirana. Ish- shok klase me Ramiz Alinë, largohet nga Aparati i Komitetit Qendror dhe bëhet mësuesi im i kasës së dytë. Pastaj qifti Kelmendi. Selim Kelmendi, pejani që erdhi në shtetin amë e u martue me Aferdita Kelmendin... Mësues Selimi, që më mësoi në klasën e katërt i dha fund jetës në burgun e Burrelit..., qifti Baca (Mihal e Vasilika Baca) nga Korça.

Po përmend dhe qiftet e tjera sipas rendit kronologjik: Gjovalin Ndoj e Davida Ndoj, Preng Syziu, Marije Syziu, Gjon Çoku, Davida Çoku, Dod Lleshi, Prena Lleshi, Rexhep Ahmeti e Zana Ahmeti, Mark Kala, Age Kala, Bib Llusku, Izmini Llusku, qifti Ndoku, Legisi, Vokri...

Drejtuese femra në Selitë (Kurbnesh), Aferdita Çeliku, Marte Bushi, Violeta Cara, Marte Arapi, etj.

Të paharruar do mbeten mësuesit e ardhur nga Kosova, në Kurbnesh e rrethinë jo vetëm për kontributin e tyre, por edhe për dramën e tyre: Selim Kelmendi, Rexhep Ahmeti, Ymer Llukaliu, Gani Demiri, Xheladin Vokri, (kosovar i lindur në Kurbnesh).

Selim Kelmendi ndërroi jetë në burg politik, Ymer Llukaliu dhe Gani Demiri u arrestuan në Kurbnesh dhe u dënuan me burgime politike.

Kujtoi se pati mendime, që shkollës së Bardhajve t'i hiqej emëri, "Bajram Curri" dhe t'i vihej emëri i Dom Vlash Muçës. E kundërshtova prerazi. Biri i Gjakovës ishte dhe mbetet mik i madh

i Selitës...

Në hartën administrative të Mirditës, Selita për do kohë pat kaluar me Matin. Kur u rikthyen me Mirditën , mbetën jashtë kësaj harte, Gjoçaj, Lami i Madh, Zall Gjoçaj, që janë pjesë autentike e Selitës etnokultuore.

Nga nxënësit e shkollës në Selitë, shumë janë bërë emra të njohur të shkencës, kulturës, letërsisë e politikës.



PER TEKSTET E FATOS HOXHËS

Tekstet e Fatosit i kam njoftun para shumë motesh. Këto, që kishte shkruar sëvoni ma mbushën zemrën me mall e sytë me lot... Tue këndue këto tekste e tue ba ndonji shënim a korrektim , ndjeva thellë vetes teme një gzim të pamatë . Nji libër që dëshmon me mjete artistike, nji kohë të pakohë, nji stinë plot vlime e trazime, plot vrulle e zhgënjime, andrra e zhgënjandrra.

Nji mall përvlues shpalohej në poetikën e Fatosit, poetikë, që nuk mungon në krejt shkrimtarinë e tij. Atlasi i viseve, ku janë përjetue motivet e derdhuna në këtë libër ngërthejnë nji territor të gjanë nga Shkodra , Gramshi, në Shënapremte, Devoll , Korçë ,Vlonë, Tiranë...

Kam ba qudi , dhe kjo asht vrejttja e parë. Nuk asht shkruar asnji rresht për kohën e ushtarllekut. Ma shumë se dy vjet kemi qenë ushtarë në nji vend që kishte emnin e nji shenjtorit, në Shënavlash të Durrësit. Dhe vinte prej nji zone të Gramshit, që mbante emnin e nji shenjtneshe, Shënapremtes....

Para dyzet e dy vjetësh, bash në atë vend, që mbante emnin e shenjtorit sulmoheshin shenjtnit, por miqësinë tonë e bekoj dashuria ...Fatosi, nuk ishte hokatari, por kryehokatari i batalionit, ishte gazmendi i tij...Shumë i hapun me shokë, korrekt në stevitje e n' msime të tjera ...Duke qene i dishepulli i Agollit, bashkëfashatarit të tij fisnik e madhështor, ne e forcuem natyrshëm shoqinë tonë. Ndërronim libra, kuvendonim për to, shkëmbeuim poezitë e njani-tjetrit dhe shpejt pergatitën kandin e letrarit të ri...Na, patëm shkruar

nji thanie të Majakovskit: „Dhe fjala e vargu, bombë e flamur“ dhe disa krijme të letrarve te repartit. Të nesërmen na thotë komisarit se ato fjalët e atij poetit rus nuk na duhen. Ne kemi porosinë e shokut Enver...Mbaj mend që na tha me shkruar një citat , që me sa kujtoj tash pas 40 e kusur vjetësh ishte: “Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmësa të Partisë...“ Anise nuk na qortuen, kjo rasë na bani me qenë ma te kujdesshëm se bashkë drejtonim grupin e estrades, ansamblin, teatrin, mramjet tematike...Reparti ynë ishte ma i dalluemi për këto veprimtari dhe në shtator 1975 , bashkë me Fatosin, ishim moderatorë të mbramjes tematike , me regjizor aktorin e teatrit të Esdradës së Ushtarit , Lavdim Kreshpa. U ndoq nga perfaqësues nga gjithë ushtria dhe pjesa u trasmetue në Radio Tirana , Emisionii Ushtarit...Asohere nuk ishte pak. Pati lavdrime edhe në shtypin ushtarak rreth kësaj veprimtarie, që organizohej si model në shkallë ushtrie.

Po edhe kur na çuen pasi kryem ushtrinë, në aksion nga Durrësi në Gegë të Kuçovës, u aktivizuem me grupin e estradës së fshatit Gegë...

Pas ushtrie , unë shkova në vendlindje, në Kurbnesh e Fatosi në Devoll.

Shpejt më erdh një letër nga Grabova e Sipërme...Nuk më qiti në harresë kurrnji herë...

Ai punonte mësues në një zonë të thellë, por unë po kalojsha vitet ma të vështira të jetës...Kurrnji herë nuk ja bana me dije gjendjen teme...

Kështu çonim e merrnim letra e kartolina , që i mbyllte :Me mall, Fatosi. Kur në një funddhjetor të viteve ,70-të , nënshkuante : Fatosi e Bajamja, ndjeva gzim të madh për mikun tim. Kishte gjetun shoqen e jetës...

Tue i mbyll këto shënime , lejomë të propozoj , që titulli i këtij libri të pagëzohet me togfjalëshin, **DHEMKË E MALL**

Ja dhe një nga kartolinat për ditëlindjen tuaj:

*Ajo ditë ,do të ketë qenë ditë me diell
Dhe qielli qeshte mbi Menkulas
Vatra tha: Mirë se erdhe bir!
Dhe ti, erdhe buzagaz...*

*Buzagaz, por stina nuk qeshte sakaq
Bota mbeti po ajo: një katrahurë
Dhe ti mbete po ai, gjithë nur e gaz
Edhe fëmijë, i ri, e burrë.*

*Dhe kështu do jesh ngahera
Miku im i kahershëm
Me zemër të uroj dhe njëqind të tjera
O, hokatari im i pa ndreçshëm!*

*Lezhë, fillim korriku, 2015
Fatos Hoxha, Dhembkë e mall*

MUZOU
SHTEPIA BOTUESE

KULLAT I NGITËM VETËM PËR ARBËR

Për monografinë "Kullat e Bardha" të studiuesit
kurbinas, Vlash Prendi.

§apo nisa të shkruaj këto radhë për monografinë, "Kullat e Bardha", të studiuesit nga Kurbini, Vlash Prendi, m'u kujtuan dy vargje të këngës së njohur mirditore:

Lokja e moçme, me djep mbi bakër
Kullat i ngriti, vetëm për arbër..

-Mbi kodra e male, malsorët nuk i ngritën ato, vetëm për banesa. Arkitektët e moçëm të viseve veriore nuk i projektuan, vetëm si çerdhe, ku do të ngjizej jeta njerëzore, por edhe si vendroje, si vendkomanda, si fortesa. Dhe ashtu, me themele mbi mademet e rralla, që pirustët ilir i patën pikasur e përpunuar fort herët, ato u bënë dhe mbetën, dëshmi të sulmeve mijëvjeçare dhe roje të përjetshme të identitetit arbëror.

Nuk është rasa të hallakatemi fort rreth argumentit, "kullë", por të mundohemi të rreshtojmë dy fjalë rreth librit, që përmendëm kryehere. Autori, në qëndër të kësaj monografie, ka një nga simbolet e rezistencës antikomuniste, në Mirditë dhe shumë më gjërë. Ai është Frrok Mëlyshi, bir i bajraktarit të Kthellës (Thkellës), vazhdim shembullor i lisit të gjakut të vet, derës së njohur të Melyshajve.

Unioni mirditas, ashtu siç shkruan shkrimtari dhe studiuesi i njohur, Ndue Dedaj, ... "Ka qënë në thelb një bashkëqeverisje konstitucionale, mes kapidanit dhe krerëve të Mirditës. Ky përbën

një fenomen tipik vetqeverisës ndër malësitë shqiptare, që e përforcon më tej dhe idenë e shtetit etnokulturor.” Mirditasit ishin të pranishëm, që në qeveritë e para pas 1912-tës, përfaqësuar nga Preng Bib Doda, e thënë tjetërsoj: Paria e Mirditës , i ka përkrahur zhvillimet pozitive përgjatë gjithë historisë së saj. Por, me ardhjen e ideve komuniste në Shqipëri, Mirdita reagoi me forcë kundër tyre , sidomos pas luftës së dytë botnore. Në këtë kohë Paria e Dera Princërore e Gjomarkut, organizuan qëndresën anti-komuniste. Në fletët e kësaj monografie ,pasqyrohet gjërësisht veprimtaria e çetave të malit, përpjekjet ndër prita , rëniet e luftëtarve të lirisë . Është meritë e autorit, që luftëtarin e lirisë , birin e kullës së Serrishit, na e portretizon si trim mes trimash , si rod mes djemve të rodit, si martir mes martirëve. Dhe kështu shfaqet Frrok Mëlyshi në Gardën Mbretnore, si oficer, ne logkuvendet , si kuvendar e pleqnar i urtë e i matur, vijim i mirë i traditës shekullore të maleve e të votrës ku lindi .

Bajraktarët e Kthellës kishin lidhur miqësi heret e vonë me kulla të tjera të bardha të krahinës . Ndoshta me Gjomarkajt më shpesh... Kështu Mark Gjomarkaj, kryetari rezistencës , nuk mund të mos ishte personazh i librit, ashtu si miqtë e bashkëluftërët e lirisë, Gjini Kros Buna, Ndrec Preng Bajraktari, Muharrem Bajraktari, Preng Dodë Gjini, Ndue Lala, etj.

Këta, e shumë emra të tjerë, janë përmendur edhe në shkrime para viteve '90, ku është shkruar për „heronj të lavdishëm“, që nderonin kombin, duke ia servisur lexuesit si modelin, që duhet ndjekur si dhe , armiq të betuar të popullit , të cilët ndiqnin një udhë anti-kombëtare. Se kush e futi frymën anti-kombëtare dhe luftën midis shqipëtarëve e tregon kthjelltas bilanci tragjik i kësaj ndeshje, e tregon mortaja , luftë klasash, që sot çuditërisht përmendet jashtëzakonisht rrallë nga nja 2-3 përfaqësues të së djathtës reale në Kuvendin e Shqipërisë (Ndërkohë , nuk ka ditë që në shtypin e përditshëm të mos shkruhen kujtime për diktatorin dhe diktaturën). Sot, të thuash se vjen nga një familje e përsekutuar, është gati

njëlloj sikur të thoshe para 90-tës se jam bir i një kulaku, bajraktari , a se ke të afërm të arratisur (O zot sa thellë e ngulën urrejtjen klasore!). Nuk është e vështirë, të dallohet lehtë se , në vënde kyçe të shtetit e të pushtetit të sotëm janë pinjollët e atyre që instaluan me dhunë të pashembullt sistemin komunist , që zhvilluan luftën e klasës si forcën kryesore për të mbajtur pushtetin monist , që shëmbën objektet e kultit dhe e kthyen vendin tonë në të parin vend ateist në botë . Të gjitha këto që ndodhën në Shqipërinë e pas luftës së dytë botnore, i patën pararajmëruar krerët e levizjes antikomuniste dhe krerët e klerit, sidomos ata të klerit katolik, Por, në ato kohë të mjergullta, kur kur komunizmi trumpetoej si e mira e njerëzimit ,pati të rinj të së djathtës , që e përkrahën këtë sistem. Nga kullat e bardha të Oroshit, të cilat, herën e fundit u dogjën , më 1944-tën ,unioni i 12 bajrakëve të krahinës, që ishte vatër e qëndresës antiosmane, mori mesazhin për të ngritur rezistencën antikomuniste. Edhe në krye të kësaj qëndrese, do të ishte pinjollit i këtij Oxhaku, Mark Gjomarkaj, i cili gjatë luftës, kishte qenë dy herë ministër i Shqipërisë: Ministër i Brendshëm dhe ministër i Kulturës e Traditës. Lidhur me këto funksione të larta ,ka mjaft mendime e vlerësime , që në të shumtën e herës e ngarkojnë me përgjegjësi kapidanin e ri, por mos të harrojmë se, kur ishte ministër ai jo vetëm se ato qeveri i kryesonin burra të shquar e dijetarë të përmendur, por ato qeveri mbulonin krejt trojet etnike të Shqipërisë. Dihet se sa politikan atdhetar u tregue shkrimtari i shquar Ernest Koliqi, i cili si ministër i arsimit, dërgoi në në trojet jashtë kufijve shqipërisë londineze, 200 mësuesit më të mirë të kohës, mes tyre edhe Mësuesi i Popullit, Ndrec Ndue Gjoka. Krerët e të Djathtës mendonin se, me mbarimin e luftës dhe largimin e pushtuesve, shqiptarët, do të zgjidhnin njëherë e mirë problemin e Shqipërisë Etnike. Me mbarimin e luftës së dytë botnore, shumë nga krerët e të djathtës, morën udhën për Europë, por ashtu si e thotë muza popullore: “Biri i rodit,burri i dheut/Gjallë s’ia kthei shpinë atdheut“, Mark Gjomarku, në krye të rezistencës qëndroi

besnik kauzës së tij, deri sa dha jetën. Ai ra, por rezistenca vazhdoi me intesitet të lartë. Në libër, nëpër mes shkrimeve të mërgimtarëve politik, Nikoll e Ndue Melyshi si dhe shkrimeve të shtypit, këngëve popullore ,etj, shpaloset veprimtaria e njerëzve të malit, epika e ditëve, muajve, viteve ndër malet e Mirditës, Dibrës, Matit, Kukësit, Pukës e Tropojës, epika e kalimit të kufirit dhe e desantimeve, vështërisive pafund të jetës në arrati, idealizmi i pashembullt ndaj kauzës së tyre, për një shtet demokratik, ku të respektoheshin të drejtat e liritë e individit e të ruheshin rrënjët e identitetit të nacionit tonë. Mendojmë se është bërë kujdesi i nevojshëm për të qëndruar larg amplifikimeve, që i ndeshim jo fort rrallë në librat, që shkruhen me argument nga këto zhvillime.

Siç e cekëm edhe më heret, në letërsinë dokumentare, që ngerthen këtë periodë , edhe para viteve '90-të dhe pas lëvizjes demokratike, kemi dy pamje: Para viteve '90-të, ka teprime dhe pasaktësi të dukshme, por dhe ideologjizim të skajshëm. Ata që u vranë nga forcat komuniste me gjyqj e pa gjyq, u shpallën armiq të betuar të popullit dhe partisë, u internuan familjet dhe privuan nga të gjitha të drejtat si për shkollimet etj. Me vrasësit ndodhte ndryshe. Buste, këngë, filma, romane me temën e vigjilencës dhe privilegje për familjarët e farefisn. Sot, bijtë e tyre ndihen të persekutuar, kur i largon nga posti i një drejtori apo nuk u festohen ditë-ëniet e gjyshërve a njerëzve të afërt, kur bashkëmoshatarët e tyre, djemtë me rrënjë gjenetike te kullat e bardha, u dënuan , u përçmuan për një gjysëm shekulli. Si shtresë , që në damarë u rrjedh gjaku i kaltër, asnjëherë nuk kërkuan hakmarrje, por askush nuk u kërkoi falje...Libri,"Kullat e Bardha" ashtu si shumë libra të tjerë, të shkruar pas lëvizjes demokratike, sjell dëshmi të reja nga kronika asaj kohe. Në shkrimet e Z. Nikoll Melyshi, Ndue Melyshi, Ndue P.Gjomarkaj, Gjon Mark Ndoj e të tjerëve , hidhet dritë mbi veprimtarinë e lëvizjes antikomuniste në Mirditë e më gjërë. Shumë ngjarje e episode trajtohen krejt ndryshe nga letërsia dokumentare e para viteve '90-të. Sillen dokumenta e dëshmi autentike të njerëzve të malit e të mërgatës shqiptare për

vrashjen e Pal Melyshit, Bardhok Bibës, etj., që lexuesi nuk i njihite më parë. Studiuesi, Vlash Prendi, me këtë monografi nuk pasqyron vetëm veprimtarinë e njërës prej luftarëve më të shquar të asaj kohe, siç është Frrok Melyshi, me trupin e pajetë të të cilit , u bë njëra ndër aktet më mizore të diktaturës, duke e djegur atë në flakë, por ndriçon edhe portrete të tjera të kësaj rezisrtence, djem të kullave të bardha, që nuk e përllomën ballin para Mirditës, para historisë... Monografia sjell prurje të reja bashkë me mesazhin sociokulturor që përcjell, e më së shumti, për brezat , që nuk e kanë jetuar atë kohë.

Lezhë, më 19.09.2009.



NJË JETË KUSHTUAR DIJES DHE PAJTIMIT

**Monografi kushtuar “Mesuesit të merituar“ dhe pajtimtarit të
shquar, Pal Kuka
nga Prof.As. Dr.Qazim Dushku**

Das botimeve të shpeshta të një vargu studimesh e monografishë, kryesisht të fushës psiko-sociale e pedagogjike, Prof. As. Dr., Qazim Dushku, nxori në qarkullim monografinë, ”Një jetë kushtuar dijes e pajtimit”.

Kjo monografi i kushtohet njërit prej pajtimtarëve më në zë të Verut të Shqipërisë, z.Pal Kuka, i cili është ndër mësuesit e parë me titullin ; ”Mësues i merituar” në vendlindjen e tij, Mirditë. Autori, duke qenë koleg dhe bashkëpunëtor në ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fondacionin: ”Zgjidhja e Konfliktëve dhe Mosmarrëveshjeve”, me qendër në Tiranë, ka marrë impresione e shkëmbyer përvojë prej shumë vitesh me personazhin e monografisë. Kjo njohje e afërt i ka dhënë mundësi të mjafta studiuësit për të shpaluar kontributin e veçantë të Pal Kukës. Si mësues e drejtues arsimit në vendlindjen e tij, lexuesi njihet me cilësitë e dallueshme të Palit si mësues, si : Aftësia për të menaxhuar klasën në orën e mësimit dhe jashtë saj, zotësia për të ndërtuar punën në grupe, orientimin e shpejtë në situata konfliktuale, ku udhëhiqej nga parimi pedagogjik se, në procesin e dukimit nuk ka vogëlsira, vizionar dhe dhe udhëheqës mësimit kurrikular,

ekspert i vlerësimit, etj. Vendin më të rëndësishëm në libër e zë veprimtaria e personazhit si ndërmjetës, mediator dhe pajtimtar. Në këtë këndvështrim, monografia i ngjan një manuali pajtimi, ku janë shënuar në mënyrë imtësore cilësitë, që duhet të ketë një pajtimtar a ndërmjetës, hapat , që ai duhet të ndjek në procesin delikat të ndërmjetësimit, fryma tolerante e humane në marrëdhënie me palët, ndershmëria, paanësia dhe identifikimi i bashkëpunëtorëve me emër të mirë në publik. Duke iu referuar herë pas here veprimtarisë së dendur të Pajtimtarit, në fletët e kësaj monografie shënohet kthjelltas e gjithë infrastruktura e pajtimit të gjaqeve në trevat, ku fenomeni i gjakmarrjes ende vepron dukshëm. Autori i ka kushtuar vemendje të posaçme sinkonizimit kreativ, që Pal Kuka, i ka bërë traditës së vyer të krahinës së Mirditës dhe ndërmjetësimit të kualifikuar, në klimën e zhvillimeve demokratike dhe dukurive të reja të panjohura më herët në shoqërinë tonë.

Ai, mblodhi me zell e dashuri kodet e kuvendit tradicional të Veriut, shfletoi literaturën bashkëkohore të ndërmjetësimit dhe u bë kreu i pajtimtarëve në viset e tij. Rezultatet ishin befasuese, sidoemos në vitet e vështira 97-98, të shekullit të kaluar. Të qenit mësues me përvojë dhe intelektual me integritet të lartë, ai me veprimtarë të tjerë, hartuan disa thirrje për paqtimin e situatës së ndezur.

Autori i monografisë, duke qenë edhe mediator për rrethin e Lezhës, por edhe Drejtor i DAR, Lezhë e vështron shkollën si një ndër institucionet më të rëndësishme për emancipimin dhe civilizimin e rinisë, kultivimin e qytetarisë dhe tolerancës në marrëdhënie me të tjerët dhe rrëfen bashkëpunimin e tij, me mësuesin pajtimtar për shumë aspekte të ndërmjetësimit.

Pajtimi gjaqeve në Mirditë dhe jashtë saj , e bëjnë Pal Kukën të njohur thuajse në krejt hapësirën shqiptare si një misionar fisnik e humanist të shquar. Në kujtimet , që kanë dhënë në këtë monografi, personalitete të tilla si: Prof.Ismet Elezi, Akademiku Mark Tirta, Mësuesi i Popullit, Mark Vuji, Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit, "Zgjidhja e Konflikteve dhe Mosmarrëveshjeve", Rasim Gjoka,

piktori Pjetër Marku, poeti Preng Cub Lleshi, Alma Tafani, Bashkim Delialisi,, Albet Favreaumontreal,(KANADA), publicisti, Preng Baloj, poeti popullor Jak Tuci, Gjokë Gjoka,V. Gjokolaj etj e bëjnë më të plotë profilin e mësuesit pajtimtar.

Në përmbyllje të këtyre shënimeve rreth monografisë, kemi të drejtë të themi se prof,As.Dr. Qazim Dushku, falë një gjuhe të kthjelltë, analize të imtë të kontributit pedagogjik, publicistik e shoqëror të Mësuesit të merituar, njeriut të paqes e mirëkuptimit, i ka dhënë lexuesit , portretin model të intelektualit me integritet të lartë, përkushtim të pazakontë e humanizëm e iluminizëm të pashoq, duke përcjellë mesazhe paqe e mirëkuptimi në klimën e zhvillimeve integruese.

Gazeta Lissalba ,dhjetor ,2008

MUZGU
SHTEPIA BOTUESE

POEZI ME ERËN E STINËS SË VET

-Për vëllimet poetike “Me zemrën e u zura keq”, të Ded Shkurtit dhe “Relievet të shpirtit”, të Dod Pjetrajt

... Deda për t'u mbajtur mend në skenën e Rëshenit dhe Doda, biri i njëjës prej vajtimeve më në zë të Mirditës, brenda vetes, do mbanin indin prej poeti. Doda botoi ndonjë poezi heret ndërsa Deda del me shkrime publicistike, poezi shkruan për vete... Ka do kohë, që dy ish-maturantët e medaljeve të arta, dalin para lexuesit me librat e tyre të parë me poezi. E përbashkëta e këtyre vëllimeve shpallet, që në titujt e tyre. “Me zemrën u zura keq” dhe “Relievet e shpirtit”. Poezia e tyre është konkrete e jo rrallë prirret kah kumtet filozofike. Forma kryesisht e rregullt e vargut si dëshmi e respektit ndaj traditës sonë të vyer. Bie në sy leksiku i përdorur në mënyrë racionale ,por edhe ai “professional”. Në krijimet e Dedë Shkurtit, lexuesi gjen individin e brezit të vet , të kërrusur nga pesha drithëruese e dilemave, zhgënjimeve të shumta. Ky individ i një shoqërie të mbyllur, të privuar nga fjala e lirë, është kryesisht intelektual i kohës. Zhvillimet e reja në vendin tonë e gjejnë atë disi të lodhur, disi në udhëkryq...Kohë të reja, teknologji të vjetra, marrëdhënie të quditshme si në poezinë mjaft të spikatur,” Sfida e dallëndysheve” ose “E shtuna e madhe në Shqipëri”, “Shekull i mbrapshtë”, “Burri i anëtares së kabinetit”, “Shëmtimi’, etj.. Po kështu balada e Zepës dhe Himarë-Vunoit, janë nga më të bukurat poezi të librit. ” Me zemrën u zura keq” ,.

E shkruar heret a vonë, poezia e Shkurtit mban erën e stinës së vet, pak shkëlqim në sfondin ‘gri’ të ngjarjeve, gjë që dëshmohet në lirikat e dashurisë ashtu edhe në lirikën sociale, duke na dhënë kështu, një tablo poetike me kolor të pasur, i cili do t’iu qëndrojë viteve. Mendoj se nuk mund të ndodh ndryshe me poezitë, ‘Gostivari’, ‘Pjetër Bogdani në Shëngjergj të Mirditës’, ‘Tualeti i vdekjes’, etj.

Krijimtaria e Dod Pjetrajt, priret nga përgjethësimi artistik i agumentit. Arkitektura e vëllimit, ‘Relieve të shpirtit’, është e mirëmenduar. Edhe se lënda poetike është e shtrirë në pesë cikle, ajo ka një unitet të brendshëm si, shpirti im i thepisur... i blertë...gri... në troje...në atdheun e Dantes. Timbri i lirikës së Pjetrajt sjell një prurje interesante në lirikën e sotme mirditore e më gjërë. E ngrohtë, transparente e me ndjesi të holla, ajo kulmon në ciklin, ‘Shpirti im i blertë’

Kurora e diellit, ku vajti, ku?

Kur mosha ime, thotë mesditë

Po zhytem, në të errtit sytë e tu

Dhe shoh si vishem, i tëri me dritë.(Sytë e tij)

Të këtij kuotimi artistik janë poezitë, ‘Duke kujtuar ty’, ‘Muret’, ‘Vetmia’, etj.

Relievi i shpirtit thepiset. E si mund të ndodhë ndryshe, kur mes nesh brof Juda Iskarioti, karrocën e vjetër e braktis i zoti për t’u bërë politikan e poeti njom buzët me shaminë që shtrydh nga pritja.

Për rreth vatrës, te shtëpia e vjetër, në vendlindje, kërkohet një emër për arbërin, kuvendohet me Eseninin, ia fal të gjitha atdheut, dhe vetë shpirtin, pa kërkuar të marrë asgjë prej tij. Libri ka edhe lirika të ngrohta familjare nëse mund të themi edhe kështu për poezitë e krijuara për nipin e tij të dashur. Raporti i gjyshit poet e ndërtues me niprit është poezi plot ndjenjë e humanizëm.

I freskët e plot mbresa vjen te lexuesi cikli, ‘Në atdheun e Dantes’, ku poeti sërish e mban shpirtin te Drini i tij..

Në poezinë, ‘Duke biseduar me lumin, Po’, poeti shkruan.

Te ti erdha, o lum
Për të parë, ta përsërisja emrin,
Po,Po,Po.
Kur erdha e të pashë,
Thashë:
Jo!
Desha Drinin.

Krijimtaria poetike e Pjetrajt dhe e Shkurtit mendoj se vjen në poezinë e sotme, me profilin e saj. Me erën e stinës së vet...

Gazeta, "Mirdita",DHJETOR,2002

MUZGU
SHTEPIA BOTUESE

I FILLIKATSHËM

“Gjethi i këputur në vjeshtë”, vëllimi poetic i 159-të i poetit Adem Zablluzha.

Me poezinë e poetit prizrenas ,Adem Zaplluzha jam njohur prej shumë motesh,por pjekjen e parë e shënojmë, në Takimin Poetik Kombëtarë,” Ora e Muzës,Lissus,2016”, organizuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë dhe Klubi i Letrave të këtij qyteti, në 145 vjetorin e datëlindjes së poetik kombëtar,”Gjergj Fishta’.

Kam ndjerë impresion të veçantë ,kur poeti nxori nga çanta 20 vëllimet e fundit me poezi.Nuk më kishte ndodhë ndonjëherë ,që një autor të më sajdis me njëzet veprat e tij.

Adem Zaplluzha është i fillikatshëm në historinë e letërsisë shqipe e më gjërë.

Plot 159 vëllime poetike. Askush nga poetët e deritashëm nuk i ka botuar,madje nuk kemi asnjë dëshmi se mund të kenë, qoftë edhe në dorëshkrim një korpus të tillë gjigand.

Para do kohe, kur më dërgoi vëllimin e njëqind e pesëdhjetë e nëntë, për t’ a këndue, duke më bërë njëherësh dhe ofertën e të qënit redaktor e vlerësova konsideratën e mikut tim ,por pyeta veten: A thua mundem me marrë përsipër një përgjegjësi të tillë?!..

Vetëm me titujt e veprave të tij, mund të kompozohet një poemth sepse në secilin titull gjen një varg me ngarkesa emocionale e

nëntekste, që të japin dorë të shpalosh shumëçka nga stili dhe gjuha e autorit.

Libri „Gjethi i këputur në vjeshtë”, që i jepet në dorë lexuesit, është vazhdim kreativ i gjithë opusit poetik të autorit.

I kompozuar me tre cikle poetike, libri sjell realitetin tronditës të shoqërisë shqiptare në përgjithësi nëpërmjet një mezazhi universal:

Thërras turmën

Shurdhmemecët si gjithmonë lozin

Një valle të lashtë pagane

Më duket se nuk kam zë

Ose të tjerët

Kanë mbetur pa të shtatë shqisat

Kjo shurdhëri e lëndon zemrën e poetit, i cili si pjesë e avangardës thërret deri në kupë të qiellit se koha po na len prapa e hapat e inegrimin janë larg ritmit që kërkohet. Tani është koha për ta zënë trenin e agut të madh.

Autori në këtë cikël shpalon edhe dukuri të pasluftës në Kosovë. Me tone drithëruese kërkon që mos të harrohet epika e ditëve të përgjakshme të qëndresës dhe luftës çlirimtare, por të lartohet si flamur i madh për shqiptarinë.

Për të shtatën

Vritej po i njëjti njeri

Vritej vdekja

E cila aq krenarisht e përbuzte armikun

Dhe vaji i zambakëve nuk diti me pra brigjeve të dhunuara të Lumbardhit’

Pastaj:

I tërë qyteti me shamia të zeza

Vajtonte te kambana

Fatin e muranave që kurrë më nuk u ngritën

I dhemb në thellësi poetit të burrëruar mes dhimbjeve dhe flakëve

në pritjet e gjata në të gjitha stinët e qytetit të tij të lavdishëm,qytetit të kuvendeve,të shpresës për agimin e madh të bashkimit kombëtar. Vdekja nuk e tut(tremb),Ai nuk don të vdes jo se i dhimbset gjaku, por se i duhet Dheut të tij.

Disa herë e pashë vdekjen me sy

Iu zgërdhesha dhe i thashë troç

Sonte s'd ua të vdes i duhem atdheut tim

I duhet poeti Adem Zaplluzha, Prizrenit të tij ,vendit të vet si qytetar e si këngëtar, si ushtarë i vijës së parë në udhën e zhvillimit e integritimit .

Jeta vazhdon qytetit me kalldramet ilire, me dashurinë e madhe në zemër,me sy nga e ardhmja.

Dy nuse ktheheshin nga spitali

Me nga dy binjak në prehër

Kalldrëmet ilire pranë Shatërvanit

Shkëlqenin si asnjëherë më parë

I shkruar me gjuhë të pasur e me një stil të dallueshëm, produkti poetik i Zaplluzhës e pasuron traditën tonë, duke sjell në letërsinë shqipe një kontribut të fillikatshëm jo vetëm nga masa, por edhe nga niveli artistik, motivet që sjell e mesazhet qytetare e humaniste që përcjell

Autori me freskin që na e sjell vjeshtën në këtë vëllim,dimrin e len larg në ftohtësin e vet. Ai ndjehet i ri në vjeshtën e tij, larg muzgjeve e pranë Agut të madh të bashkimit.

E na presim librin tjetër me kangë të reja për pranverën tonë.

Lezhë, më 11.09.2017

VEPRA POETIKE E ARBEN PRENDIT, NDËRMJET DIALEKTIT TË NDËSHKUAR DHE STANDARTIT TE DETYRUESHËM

“ Prendi lekundet mes dy gjuhëve, njëra ekspresive, tjetra kritike. Në aktshkrimin dhe aktligjërimin e tij, dominon gjuha e folur proverbiale , e cila e bën poetin një individualitet të spikatur“ Prof.dr. Alfred Çapaliku.

Poeti Arben Prendi, vjen nga një areal etnokulturor me tradita të hershme e të vona letrare ,që e la pas rininë e herëshme, në Lezhën e tij të dashur dhe u nis udhës së dijes. Në këtë udhë të bukur e të vështirë, ëndrra për t’u bërë poet e ndjek kudo dhe, në dilemën për t’u bërë poet ose jo, fiton andrra e rinisë së hershme. Dhe kështu troket heret ne tempullin e poezisë e andrra merr krah.

Pas 29 vitesh krijimtari poetike, vjen para lexuesit me ,Vepra poetike,vëllimi i parë . Doktori i Shkencave Letrare dhe Profesori i asocuar në Universitetin , “Luigj Gurakuqi“, Shkodër, është autori një varg veprash të botuara jo vetëm në poezi. Si kritik lerar e publicist ai ka botuar :

Tekste e nentekste,studime letrare,Naimi,Tiranë 2011

Letërsi shqipe bashkëkohore.Ndërthurja e poetikave dhe çkodimi i realitve metafizike në romanin bashkëkohor. Monografi.Fiorentia,Shkodër,2015.

Probleme,autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore Studime letrare. Fiorentina.Shkodër,2017.

Prendi është autor artikujsh dhe ligjëratash , botuar në shtyp

a mbajtur në evente të ndryshme letrare e kulturore , brenda e jashtë atdheut.

Vepra poetike, vëllimi i parë, Florentia, 2018, është e kompozuar me shtatë libra, që autori i ka quajtur cikle . Duke respektuar rendin kronologjik të botimeve , poeti sjell për lexuesin krijimet e tij të hershme, ku ndihet era një stine të re, që po troket. Në kapërcyell të saj poeti i ri na kumton me tone të qeta e të kthjellta kredon letrare dhe aspiratat estetike në udhën e saponisur .

Fjala është aty,
e shkruar,

si gonxhja

trishtë mbyllur në vetminë e saj te bukur,
nën smeralde harrese.

Ti vështroje,
veç një herë,
të çelet.

Në ciklin e parë: “Thirrja e horizonteve”, janë përmbledhë disa prej poezive të moshës 18-23 vjeçare, që nuk u botuen kurrë , por tash lexuesi identifikon hapin e sigurt të poetit drejt krijimit të profilit të vet

Të shkruara në horizontin kohor, 1989-1995, ato sjellin një realitet tronditës për poetin, ndaj të cilit ai reagon plot sarkazëm, duke na thënë se aristët e vertetë nuk duhet të bashkëjetojnë me realitetin që i rrethon. Ata janë e duhet të jenë avangarda e shoqërisë njerëzore.

“Kam pa vetëm poetë të trishtuar në këtë vend
Sepse poetët shohin të ardhmen”

Libri i dytë: “Të shtunën ndize një qiri”[1996], janë përzgjedhë një pjesë e mirë e poezive të botueme në këtë vëllim. Tipari dallues i këtij vëllimi është lëvizja e arkretipit të tij nga standardi drejt një kumti me dialektin e gegërishtes , që i dha poezisë shqipe një fond aq të pasur e elitär , që nga Budi e deri te Anton Pashku e Martin Camaj. Asht një grishje që vjen natyrshëm në muzën e Arben Prendit ,që është nga truallë që nxori emra të përveçëm si

Fishta e Zarishi e ndonjë tjetër. E thënë me qartësi e thjeshtësi në autorencencën (parathanien), që përjell veprën poetike, autori na dëshmon se:

“Çështje problematike e poezive mbetet gjuha e shkrimit të tyne. Strukturat gjuhësore shkojnë gjithmonë kah strukturat e gegnishtes. Gegnishtja është gjuha e tyne e natyrshme, e leme, por për shkak të formimit në gjuhën standarde shqipe, shkollimi, leximi i letërsisë së shkrueme me këtë normë, ndodh fenomeni i përziemjes herë-herë mes gegnishtes dhe gjuhës standarde. Më duket se kjo është gjendja ku ndodhem gjuhësisht, në të shkrueme, ndërmjet dialektit të ndëshkuem dhe standardit të detyrueshëm. Sigurisht, nuk më ka shkuë ndërmend, se me këto poezi po e mkambi dialektin gegë, as nuk kam shkruë me përmbysë gjuhën standarde, por jam udhëheqë prej ndjenjës së leme gjuhësore dhe prej shprehjes gjuhësore e letrare të përfitueme nga letërsia e autorëve të mëdhenj gegë...” (parathanie)

Libri i tretë: “Vashat nguten me u ba gra” [1998], me poezi të zgjedhuna prej vëllimit me të njejtin titull, që pritet mjaft mirë prej lexuesit dhe qarqeve letrare .Një libër, që ecën në binarët e shtruar më herët. Po sjell një poezi :

Taka të nalta

Të holla thikë.

Plagosin trotuarin

Kalimtarët kthejnë kryet me pa

Asgja,asgja ,mos u ligshtoni

Vashat nguten me u ba gra!

...kot nguten,

E pamëshirëshme është koha.

Ah, sa kanë me u pendue

Ah,sa kanë me u pendue!

Cikli i katërt: “Qirinj te ndezun për të gjallët”[2001], me poezi nga

vëllimi me të njajtin titull.
Në Shkodrën e rrethueme,
mes një anarkie shembullore,
Nadja, (si i thone mengjesit, në Shkodër
asht person i shpallun në kërkim.
1997.

Shkodra,dhe gjithë Shqipëria janë të rrethuar nga krimi e dukuri,
që shoqëria jonë lëngon prej sosh. Një realitetet i trishtë urban, një
rrethim kërrcënues i individit sa të ban me e kundrue edhe njëherë
Pranverën.

Kundrova edhe një herë pranverën,
lotët e hardhive,
vijëzën e trembur të maleve në horizont,
buisjen e qershiztë të luleve,
këndoi i fshehur nje zog...
Dënosa tan ditën,
me një dallëndyshe të vrarë
në dorë.
1993.

Opusi poetik i Arben Prendit, në Vepra poetike, vëllimi i parë, është një zë i përveçëm , pemë e mjellun në vendin e duhur e me emrin e vet . Dashuria, dhembja, vetmia, jeta dhe vdekja ,refleksioni, raporti me ndergjegjen estetike, fenomene të ndryshme të realitetit, vijnë nëpërmjet një gjuhe poetike të zgjedhur e të kompozuar me mjeshtri. Janë mjaftë poezi , që mund të jenë pjesë e antologjive me argumente të ndryshme, por unë zgjodha këtu poezinë: “Nana dhe baba janë në kornisë“

E lanë jetën e zakonshme
nana dhe baba hynë në kornizë...
Ma prej saj nuk munden me dalë
as vdekja , që mendon se i mori
Nuk mundet me i prekë...

“Kjo poezi ekstatologjike , shkruan Prof. Alfred Çapaliku-përfaqëson atë moment tejet mistik, kur njeriu nga objekt, bëhet subjekt dhe dalëngadalë shndërrohet në hije(fenomen fizik) dhe më pas kthehet në hijeshi(fenomen estetik)”

Poezia e Arben Prendit është një poezi e mendimit e, si e tillë , shpalon vibrime lirike moderne në tërë strukturën gjinore të saj si në liriken erotike,atë sociale dhe filozofike, ku jo rrallë ndihet kumti pamfletik dhe ironia e hollë, shpesh edhe nëpërmjet imazhit, duke e radhit autorin Arben Prendi në radhën e poetëve të elitës. Natyrshëm , që një vepër letrare e këtij dimencioni kërkon studime të thelluara për shumçka që shpalon. Unë nuk hy tek ata që mund ta marrin përsipër këtë mission. Unë solla këtu një kundrajë të shkurtër e krejt modeste të Veprës Poetike ,të poetit Arben Prendi, i bindur se muza etij ka observuar motive të reja, që ne do ti këndojmë në Vepra poetike II.

Gazeta Nacional,datë 29 korrik 2018

IVU XGU
SHTEPIA BOTUESE

HISTORI SHQIPTARE NË REALITETIN ARTISTIK TË PROZËS SË ERNEST MARKUT

E tillë është ngrehina narrative e shkrimtarit Ernest Markut. Lexuesi i nënkuptuar e dekodon kthjelltas mesazhin , i cili na sajdiset si indkusion i autorit, jo vetëm nëpërmjet vëzhgimeve të holla , por edhe nëpërmjet përjetimeve të thella, hera - herës si stih...

Rava narrative zë fill bash aty ku autori hodhi hapat e parë, ku shqiptoi dhe fjalët e para të gjuhës së etërve. Aty, muzgut mesjetar pati shndritur lavdia e Blinishtëve të Zadrimesë e qenë ruajtur ndër breza mitet e këngët e moçme të njërit prej arealeve më të pasura të visarit kulturor nacional. Aty është dhe djepi Zarishit, poetit të fillesës së Rilindjes Kombtare. Shkrimtari Ernest Marku, i mëson këto gjurmë historie e kulture të fisit vet, nëpërmjet shkrimeve dhe rrefimeve gojore dhe ndjen se mund ta vijojë rrëfimin e tij. Histori, episode dramatike, tragjikomike, fatkeqe, por sakaq edhe erotike; e zgjojnë indin e tij kreativ. Po cili do jetë stili, idealet estetike, regjistri?... Duket që në shkrimet e para, se autorin e ri e shqetëson dilema , nëse mund të krijojë vepra artistike nëpërmjet një kumti lakonik, apo siç thotë populli: trup e shkurt?! Do të ishte e lehtë kjo zgjedhje?! Proza e tij e shkurtër herë si rrëfenjë e herë si ese, herë si skicë e herë si prozë poetike, dha provën e parë se kishte patur të drejtë, kur në mënyrë krejt të çuditshme, shënon në ballinën e librit: „Letërsi Spartane“... pra, histori me kumt lakonik, si aso

kohe në botën antike.

Thellë unit të brendshëm troket një thirrje e largët e mjegullt dhe e afërt sakaq. Është thirrja e gjakut. Rrënjët e identitetit të individit në një klimë shoqërore e humane plot trazira e padrejtësi, plot djallëzi e krime. Një thirrje, që të lëndon si fillesë e mandej të motivon deri në sakrifikim. Shkrimtari, i kthjelltë për misionin e artit të fjalës, bën vemendjen e duhur, për të na e sjellë me mjete artistike që i perkasin prozës. Atlasi gjeografik nuk është i madh, ndërsa ai i plagëve të dramës si një familje malësore, është i gjërë e i thellë. Jeta e malit dhe e fushës, e punës dhe shkollimit e vazhdimit, janë dhënë nëpërmjet një poetike të lavdërueshme. Blinishti, nëpërmjet rrefenjës, shpalohe si histori e letrarizuar. Nuk mund të themi se cili është yrneku i tij, pra shembulli ku merr cak rrëfimi romanor. Por, as nuk mund të themi se sjell një model. Mundemi vetëm të provojmë se, në mënyrë kreative, shpërfaqet i ndryshëm, jo vetëm nga autorët e njohur shqiptarë... I pëlqen ta ndajë lëndën romanore në pjesë dhe kështu bën, diku shkruan një maksimum të njohur e diku një trakatat të tijin.

Tipar dallues i katër librave të parë, është edhe dialogu intensiv, me nëntekste të menduara mençurisht. Rregjistrimi është i përzier. Sintaksa gjithashtu e kompozuar me qartësi, e tillë që respekton kodet e gjuhësisë së tekstit. Indetifikohet lehtë se gjatë aktit të krijimit, ai, përposë të tjerash, disponon një arkiv të pasur leksikor që e begaton tekstin.

Në kumtin romanor nuk lëvizin shumë personazhe, por shumë episode, ku narratori shkruan në kohën e tashme, por jo rrallë dhe në vetën e tretë, duke evokuar ngjarje nga e kaluara. Autori nuk zgjatet me përshkrimin e mjedisit, por as te situatat ligjëririmore. I thukët në mendimet dhe perifrazimet rreth koncepteve filozofike, estetike e socio-psikologjike. Autorit i dhëmb fati i individit në një shoqëri totalitare, i raportit të tij me familjen e shoqërinë saqë, ndonjëherë, ndjehet fryma ekzistenciale... Realist të shumtën e herës, edhe impresionist aty këtu...

Një krijues i talentuar i çdo fushe, nuk e pranon realitetin ku jeton e vepron. Komuniteti krijues i çdo shoqërie është avangarda e saj. Ajo shpalon atë që duhet të ketë një proces zhvillimi. Në veprën e tij, shkrimtari Ernest Marku, mban qëndrime ndaj dukurive e fenomeneve sociale. Këtë e realizon nëpërmjet një ironie të hollë e hera -herës, me kumte pamfletike. Ndjehet në monologjet e tij dhimbje, shpresë e zhgënjim. Gjeografia e episodeve dhe ngjarjeve, ka një marrëdhëni intensive, herë nga fshati mbi kodër drejt metropolit dhe herë nga e kundërta. Kur niset nga fshati për në sheshin e madh të një lëvizjeje mbarëpopullore, mbart shpresë dhe emocion, beson dhe atje behet pjesë aktive e lëvizjes. Zhgënjehet, kur kthehet në vendbanimin e tij. E quajnë të dalë dore. Plangprishës, mosmirënjohës ndaj Partisë. Ky biri i këtij kuadrit e tjerë e tjerë... Fshati si fshati. Sa vonë vjen këndeje pranvera. Me realizëm autori e skicon fshatin e atyre viteve. Po Tirana? Qielli i saj plot shpresë. Të shtypurit e diktaturës janë të parët që kremtojnë, por jo të gjithë... Dikush kthehej nga Këneta e Tërbufit pas internimeve të gjata, nga burgjet politike, të tjerë... Përballë dramës gjysëmshkullore të shtresava të shtypura, autori na kërkon të jemi reflektivë e humanist, e mbi të gjitha të drejtë. Diçka dinjitoze pret të bëjë shoqëria, politika... A thua vetëm nuk do na dënojnë më, kur lllapim sa të duam dhe kaq...

Në prozën e Ernest Markut episodet, ngjarjet, dashuritë, ndarjet, zhvillimet politike, zhgënjimet, refleksioni, dhembja, revolta, korrupsioni, imoraliteti; nuk shpalohej thjeshtë si kronikë, por si një realitet artistik, duke dëshmuar se kredoja e tij letrare, për kumte lakonike me densitet të lartë të mendimit, me ideale estetike e emocione të ndjera, me një kompozicion tejet funksional; janë treguesit se zgjedhja e tij ishte e drejtë dhe profili i tij krijues arrin të jetë i ndryshëm e i dallueshëm, ndërsa vijimi edhe më i suksesshëm.



Publicistikë

SHTEPIA BOTUESE



MINERAL NXORET NJE JETË, FLORIRI ISHIT VETË

-Reportazh-

Për rreth pesëdhjetë vjet, kanë hyrë e dalë Ata nga brinjët e shqyera të nëntokës. Male minerali kanë nxjerr prej saj. Brigjeve të Urakës flejnë dambat e kuqremta, me mijra km. tel, ton floriri janë nxjerrë, maganizuar e përdorur anekënd Shqipërisë. Të gjitha këto prej duarëve dhe djersës të këtyre “pirustëve”, minatorëve të Kurbneshit si i quante ata, inxhinieri poet, Martin Cukalla. Vite të tëra gërmuan Selitës së nëndheshme, duke nxjerrë mbi tokë bukën e përditshme për fëmijtë. Me atë heroizëm e idealizëm brilant nuk u lodhën, por ndërtuan qytetin, fabrikën, uzinën, Shqipërinë ... Ndërsa ata morën 22 shokë të rënë në frontin e punës dhe rreth 300 të tjerë të vdekur nën moshën 50 vjeç nga silikoza, me qindra të tjerë, mes jetës e vdekjes rropaten të zgjatin sadopak jetën e shtrenjtë të ngrëne nga pluhuri dhe kolla e vazhdueshme. Ashtu ngadalë mushkëria sosit, si në legjendën e lashtë të Prometeut. Kur e pyetën selitasit priftin Dom Vlash Muça, se ç’thesar po kërkojnë këta, ai u përgjigj: Nëse do zbulohet, do sjellë zhvillim të madh, por do të korr edhe jetë njerëzish... Afërsisht ashtu ndodhi...

Pak histori

Kur në krye të një nëntitulli, vemë fjalën histori, pa mëdyshje mendja të shkon tek arkivi i asaj kohe, që merr përsipër për të thënë diçka. Por nuk na ndodhi kështu. Na erdhi në ndihmë muza

popullore, e cila është kronika e ndjerë dhe e saktë e asaj , që do ndodhte më vonë këtyre viseve. Jo rrallë qe dëgjuar në ditë festash a dasmath të këndohej ndër sofa:

Në ‘56-tën tue dal pranvera

N’at Kurbnesh, u hap miniera..

Vargjet shpallin pa drojë gëzimin e madh të hapjes së një miniere, a thue e ndjenin se dekata më vonë shkrimtari dhe publicisti, Ndue Dedaj, do të shkruante në reportazhin e tij: Miniera e bën njeriun minierë” Epo rapsodi dhe publicisti, duke qenë vazhdim i fisit të pirustëve, nuk mund të ishin të ndryshëm në ndjesitë dhe profecitë e tyre... Dihet se lajmëtarët e thesarit janë gjeologët. Me 16 korrik 1954, u hodhën themelet e kërkim- zbulimit të vendburimit Kurbnesh.

Inxhinieri Aleks Vranaj, kujton se ekipi përbëhej nga kolegët e tij, Luan Peza, Haxhi Sauku dhe rusi Anatol Zverjuka, me bashkëshorten e tij, Sofia Nikollajevna Zverjuka. Na duhet të shënojmë se në ato vite nuk kishte rrugë makine, kësodore sondat u trasportuan me kafshë e me krah me mund e skrifica të patregueshme. Gjergj Kolmarku me ekipin e tij nuk do të shlyhet kurrë nga kujtesa e bashkëkohësve.

Kariera në Lak të Kishëze, është vendi, ku filluan punimet minerare e u lëvizën 500 mijë metër kub sterile e u prodhuan rreth 400 mijë ton bakër , deri , më 1963, kur filloi shfrytëzimi nëntokësor. Në horizontin kohor të viteve 1956-1994, janë prodhuar 2 863 519 ton bakër me 1.29 cu. U hapën udhë të nëndheshme 80 km, e barabartë me rrugën auto, Perlat – Tiranë. Kuota më e lartë e prodhimit u arrit më 1971, ku u prodhuan 119 330 ton bakër. Në këto vite miniera dhe fabrika e Kurbneshit, u kthyen në njërën nga qendrat më të rëndësishme të industrisë së bakrit në Shqipëri. E para fabrikë pasurimi , ishte Fabrika e Pasurimit të Bakrit Kurbnesh. Në muajin shkurt 1961, u vu në punës seksioni i parë. Ishin specialistët gjermano-lindor , që bashkë me inxhinierin, Zef Gera, drejtuan kurset për flotuesit e ardhshëm. Po kështu, një grup të rinjësh nga

Selita e Kthella u specializuan në Gjermani. Kështu, kjo fabrikë u bë shkollë për ato që u ngriten më vonë në Mirditë e më gjërë. Që nga përgjegjësi i parë i minierës, Gjon Zogu e deri te të fundit, Ndue Gjokolaj e Preng Mark Gjini, kanë punuar qindra drejtues, specialistë e minatorë dhe secili ka pjesën e vet të mineralit të nxjerrë dhe metrin e galerisë së hapur...

###

Në pranverën e 48-të, të hapjes së minierës, udhëtojmë drejt Kurbneshit. Një qiell i vranët na rrin mbi krye. Kur dalim në Qafë të Pëllumbthit, përballë na shfaqet si gjithëhere, Guri Gjon, vigan e madhështor, në sfondin gri të bjeshkëve. Njëpër këmbët e tij rrjedh si i hutuar, lumi i kthjellët. Në brigjet jugore të tij, qyteti Kurbnesh të ngjan me një rrënojë pas një beteje... Shuteriqi, para 40 vjetësh, në një reportazh të tij, e pati krahasuar me koshere bletësh, që gumzhin... Profesori i nderuar, atëhere kishte të drejtë. Ishin rreth 1500 punëtor të bakrit e të sektorëve nihmës, banorë, rreth 1300. Vetëm, dy km ishte largësia e qytetit nga galeria kryesore. Që nga hyrja në minierë, çdo minatori i duhej të bënte rreth katër km. rrugë për të shkuar në frontin e punës. Ishte një nga ata sektor të prodhimit, ku fjala "fronti", kishte kuptim jo simbolik, por real, pasi lufta me shkëmbenjtë ishte e përditëshme, ku të papritura rrinin mbi kokën e çdo minatori. Një vagon minerali kalonte në pesë duar, deri sa të delte në sipërfaqe, për të marrë udhën drejt fabrikës së pasurmit, ku treni i vogël elektrovoz, bënte dy km deri në destinacon.

Zhurmonte dhe e zhurmonin qytetin e vogël minator. Nuk dihet numri i kronikave, reportazheve për njerëzit e tij. Edhe se jeta e tyre nuk ishte bash si shkruhej në kolonat e gazetave apo thuhej ndër televalë... Jeta rridhte. Edhe një natë pa hënë, ka dritën e saj. Populli thotë: "Çdo e mirë e ka një të keqe e çdo e keqe e ka një të mirë."

Në këtë qytet mes malesh erdhëm gjeologë, inxhinierë, ekonomistë, mësues nga gjithë viset e atdheut, bashkë me familjet e tyre.. Thuhet shpesh se, mirditasit i kanë respektuar pa cak të ardhurit. Këtë e

pohojnë me kënaqësi edhe ata vetë, por mirditasit kishin të drejtë ta bënin këtë jo vetëm në respekt të traditës së njohur të mikpritjes. Kishin të drejtë se në relievin tonë, ata sillnin element të panjohur në marrëdhëniet tona, në mënyrën e jetesës dhe të komunikimit. E mirditasit e duan të renë....

Udhët e bakrit Kurbneshi i zgjaste thellë. Nëpër ato udhë, do lëviznin breza minatorësh. Në këtë front të vështirë si e thamë edhe ma heret, sfida ishte epiko-heroike. Lumenj djerse u derdhën, por edhe gjak...

Të rënë

Ata nuk janë pak. Janë 22 minatorë. Të gjithë në lule të moshës: Tuc Preng Doda, Gjini Pjetër Nikollaj, Hajrulla Suçi, Selman Cara, Halit Kaci, Ramiz Koleci, Adem Hysnelaj, Preng Mark Gjokolaj, Ndrec Lika, Mark Përkeqi, Seit Cara, Nikoll Përlika, Pjetër Kaçorri, Murat Përgjegja, Ndrec Llusku, Kolë P. Lleshi, Gjetan Lala, Agron Hazbiu, Dava Zogu... E midis tyre, "Heroi i Punës" , Frrok Kol Kaçorri, emi e të cilit, mori Miniera e Bakrit Kurbnesh.

Gëzimi , i biri i heroit, lindi disa ditë pas rënies së babajt të tij minator. Edhe djemtë e minatorëve që erdhën në jetë pas shuarjes së baballarëve u pagëzuan me emrin Gëzim, sikur ta kishin bërë me fjalë... Gëzime paçin , gjithë bijtë e minatorëve!

Të rënë pas betejës...

O Zot!. Numri i tyre është i madh. Ai rritet çdo ditë, çdo javë, çdo vit. Ndoshta edhe tash , kur po hedhim këto radhë, homazh për ta, diku në Selitë, Macukull, Derjan, Kthellë a Fan, fjalëtorët janë nisur për të ba me dije rënien e radhës... Silikoza, kjo sëmundje e përbindshme, i preku mushkëritë e minatorëve shpejt. Të parët pas betejës ranë : Zef Gjini Lleshi, Pjetër Ndue Lleshi, Mark Mikeli, Bib Margjini, pa i mbushur 40 vjet jetë. Radha e tyre u shtue në vijimësi. Përmbajtja e lartë e silicit, mungesa e shpimit të largur deri vonë, varfëria e minatorëve që banonin në fshat e shtuan shpejt numrin

e të sëmurëve. Murlani i egër e frulliza e borës u përplasej në fytyrë e gjoks të atyre , që vinin në këmbë nga Lufajt, Bardhaj, Lëkunda ,Zajsi, Mërkurthi. Kështu , në agun e acartë për të filluar turnin e parë. I njeiti rit për turnin e dytë, e akoma më keq, turnin e tretë... Dhe në çdo ndërrim turni, ata që dilnin u thoshin atyre që hynin në minierë: Dalshi shëndosh! Pas pune një bukë gruri nën sqetull për fëmijët. E pabesueshme, por episodi i rradhës, ka ndodhur shpesh. Uk Toçi nga Urxalla e Matit, vinte thuajse çdo ditë në këmbë nga shtëpia e tij dhe kthehej prapë pas turnit, tetë orë udhë. I hekurti Ukë! Kështu vepronin edhe minatorë nga Lami I Madh, Kumbulla e Merkurthi, Kthella Epër, Ndershena, etj. Sëmundja vrastare goditi egër. Deri në pranverën e këtij viti, 2004, rreth 300 minatorë, teknikë e inxhinierë kanë ndërruar jetë pa e kaptuar mesin e moshës. Pjesa më e madhe i kaluan vitet e fundit të jetës në mjerim të madh, me do pensione qesharake, që as për ilaçe nuk mjaftojnë, qindra të tjerë presin të bien pas betejës vigane me mineralin ...

Kurbnesh, 30 prill, 2004

Qindra minatorë, teknikë, inxhinierë, drejtues ndër vite, fëmijë e familje të minatorëve , u mblodhën te hyrja e minierës së Kurbneshit jo për t'u futur në minierë, por për të përruar një pllakë simbolike, vendosur aty nga nga Komuna Selitë, Këshilli dhe kryetari i saj Nikolin Lleshi, në nderim të punës, djersës , sakrificës e gjakut të derdhur në vite

.Aty shkruhet:

Minatorëve të Minierës Kurbnesh:

Mineral nxorët një jetë

Floriri isht vetë!”

E para pllakë, që vendoset në ndonjë minierë në Shqipëri. Në këtë takim përpos deputetit Luigj Gjoka, kishin ardhur dhe autortete vendore si dhe drejtues ndër vite si Dod Tusha, Ndue Marku, inxhinieri Thanas Dede, që e filloi punën në këtë minierë. Ing. Gjon

Bazhella kishte ardhur sëbashku me librin e tij: "Kultura Minerare në Mirditë", një libër i veçantë, ku përshkruhet hollësisht tradita mineralogjike dhe puna ndër minierat e krahnës bakërmbajtëse.

Me zërin që i dridhej nga emocioni dhe silikoza, minatori, Ndue Dod Gjokolaj përmend emër për emër, të gjithë ata, që i dhanë jetën kësaj miniere e kësaj zone të thellë.

Mot i vranët. Shi nuk bie. Ani se te qerpikët e shokëve veson loti. Është lot malli, dashurie, dhembjeje. Ai diellon. Sytë e tyre vështrojnë trishtueshëm e ashtu në heshtje bëjnë apelin e shokëve. Sa shumë do të mungojnë përgjithmonë. Të tjerë që assesi nuk mund të vinin. Nuk do të mundin, kurrë....

Teposhtes ecim drejt Kurneshit bashkë. Kujtime pafund...E përsëri na vijnë në mend fjalët e inxhinierit poet, Martin Cukalla;"Pirustët ishin gjallë. Në Kurbnesh i pamë."

Gazeta "Mirdita", prill, 2004. Bashkëautor Bardhok Pulaj

PAL KUKA, NJERIU, QË PËR FLAMUR , KA NDERSHMËRINË

Me veprimtarinë e Pal Kukës për pajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve është pasuruar dhe më tej tradita e viseve, ku ai lindi, vise që prof. Ismet Elezi i ka quajtur “Atdheu i Kanunit”. Profilit të “Mësuesit të merituar”, do t’i mungonte shumëçka, pa pasqyruar kontributin e tij të padiskutueshëm si veprimtar i palodhur shoqëror , si pajtimtar, si ndërmjetës, si moderator, si iniciues i shumë veprimtarive në Mirditën e tij. Dhe jo vetëm në vendlindje. Pal Kukën e kemi parë të ngjitet në tribuna të kuvendeve në rrafsh kombëtar. Në Tiranë, në Prizren, në Lezhë, në Vlorë, në Shkodër, ku fjala e tij e peshuar me mastarin e urtisë popullore, mori vlerësime të veçanta. Çelësi i suksesit të tij është e do të mbetet, sinkronizimi kreativ i traditës së vjetër, bartës i së cilës është dhe ai, i ndërmjetësit të kualifikuar në klimën e zhvillimeve demokratike dhe të dukurive të reja e të panjohura më parë, me të cilën u ballafaqua shoqëria shqiptare.

Me përgjegjësi e zell të pashembullt i mblodhi kodet e kuvendit tradicional të Veriut, shfletoi literaturën bashkëkohore të ndërmjetësimit dhe u vu në krye të pajtimtarëve në Mirditë. I veçantë shpaloset kontributi i tij në të gjithë krahinën dhe jashtë saj , gjatë viteve të mbrapshta 1997-1998. Ai me përkushtim të jashtëzakonshëm dhe me vetëdije të lartë, punoi pa u lodhur bashkë me veprimtarët e tjerë, për të ndikuar në qetësimin e situatës sociale dhe në parandalimin e gjakmarrjes dhe të konflikteve të tjera të

kohës. Në pikat më të nxehta të konflikteve , do të ndodhej gjakftohtë dhe i matur Pal Kuka. Shkonte kudo dhe e prisnin kudo... Punonte e kërkonte, që t'i zgjidhte bashkëpunorët si njerëz me besim në popull, të provuar dhe persona të drejtë dhe të zgjuar... Më 1997, më saktë, në fillim të prillit të atij viti, erdhi në zonën e Selitës dhe në një takim me disa veprimtarë të asaj ane, pasi dha mesazhin e tij të njohur për pajtim e mirkuptim, shtroi dhe idenë e thirrjes së një kuvendi zonal. Nuk ishte aspak e lehtë të bëje një kuvend në atë klimë të ashpër, nën atë qiell me tym baruti, në ato rrugë “kalldrëm me gëzhoja”, në ato ditë fatkobi, në atë “luftë” me armët drejtuar qiellit...

Pas ndonjë hezitimi nga ndonjë i pranishëm, u vendos që me 15 prill 1997, të thirrej Kuvendi Selitës. Në platformën e këtij kuvendi, u hodhën pikat kryesore që do të diskutonte ai, u caktuan personat që do të bënin emblemën dhe do të hartonin e shpërndanin fletët e thirrjes për Kuvend (në atë kohë nuk funksiononte asnjë telefon, çdo lajm çohet me postier). Grupi organizator vendosi që kuvendi të mbledhej te kulla e Pjetër Gjini Lleshit, në fshatin Kurbnesh, e thënë ndyshe te pinjollit i Plakut të Selitës. Kuvendi do të ishte pluralist, me pjesëmarrjen e kryepleqve të zgjedhur dhe me përfaqësues të dyerve me emër në traditën e mirë të atyre anëve. Në të do të merrnin pjesë dhe nga qeverisja vendore si dhe një grup intelektualësh që përfaqësonin subjekte të ndryshme. Veprimtarët (grupi i punës i drejtuar nga Pali) punuan me intensitet të lartë, morën kontakt të drejtpërdrejtë me faktorët zonalë dhe shpalosën qartë platformën dhe qëllimin e thirrjes së këtij kuvendi. Në çdo tre ditë, Pal Kuka vinte nga Rrësheni në Kurbnesh (40 km rrugë pa asfalt), merrte kontakt me grupin e punës, jepte këshillat e rastit e kthehej me ndonjë makinë transporti. Në Rrëshen e prisnin punë të tjera. Ai do të riorganizonte shoqatën e Kryqit të Kuq. Njerëzit thonin: Tani e paskan gjetur njeriun për Kryqin e Kuq. Pali është njeriu i Zotit!

Me 15 prill të atij viti, u mbledh Kuvendi i Selitës. Pas 50 vjetësh

selitasit e vjetër e të rinj u mblodhën në kuvendin e tyre në mënyrë të pavarur nga shteti dhe morën vendime të rëndësishme për qetësimin e situatës së ndezur të asaj periudhe. Në kuvend morën pjesë thuajse të gjithë ata që u thirrën. Erdhën dhe nga Fondacioni për Pajtimin e Konfliktëve, me qendër në Tiranë, nga TVSH-ja dhe media e shkruar. U bënë disa pajtime dhe u zgjidhën disa mosmarrëveshje gjatë zhvillimit të kuvendit. Ishte një veprimtari mjaft e dobishme, e cila do të kujtohet për impaktin pozitiv që pati në ato kohë të trazuara.

Kredo e Pal Kukës ka qenë dhe do të mbetet ashtu siç e ka thënë ai vetë: “Gjuha ka për bazë Urtësinë, në majë mençurinë dhe për flamur Ndershmërinë”. Nëse dikush do të bënte portretin e pajtimtarit, “Mësuesit të merituar”, Pal Kuka, do t’i sugjeroja këtë diçiturë: “Pal Kuka, gojëtari zemërbardhë, i urtë e i mençur, që për flamur ka NDERSHMËRINË”.

MIUZGU
SHTEPIA BOTUESE

GJURAJT.

Gjon Gjura është një pensionist, që po i kapton tetëdhjetë vite jetë. Kur fillon të rrëfejë për dramën e tij dhe të familjes Gjura, herën e parë përmend vëllain e tij, Gjergjin .Dhe ja se përse?

Gjergji kishte kryer konviktin e Oroshit dhe fill pas mbarimit të luftës së dytë që emëruar mesues...I pat hy në zemër ky profesion, e vëllai i madh, e kishte dërguar Gjonin, në shkollën pedagogjike , në Elbasan.

Pati një fillim të shkëlqyer,por vetëm kaq...

Fatet nuk janë njësoj...

...dhe Gjoni rrëfen:

-Me, 31 dhjetor 1948, më thërrasin në drejtorinë e konviktit dhe më thonë të merrja valigjen se do nisesha për diku tjetër. E ku më shkonte ndër mendje se do më nisin për në kampin famëkeq të Tepelnës, në atë moshë krejt të re , kur fati më kishte grishur në udhën e dijes. Kur mësova përse më dergonin atje, u trondita thellë. Gjergji Nikoll Gjura, pasi pat punue do kohë mësues, që emëruar, në Komitetin Ekzekutiv të Mirditës, me qendër në Shpal. Kryetar ishte aso kohe, Bardhok Biba. Si një i ri, që mbështeti pushtetin e sapo ardhur, u zhgënjye shpejt. I rritur në një familje tipike tradicionale të Dheut të Spaçit , ai nuk i kapërdiu dot ato padrejtësi që po bente pushteti i ri. Në Mirditë, kishte filluar persekucioni i madh, sidomos mbi parinë e krahinës dhe klerin katolik. Abati Frano Gjini, kishte

ndërruar jetë nën turtura, po kështu ndiqej mësuesja martire, Marije Tuci , bije e Derës Princore të Gjomarkajve . Kjo ftohtësi e Gjergjit, u identifikua nga organet e pushtetit dhe u bë shinjestra e tyre...

E kështu , katër burra të kësaj dere, vendosën me marrë arratinë. Në tetor 1948, ashu siç dëshmojnë dhe dokumentat, Gjergj Nikoll Gjura, Nikoll Preng Gjura, Zef Pjetër Gjura, Nikoll Pal Gjura, bashkë me kryetarin e Këshillit të Gjanë (Këshilli rrethit) , Zef Preng Gjonin, me të birin, Gjergj Zef Gjoni.

Streha e tyre e parë u bë stani në Malin e Munellës, ku veronin bagëtitë, pastaj nëpër Fanë, në baza të sigurta, qëndruan për do kohë...

Mes Tiranës dhe Beogradit , ishte ngritur një mal me akull. Kreu komunist i Federatës së sajuar pas Luftës së Dytë Botërore, i kishte prishur aleancat me Moskën staliniste , që ishte aleati strategjik i komunistëve shqiptar.

Në atë vjeshtë të 1948-tës , ishte thirrur dhe Kongresi Parë i PKSH,ku u denoncua vija revizioniste e Marshallit Tito, duke e acaruar situatën politike në vend dhe jashtë tij.

Një varfëri e skajshme kishte pllakosur në gjithë vendin...

Edhe për familjen Gjura, ky ishte dimri i parë i atij viti,por i dyti, do vinte shumë i egër ndër malet e Veriut me klimë kontinentale.

Brigjeve të Fanit e të Drinit nuk ishte vetëm çeta e vogël e tyre, por dhjetra të arratisur nga Mirdita, pritnin ta kalonin kufirin nëpër atë dimër të pashoq.

Në dhjetor ose në fillim të janarit mendohet të kenë kaluar kufirin shtetëror.

Dhe që atëbotë, asnjë fjalë për ndodhjen e tyre, vetëm baltë u hodh mbi ta si armiq e tradhtar të atdheut...

Drama me shumë akte e persekutimit familjar.

Familja Gjuraraj është nga Spaçi, Dheu, që bashkë me Oroshin e Kuzhninin janë zanafilla e unionit mirditas me 12 bajrakët e saj, të njohur gjerësisht për vetëqeverisjen me kodet e kushtetutës antike,

Kanunin e Lekë Dukagjinit. Mbi këto parime funksiononte familja e madhe e Pjetër Gjures me rreth 40 anëtarë.

Kur burrat e saj dolën malit, pas pak ditësh nisën për kampin famëkeq të Tepelenës gjithë anëtarët e familjes , ku do të trajtoheshin si sklllevër

Gjoni fillon e numëron:Gjyshi, gjyshja, nana , motrat, kushërinjtë... Pas do kohet, thotë Gjoni, erdhi një urdhër që disa fëmijë të lirohen nga kampi nese kishte dikush që mund t'i mbante.

Dhe unë u lirova para familjes, por për mos t'u kthyer më kurrë në vendlindje, në Spaç, të cilin ma vonë diktatura do t'a kthente në burgun ma famkeq të Shqipërisë..Në Breg të Mates mbarova shkollën 7-vjeçare. Aso kohe kishte shumë nevojë për mësues dhe një fjalë e mirë e dikujt në komitet(Shaqir Dibra), bëri që të vazhdoj një kurs për mësues e fati e deshi të punoj për do kohë , derisa partia korrigjoi gabimin, që kishte ba me mue dhe më largojnë nga arsimi. Ketu shuhet ëndrra ime për t'u bërë mësues .

Kërkesa drejtuar shtetit shqiptar që nga kreu i diktaturës deri te kryeministri Rama.

Ashtu siç dihet, mërgata shqiptare e postluftës së dytë u shpërnda në gjithë kontinentet, por në përgjithësi, ata mundën të lidheshin me familjet e tyre.Gjurajt e shumë të arratisur të tjera nga Mirdita , Mati dhe Luma, që kaluan kufirin e dolën në Jugosllavi nuk u lidhën kurrë me familjet e tyre. Gjon Gjura na vë përpara një deng me letra, që i ka dërguar qeverisë shqiptare, ku i kërkon të dhana mbi vendodhjen e tyre a varret e tyre. Nga mesi i viteve '50-të e deri në vitin 2014, të gjitha përgjigjet e shtetit shqiptar kanë qenë : Nuk ka asnjë të dhënë për këta përsone...Përgjigjja e fundit është e kreut të shërbimeve sekrete të Republikës së Shqipërisë : Ky institucion nuk është i detyruar të japë të dhëna të klasifikuara...

Vertetë shteti shqiptar nuk din asgjë për këta shtetas, që kanë kaluar kufirin në vitin 1948, pra para 66 vjetësh?!...

Kaq sekrete paska qenë zhdukja e tyre, për të mos u treguar kurrë?

Kaq mister?

Dhe muza popullore me të drejtë pyet:

Kush ju nguli thikën shpinës
Të pabesët, a klysh të shkinës,
Kush ka qenë, kjo dorë mizore,
Që u ka vra, e lan' pa vorre

Kemi pyetun, zogit' e qiellit,
Kemi pyet valt' e Drinit
Kemi pvet, dritën hanës,
Ku i kanë tretun, djemt e nanës?!...

Amaneti

Sa qe gjallë gjyshi e gjyshja, e ma vonë nana e të moçmit e tjerë të familjes, na lanë amanet, që me shpresë të Zoti me i kërkue eshtrat e tyre e me i sjellë në dheun tonë.

Kam shumë vite që e mbaj si gurë mbi vete këtë amanet të të parëve të mi. Gjithmonë kam shpresuar se dikush e dikah, do vijë një lajm për ta. Prapë shpresoj e do shpresoj sa t'a kem frymën gjallë. Para një viti mendova ti mbledh pasardhësit e t'jua la amanetin, se mosha ban të vetën, por ndërrova mendje. Ndërtova një varr familjar te varezat e Laçit, ku pushojnë prindërit. Katër varre janë bosh. Presin që një ditë, amaneti të shkojë në vend e eshtrat e Gjergj Nikoll Gjures, Nikoll Preng Gjures, Zef Pjetër Gjures e të Nikoll Pal Gjures, të pushojnë pëjetësisht pranë njerëzve të gjakut, në dheun e tokës shqiptare. Por, jo vetëm eshtrat e tyre. Janë qindra familje shqiptare, që presin të gjejnë varret e humbura nga diktatura. Presim që të vemë edhe ne një tufë me lule...

Ky varr, nuk është vetëm homazh, por edhe një mesazh dhe apel për shoqërinë e shtetin shqiptar, që të tregoj ma shumë humanizëm e drejtësi për këtë kategori sociale, viktimë e dhunës së diktaturës më të egër të Europës.

MIRDITA NDER FESTIVALET FOLKLORIKE KOMBETARE, 1968-2000

“Folklori është pasqyra e kthjelltë e psikës së komit, është rrasa e mermerit, me të cilën historia zhgavron të endurit e shëndurit e popujve, është cekja e pashterrshme e gjuhsis dhe letërsis komtare...” Këto fjalë të AT’ Gjergj Fishtës, padyshim, epikut më të madh të letrave shqipe, tregojnë qartë se folklori si fenomen artistik dhe jetësor jo vetëm se është i vjetër sa vetë njeriu, por dhe se lindi si nevojë e tij.

I mirditasi në origjinë, poeti i madh, Homeri i gjakut tonë, në Gomsiqe, do të shkruente këngët e para të “Lahutës së Malcisë” ashtu si bëri dhe Gjeçovi jo vetëm me mbledhjen e kodifikimin e kanunit, por edhe me përshkrimet, që ai u bëri ceremonialit të dasmës dhe të mortit. Për ta dhe për albanologë të huaj, Mirdita ishte një minierë, shpirti i florinjtit i të cilës ruajti vlerat autentike të folkut.

Luftrat për qëndresë i dhanë këngës së saj, frymën epike, dashuria për jetën, një lirizëm të kulluar, inteligjencia, një humor plot shëndet, reagimi ndaj së keqes, një sarkazëm të thekshëm, respekti ndaj paraqitjes, një shije të hollë të veshjes, dhimbja, një kangavaji, që të trondit...

Folku i Mirditës ndër festivalet kombëtare

Festivali i Parë Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë, 1968

Dihet se, pas shumë ekspeditash, në gjithë trojet tona, u organizuan festivalet folklorike kombëtare, të quajtura ndryshe, festivalet folklorike të Gjirokastrës. I pari këtij lloji u zhvillua, në tetor të vitit 1968.

Mirdita u paraqit me një grup folklorik, ku përgjithësisht u respektuan kriteret shkencore të këtij aktiviteti nacional. Spikati në mënyrë të veçantë veshja e bartësve e sidoemos e ajo e nuses dhe e grave si dhe instrumentet popullore të traditës. Në këtë përfaqësim të parë u pëlqyen dhe u vlerësuan zërat e Nikoll Preçit, Fran Vorfit, Kolë Zefit, Dod Becit dhe imitimet e meloditë me gjeth të Bardhok Mikelit. Duhet përmendur përpjekja e parë për ngritjen e Grupit të Burrave Mirditë nga këngëtarët e shquar, Fran Vorfi e Kolë Zefi, me kangën, “Kullat tona do t’i bashkojmë“

Para së gjithash, ky festival ishte një përvojë e mirë për gjurmimin dhe mbledhjen e folkut të pasur të krahinës, identifikimin e bartëse, ku një ndimesë të çmuar dhanë mësuesit.

Festivali i dytë, 1973

Krijuesit e bardët e fokut pas një pune të zellshme në të gjitha fshatrat, bënë të mundur, që përfaqësimi i grupit folklorik të ishte mjaft i mirë. Përvoja e krijuar, por edhe bashkëpunimi me Institutit e Kulturës Popullore e sidomos kontributi i etnologut Mark Tirta, poetëve Gjokë Beci e Dedë Ndue Lazri, këngëtarit legjendë, Fran Vorfi, muzikantit Kolë Picaku, etj, bënë të mundur një përfaqësim dinjitarë, ku veshjet tradicionale morën vlerësim të lartë. Zëri këngëtareve të reja, Gjyste Ceka, Matine Gjinali, Marte Bushi dhe të riut, Pjetër Shtjefanaku, sollën freski dhe origjinalitet në këndimin e këngës burimore.

Festivali i tretë, Gjirokastrë, 1978.

I treti, i vërteti.

Në këtë festival krijuesit dhe bardët e folklorit, do të ishin kryekreu. Tashmë jo grupi folklorik, por Ansambli Folklorik, “Mirdita”, vlerësohet me çmim të parë. Lënda burimore u bë një poemë folklorike e kompozuar mrekullisht. Këtij sukcesi i paraprinë veprimtaritë e shumta folklorike në krejt krahinën. Prurjet e reja nga Selita (fituese e flamurit të festivalit krahinor dhe dekoruar me medaljen Naim Frashër), Oroshi, Fierza, Kaçinari, ishin pjesë e këtij sukcesi. Kështu gazeta Drita e datës 18 tetor 1978, citon:

”...Xhamadani i Trimnisë“, një këngë e Mirditës. Është xhamadani i përflakur i Mic Sokolit, është këmisha e kuqe e Vojo Kushit, është simboli i shpirtit heroik e liridashës i shqiptarit...”...tani është e pamundur të vazhdojmë bisedën më tutje. Publiku duartroket kësaj here për kostumet e bukura të Mirditës.

Gazeta, “Zëri i Rinisë“, e datës 11 tetor 1978: “...mbi të gjitha muret e kalasë, mes qiellit dhe malit jehojnë vargjet:

“Shkrin çeliku e lulzon molla...” Është zëri këngëtares, Mrika Trumshi

Po te” Zëri i rinisë”, 14 tetor : ”E veshur si burrë (veshja e virgjëreshës), e paraqitur për herë të parë, e impresionon poetin, Rajmond Taho:

Ç’është kjo vajzë, veshur si djalë?

Ç’është kjo vajzë me çifteli

Zëri i saj hapsirën mbush

Kënga flet për trimëri

Gjallë, si Shota ajo ngjan...

Le të kujtojmë për një moment dhe episodin mbresëlënës, kur këngëtarja e vogël nga Kurbnesi, Lindita Vladi, i dhuroi buqetën me lule, këngëtarit gjirokastrit, Xhevat Avdalli.

Grupi i burrave, dyshja Kolë Zefi, Luljeta Përbasha, e papëreritshmja,

Gjela Pjetraj, vajtimorja e këngëtarja më në za e Mirditës, zëri i veçantë i Anton Gjokës, lahutarit Simon Beleshi , ishin disa nga vlerat më të spikatura. Lënda tekstore u përgadit nga poeti I njohur, Gjokë Beci, materiali muzikor u përzgjedh dhe u përgatit nga Dorian Nini, Mark Gjoka , Servet Cara, Fran Vorfi.etj. Kostumet popullore, shkëlqyeshëm (nën kujdesin e piktorit Lin Loci).

Festivali katert, 1983

Ansamblu, "Mirdita" me statusin laureatit, ngjitet në skenën e kalasë, i pari. Korri duartrokkitje nga më impresionueset, balada e famshme, "Dasma e Kamber Loshit", njëra ndër më të bukurat e Veriut e këndua nga një grup zanor i përzier , duke sjell një tingëllim original.

"Pëllumbesha dhe skifteri" , një valle e rrallë e Mirditës, me motive lirike e shoqëruar me guralecë, ishte prurje e veçantë në krejt FFK Gjirokastër,1983, një valle e përshkruar imtësisht nga shkrimtari austriak, Fabian Barcata, në romanin, "Lule".

Festivali i pestë , 1988

Kësaj here , shtylla të programit ishin dy balada: "Nuse e bukur ka dalë motra", që e mbloodhën, i ndjeri Ndue Kola dhe muzikanti Gjin Dona. Balada përcjellë dramën e nuses së Shtufit ,që ndërroi jetë në udhë.U dallua për tekstin dhe gjithë prozodinë muzikale si dhe këndimin e saj nga Marte Moli e...

Balada tjetër e mbledhur nga Gjokë Beci e Servet Cara,"Guri i randë rrin n'troje të veta" u këndue nga zëri i rrallë i të paharruarit, Ndue Përkola. Edhe Prenë Beci, shkëlqu me zërin e saj të veçantë ashtu siç u pëlqyen edhe Bardhok Deda, Kastriot Kola ,etj.

Festivali i gjashtë, Berat, 1995

Mirdita paraqitet me profilin e saj të njohur, veçse me një raport më të balancuar mes epikës e lirikës .

Dominuan motivet lirike ndërsa mungojnë këngë programatike

(me motive politike e frymë patetike). Orali i dasmës ishte krejt burimor.U vlerësuan lirikat, ”Në një mal dy kedhe vetëm, ’Brigjeve të Urakës “, mbledhur nga Mark Gjoka e Viktor Gjokolaj. Kjo e dyta këndua nga një treshe dhe shoqëruar me polikë e guralecë (me vegla paramuzikore).”Gurët e kullës do t’I bluaj“, ishte një tjetër baladë e këndua bukur nga Gjela Duka. U vlerësua gjithashtu kënga humoristike e kënduar nga Ndue Nikoll Gega, Grupi i burrave me këngët: Fry ,moj era e Evropes, mbledhur nga V.Gjokolaj e M.Gjoka, solist Kolë Zefi, “ Pa flamur n’Mirditë s’ka dasëm“, mbledhur Gj,Beci,M.Gjoka etj. Bukur tingëlluan meloditë me instrumenta popullore , nën drejtimin e Tom Lleshit, etj.

Gjirokaster,2000.

Folku mirditas, do të shpalosej në grupin folklorik të Qarkut Lezhë .Në këtë program u vlerësuan këngët: Tokën tonë e bekoji zoti, mbledhur Kolë Zefi e V.Gjokolaj, „Në këtë jëtë s’ka moshë meraku” (M.Gjoka,V.Gjokolaj), ‘Une e vogla nga Rësheni”(A.Kolshi,V. Gjokolaj), që u këndua nga 5 vjeçarja, Jurilda Zefi, më e vogla e këtij festivali.

###

Kënga folklorike mirditore ka konkuruar me sukses në shumë veprimtari kombëtare. Janë disa që kanë zënë vend në fondin e artë të këngës shqipe si: Për liri s’të fal shqiptari, Gj.Beci, S.Cara, që është kënduar edhe nga artistja e popullit Vaçe Zela e grupi vokali ansamblit të ushtrisë. Një tufë perla të lirikës si , Buzë Valmorit, Shkon Syzeza, Një tufë pllumba të bardhë, Brigjeve të Urakës, Shtegut të bjeshkës, etj , janë bërë pjesë e reportorit të Ansamblit të Këngëve e Valleve Popullore dhe e disa këngëtarëve të njohur si Arif Vladi, Arditi Gjebrea , Hysni Zela, Ilir Shaqiri,Shkurte Fejza e tj.

Gazeta “ Mirdita “, dhjetor, 2004

NJË SKICË NGA KURNESHI PËR 20 SHKURTIN

Salla e klubit të kulturës që mbushur plot. Pata ndërhyrë te drejtori , Bardhok Koka, që të mundësonte vënien në punë të fonisë. Më çuditi mirëkuptimi i tij i shpejtë, pasi i shpjegova arsyen përse do mblidheshim në atë sallë. Nuk vonoi dhe erdhi ing. Fran Canga me disa shokë të tjerë, dy prej të cilëve ishin inxhinierë të minierës, por jo nga Mirdita. Frani kishte menduar që takimin ta hapte një teknik i fabrikës, Gegë Gjini. Ashtu u bë. Foli dhe Frani, i cili për ma tepër se një vit kishte shpalosur hapur qëndrimet e tij për pluralizmin. Fola dhe unë, Eduart Kolmarku, studenti Tonin Mërdhoqi e Gjon Çuni. Shpërthyen duartrokitje e falenderime për ne organizatorët. Ishte hera e pare, që në atë sallë, që nga inaugurimi i saj, të flitej hapur kundër sistemit dhe të bëhej thirrje për ndryshimin historik. Kur dolëm jashtë, Nikollë Ndoku, miku im, që e kishin pranuar në parti rreth një muaj më pare, më tha: “Bukur e keni kombinuar, Radio Tirana sapo dha lajmin se edhe në Durrës e rrëzuan bustin e Enver Hoxhës”. E vërteta ishte e kundërta e asaj që tha vërsniku im mësuës. Frani, që ishte lideri ynë asoherë, as që na e kishte thënë një gjë të tillë, sepse realisht nuk e dinte. Lajmin e Napolon Roshit e dëgjova në ritransmetimin e tij. Qyteti i vogël notonte si një kaike mes tymnajës, ankthit e gëzimit. Të nesërmen njerëzit me “shpallën” sekretar të PD-së, kur asnjëri prej nesh nuk foli për çështje organizative. E vërteta është se ing. Franin e sulmonin me shumë, duke i kujtuar se “partia i kishte dhënë shkollën”...E kujtoj si një episod të veçantë të jetës sime, si ditën e

lirisë, ditën të shpresës së madhe.

Nuk është se këto vite nuk kam pasur dhe ndonjë zhgënjim, por kujtoj rininë, që më iku si dallgë mbi krye, harroj, çuditërisht, harroj. Kam drejtorë, që kanë qenë drejtorë me disa sigla partish aleate, e jo aleate. Nuk i kam parë në asnjë tribunë të flasin për kauzën e dhjetorit, e as stinën e integritimeve. Nuk kanë nënshkruar, qoftë dy rreshta si produkt intelektual dhe se nga mbijnë nuk e di, por kur e mësoi, trishtohem, ndjehem keq. Më duket sikur eshtrat e gjashtë njerëzve të mi të humbura nga diktatura me thërrasin. Dhe duke qenë se Zoti më pati dhënë indin e poetit, por jo fatin e tij (e drejta e botimit me emrin tim m'u dh në vitin '90-të), kur pashë një nga këta drejtorë, improvizova këto katër vargje:

“Në burgun, ku i ati vuajti dhjetë vjet

I dënuar për dy fjale goje,

Biri i ish –drejtorit, është drejtor,

I biri i të burgosurit, roje”...

Shtresa ime roje...! Sa afër pragut të burgut...As pesë shefa zyresh nuk ka nga kjo shtresë rajoni ku jetoj, dhe nja 5 a 6 deputetë ne Kuvendin e Shqipërisë. Sa pak. Pashë do gra të një institucioni rajonal, që shkonin në një veprimtari që organizonte Topalli në Tiranë. Vetëm tri gra ishin demokrate dhe vetëm ato shkuan, edhe se dy prej tyre me diplome të pa emëruara...E pra...Rroftë dita e lirisë!

Kjo skicë e thjeshtë ka një pjesë të parë rekuem dhe një pjesë të dytë si refleksion. Kështu i ndjeva kur i hodha, por të jeni te bindur se as mua as familjes sime nuk ka guxuar kush t'i kërkojë të votojë ndryshe pas 31 marsit 1991. Çuditërisht kam mbetur një votues konservator, në kundërshti me natyrën dhe pikëpamjet e mija liberal demokrate. PD-ja është për mua dhe të shtypurit nga dhuna e diktaturës, partia e lirisë, shenjtëresha e saj. Udha është e gjatë dhe e vështirë, por nuk ndjehem i lodhur për të çuar misionin sa më para, duke e lënë pas ndonjë zhgënjim, që prodhojnë të pa bojët, servilët, abuzuesit me pushtetin.

Tirana Obsevëer, 27/02/2013

MË FAL, MËSUES MARKU!

Klasa e pestë e vitit 1965 priste nga çasti në çast të vinte mësuesi i matematikës. Njëra nga shoqet e klasës na tha se është i vjetër, por i rreptë... Dera u hap pothuajse nxitmthi dhe para nesh u shfaq mësuesi i matematikës. Nxënësit u ngritën në këmbë si të qe dhënë një urdhër luftarak. Ai përshëndeti dhe shkoi te tavolina e tij... Për katër vite, mësues Marku na dha matematikë, fizikë, gjeometri dhe fiskulturë, por mbi të gjitha shpaloj modelin e njeriut me kulturë të gjërë e përkushtim të pasqorë. Me etikën, mënyrën se si vishej, si komunikonte me nxënësit dhe kolegët, si bënte vlerësimet, mësues Marku dallohej nga të tjerët... Na pyesnin: Mark Arapi u jep matematikën? Dhe vazhdonin: po more notë të mirë me këtë mësues, nuk lë shkollë pa mbaruar... Është e akademist thonin të tjerë, nuk ka njeri më të shkolluar sot Selita dhe jo vetëm, por Mirdita e më gjërë.

Në kujtimet e mia për të gjitha ata që kam patur mësues e pedagogë, Mark Arapin e veçoj nga të gjithë. Besoj se nuk mendoj kështu vetëm unë, që kisha prirje në letërsi, por breza të tërë. Po më jepet rrasa të rrëfej një episod, që ka ndodhur në resturantin e qytezës së Kurbneshit, aty nga viti 1969. Për shumë arsye, që unë i mësova më vonë, ai rrinte si i veçuar e në kafe hynte rrallë, por atë ditë po pinte kafe me një të moshuar nga Zajsi, diku në fund të lokalit. Pas pak hyri në lokal ish-nxënësi i tij N.B, i cili ishte cilësuar nga mësues Marku, si më i miri nxënës që kishte patur ndonjëherë. Kishte

thënë hapur për të se se: me këtë inteligjencë e këto rezultate të shkëlqyera, nëse i prihet mbarë , bëhet një gjeni. Por, N.B ndërpreu studimet ushtarake si i smurë mendorë . Bash atë ditë u acaraua më shumë se tjetër herë dhe prishi qetësinë në lokal. Sa u kthye për të dalë, pa në sallë mësuesin e tij. Heshti një moment dhe me hapa të ngadaltë eci drejt tavolinës së tij. Kur iu afrua një metër larg, u ndal, drejtoi trupin , vuri dorën në zemër dhe u përkul, duke thënë me nje ton përgjërues: - Më fal,mësues Marku!Ra një heshtje e rëndë... Mbi qerpik të mësuesit ,“të rreptë“ vesoi një lot. Lot dhimbje e dashurie. Lot prindëror... Nuk e di sa herë e kam pyetur veten: A do ta kishte qetësuar mjeku i vet kaq shpejt pacientin e tij? Dhe gjithmonë kam bindur veten e kam thënë, Jo...

Mësues Marku i vëzhgonte tipat e ndryshëm për një kohë të gjatë dhe në pavarësi të plotë nxirrte përfundimet e duhura, që sipas rastit ua thoshte nxënësve apo prindërve. Kishte krijuar besim të madh te njerëzit. Para nesh nuk ishte thjeshtë mësuesi, por njeriu i ditur, mendimtari, psikologu i pagabueshëm në gjykimet e tij. Ai i ndërtonte marrëdhëniet me nxënësit e prindërit, duke njohur nivelin dhe mendësitë e tyre, problemet familjare etj. Psikologjia popullore e vështroi personalitetin njerëzor me thjeshtësi e thellësi të çuditshme. Nuk thonë kot për një fëmijë të mangët: “Asht prej familje soj, por ka rrëshqit... ”

Gjithë jeta e tij flet për humanizëm e përkushtim,urti e durim, dashuri, dije e zhvillim ,për t’u kujtuar gjithmonë , si emblema e ushtarakut patriot, mësuesit të palodhur e prindit shembullor.

DY EPISODE NGA KURNBESHI PËR KADARENË

Romani është shumë i mirë, shkrimtari nuk është komunist...

Sapo e kisha lexuar romanin ,”Koncert ne fund te dimrit” të shkrimtarit tone te madh. Në mënyrë instiktive u ndodha para librarisë së qytetit të vogël. Pyeta per nje liber nëse kishte ardhur. Librashitsja ma bëri me shenj se nuk e kishin sjellur akoma.Pasoi një grime heshtje.Mos kij marak ,sa te vij...Biseda u ndërpre, pasi aty kaloi Prenga,një zyrtar i rëndësishëm lokal,por edhe nje lexues e artdashës i njohur.Ai vuri re se doja të shkëmbeja ndonjë mendim .U ndal. E mbarove? Shtanga një çast ,por ai nuk më la të mendohem. Po, për romanin e kam fjalën. Më dha mundesinë të hyja në bisedë.Po ,mbremë e mbarova.Bukur si gjithëhere, i thashë Prengës. Hodhëm disa hapa pa folur. Ai e theu heshtjen ,duke më thanë se edhe unë e kam lexuar.Pata drojë me i kërkuar mendimin e tij për romanin. Ai e vuri re hezitimn tim , shikoi pak rreth e rrotull, më vuri dorën në supin tim e më tha: Po ta them trup e shkurt si thomi ne mirditasit. Romani është shumë i mirë, por shkrimtari nuk është komunist!... Nuk e prisja këtë kumt të tij kaq hapur. Pastaj, nga goja e një komunisti të bindur e të zgjedhur në forumet Partisë në rreth. Ishte prag dimri. Ndyshe nga motet tjera, një erë deti(kështu i thonë vendasit erës që fryn nga perendimi), po frynte vrulltas...Bashkëfolësin e prisnin në një takim pune. U ndal, më shtrini dorën ,duke më thënë: Koncert në fund të dimrit...

Zbrita fillikat shkallëve të shtëpisë kultures, që të çonin në udhën kryesore ,duke thënë me vete: Vertetë ky dimër i gjatë, po merr fund?!...

Kuurrë!...

Një ditë më parë qe dhënë lajmi i largimit të Kadaresë nga Shqipëria. Dola heret nga shtëpia për punë. Nga grupi vogël i përsoneve, që po shkonin te dyqani i bukës, u ndal dikush. Në mënyrën se si ishte veshur, m'u duk se qe njëri prej shokëve të mi, por kur u afrova , pashë se ishte Drita , një mësuese, që kishte filluar punën atë vjeshtë. I pëlqente letërsia dhe shpesh këmbenim libra me sho-shojnë. Unë ,që edhe po të filloi të bjerë shi, nuk e ndërroi ritmin, po vonoja. Ty po të pres, më tha ajo. U njetjetuam. Pytja e saj qe beftë: Si thua ti, a mund të hiqet nga historia e letrësisë Kadareja?! Nuk u mendova asnjë grimë. I thashë prerë, sikur gjithçka të ishte në dorën time. Kurrë,kurrë!

Ajo u gëzua shumë sikur të ishte një vendim i formës së prerë. Kurrë, tha ajo me vendosmëri, me gëzim e krenari. Më përshëndeti me dy gishtat e ngritur lart ,duke përsëritur, kurrë, Viktor!
Ishte fundvjeshtë...

Marrë nga gazeta MAPO, suplementi letrar

PERMBLEDHJA E LENDES

“BARRA E VRAME”	11
TAGRI I PASHKRUAR I FARKËTARIT ME NGJYRË, NË TRE BAJRAKËT E OHRIT	16
Revista “Mirdita”, 2016.....	21
VËSHTRIM MBI LIRIKEN FAMILJARE NE MIRDITË.....	22
TRAJTA TE KOMIKES NDER VAJET E MIRDITES	27
MIRDITA E KUQE, NJË TOGFALESH I MOÇEM	34
SELEMI.....	38

INTERVISTA

SELITA - KËNGA DHE BRENGA IME	43
ZOGJTË DUAN QIELL.....	46

SHENIME PER LIBRA

DËSHMI TË MENDIMIT TË SOTËM PËR HISTORINË, ETNOKULTURËN, BOTIMET DHE JETËN REGJIONALE TË MIRDITËS.....	61
POETI REPORTER.....	67
TOKA E KATEDRALEVE, NJË LIBER PANTEONI.....	70
SAGA E NJE MONOGRAFIE TË HERËSHME PËR MIRDITEN.....	73
DRITA E NJË AMANETI.....	78
MALI I KËNGËS.....	80
SHPIRTI I VISAREVE.....	84
DRAMA DHE QENDRESA E FAMILJES KOLZIU NE DIKTATUTURË.....	89
POETI POPULLOR JAK TUCL.....	92
RRËKEZË E KULLUAR , RRJEDHËS SË PROZËS SHQIPE.....	95
SELITA, NJË QIELL ME ZOGJ, BECAJT, NJË TUFË ME BILBILA	98
LIBRI “MIRDITA NËN TERRORIN KOMUNIST” - DËSHMI TRONDITËSE E NJË STRATEGJIE KRIMINALE.....	103

SHËNIME NGA KRONIKA E NJË JUBILEU	108
PER TEKSTET E FATOS HOXHËS	113
KULLAT I NGITËM VETËM PËR ARBËR.....	116
NJË JETË KUSHTUAR DIJES DHE PAJTIMIT	121
POEZI ME ERËN E STINËS SË VET.....	124
I FILLIKATSHËM.....	127
VEPRA POETIKE E ARBEN PRENDIT, NDËRMJET DIALEKTIT TË NDËSHKUAR DHE STANDARTIT TE DETYRUESHËM.....	130
HISTORI SHQIPTARE NË REALITETIN ARTISTIK TË PROZËS SË ERNEST MARKUT	135

PUBLICISTIKË

MINERAL NXORET NJE JETË,FLORIRI ISHIT VETË.....	141
PAL KUKA, NJERIU, QË PËR FLAMUR , KA NDESHMËRINË	147
GJURAJT.	150
MIRDITA NDER FESTIVALET FOLKLORIKE KOMBETARE, 1968- 2000	154
NJË SKICË NGA KURNESHI PËR 20 SHKURTIN	159
MË FAL, MËSUES MARKU!.....	161
DY EPISODE NGA KURNBESHI PËR KADARENË.....	163



isbn